

Janar 2018
Numri: 118
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

VLERA E XHENETIT



*Shtëpia botuese Progresi
vjen me 6 libra të rinj, të cilët
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë
individuale dhe shoqërore.*

TË
RINJ

Një këshillë
1001 mësimë
350 Lekë
3 Euro



Si edukonte
Ai (s.a.v.s.)
150 Lekë
1 Euro



101 Parime
në shërbim
200 Lekë
1.5 Euro



Shqetësimi
për brezat
200 Lekë
1.5 Euro



Udhëtimi
drejt Zotit
200 Lekë
1.5 Euro



Shërbimi
200 Lekë
1.5 Euro

Janar 2018

VITI: XII

NUMRI: 117

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardan Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Maqedonija

Mob: +389 7042 8245

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VIJTOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyra të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Një nga çështjet më të rëndësishme të besimit islam, është besimi në botën tjetër. Pra, fakti se pas jetës së kësaj bote, ekziston një botë tjetër. Njeriu nuk zhduket. Pasi të ketë mbaruar jetën e kësaj bote, ai fillon një udhëtim të ri. Besimi islam na bën të ditur se ky është një "udhëtim drejt përjetësisë". Pra, kjo botë është e përkohshme, ndërsa bota tjetër, është përjetshme.

Këtë sistem nuk e ka krijuar njeriu. Ai është vetëm një prej aktorëve, të cilit i është dhënë një rol. Brenda këtij sistemi është edhe guri, edhe druri, edhe insekti... Mirëpo, njeriu i është dhënë një rol edhe në botën tjetër pas kësaj bote. Njeriu do të vazhdojë të ekzistojë edhe atje, por atje do të marrë një pozitë sipas cilësisë së dosjes së jetës që ai ka dërguar atje prej kësaj bote. Pra, dosja jonë e cila përgatitet në këtë botë të përkohshme, do të përcaktojë cilësinë e jetës sonë në botën tjetër.

Si është bota e përjetshme? Natyrisht që askush s'ka shkuar e është kthyer. Të gjitha të dhënat në lidhje me atë vend, janë në dorë të Fuqisë hyjnore që ka krijuar këtë botë dhe atë botë. Dhe ne dimë vetëm aq sa na ka treguar Ai. Për rrjedhojë, njeriu është i detyruar të shohë informacionet që ka dhënë Allahu, kur të vlerësojë këtë botë dhe tjetrën.

A mund të thuhet, "mua nuk më intereson ajo botë"? Nuk mund të thuhet, sepse kur thuhet kështu, në mënyrë të pashmangshme, edhe kjo botë e humbet kuptimin e saj. Sepse çdo vepër, çdo sjellje, çdo ndodhi dhe çdo ekzistencë në këtë botë, duhet të ketë detyrimisht edhe dimensionin e projekcionit që pasqyrohet në botën e përjetshme.

Në vendin e përjetësisë, ka dy stacione të fundit: Xheneti, vendi i lumturive të përjetshme dhe Xhehenemi, vendi i çdolloj katastrofe, bota e dënimit, e cila do ta bëjë njeriun të dëshirojë vdekjen. Njeriu, edhe Xhenetin e tij do ta ndërtojë në këtë botë, edhe zjarrin e Xhehenemit do ta marrë nga kjo botë.

Në Kuran urdhërohet: "(Këta janë) **të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm.**" (Nisa, 165) Profetët erdhën me mesazhet hyjnore që tregojnë rrugën e Xhenetit dhe paralajmërojnë për rrezikun e rrugës së Xhehenemit, duke u bërë prijës të njerëzimit. Mesazhi i fundit hyjnor, është Kurani Fisnik, i cili ka ardhur me Profetin Muhammed (a.s.). Kush dëshiron të udhëtojë drejt Xhenetit aty do të gjejë edhe udhëzimet përkatëse të asaj rruge. Po ashtu edhe ata që duan të ruhen prej Xhehenemit. Madje, mbase edhe ata që mashtrojnë veten duke thënë: "**Neve nuk do të na prekë zjarri i Xhehenemit, përveçse disa ditë.**" (Al-i Imran, 24)

Atë Ditë, vetëm Allahu i takon të gjykojë. Edhe udhëtimi drejt Xhenetit fillon me vendimin e Tij, edhe dërgimi drejt Xhehenemit... Secili do të marrë shpërblimin për atë që ka bërë dhe askujt nuk do t'i bëhet as padrejtësia më e vogël. "**Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë.**" (Zelzele, 6-8)

Përmbajtja




8

Përpjekja, durimi dhe xheneti
Dr. Adem Ergyl



Shitblerja e xhenetit
Osman Nuri Topbash

34



17

14

Të fitosh pa luftuar
Ali Riza Temel



5 Nëse synimi është xheneti...
Ahmet Tashgetiren

10 Xheneti
Prof. dr. Sulejman Derin

12 Rregullat themelore për ndërtimin e
një shoqërie të virtytshme
Doç. dr. Kerim Bulladë


17 Edukimi i karakterit dhe modeli
shembullor
Prof. dr. Irfan Gyndyz

23 Punët e nevojshme
dhe të panevojshme
Xhemal Nar

24 Të shohësh mirësitë e përgjithshme
Xhafer Durmush

28 Historia e një astronauti
Muaz Erdem

29 Urtësi



50

Një Ajet 30
Një Hadith 32

El-Kahhar 40
Ilir Hoxha
Ma'kil ibn Jesar 44
Mustafa Erish
Duaja 47

Amatorë në fe... 50
Hasan Tahsin Karaman
Mbretëresha Belkis 52
Halime Demireshik
Çdo gjë dëshmon për Profetin 55
Ferid Piku

26



Duhet të bëjmë paqe
me OMGJ-të
Xhihan Tashitan

A ka mbetur ende vend për refleksion
Nuredin Nazarko

42



NËSE SYNIMI ËSHTË XHENETI...

— Ahmet Tashgetiren —

1 Një nga çështjet më të rëndësishme të besimit islam, është besimi në botën tjetër. Pra, fakti se pas jetës së kësaj bote, ekziston një botë tjetër. Njeriu nuk zhduket. Pasi të ketë mbaruar jetën e kësaj bote, ai fillon një udhëtim të ri. Besimi islam na bën të ditur se ky është një “udhëtim drejt përjetësisë”. Pra, kjo botë është e përkohshme, ndërsa bota tjetër, është përjetshme.

2 Këtë sistem nuk e ka krijuar njeriu. Ai është vetëm një prej aktorëve, të cilit i është dhënë një rol. Brenda këtij sistemi është edhe guri, edhe druri, edhe insekti... Mirëpo, njeriut i është dhënë një rol edhe në botën tjetër pas kësaj bote. Njeriu do të vazhdojë të ekzistojë edhe atje, por atje do të marrë një pozitë sipas cilësisë së dosjes së jetës që ai ka dërguar atje prej kësaj bote. Pra, dosja jonë e cila përgatitet në këtë botë të përkohshme, do të përcaktojë cilësinë e jetës sonë në botën tjetër.

3 Si është bota e përjetshme? Natyrisht që askush s’ka shkuar e është kthyer. Të gjitha të dhënat në lidhje me atë vend, janë në dorë të Fuqisë

hyjnore që ka krijuar këtë botë dhe atë botë. Dhe ne dimë vetëm aq sa na ka treguar Ai. Për rrjedhojë, njeriu është i detyruar të shohë informacionet që ka dhënë Allahu, kur të vlerësojë këtë botë dhe tjetrën.

4 A mund të thuhet, “mua nuk më intereson ajo botë”? Nuk mund të thuhet, sepse kur thuhet kështu, në mënyrë të pashmangshme, edhe kjo botë e humbet kuptimin e saj. Sepse çdo vepër, çdo sjellje, çdo ndodhi dhe çdo ekzistencë në këtë botë, duhet të ketë detyrimisht edhe dimensionin e projeksionit që pasqyrohet në botën e përjetshme. Nëse pranojmë se në atë

botë nuk ekziston një projektion, atëherë edhe veprimet në këtë botë do të jenë të zbrazëta përbrenda. Por, çdo veprim në këtë botë, sado që për ju mund të jetë i zbrazët nga brenda, për shkak se ai është i lidhur edhe me të tjerët, ai do të ketë një vlerë për ta dhe për atë tjetrin do të dalë në pah kompensimi i përjetësisë. Në të njëjtën mënyrë, një veprim që për dikë tjetër pranohet si i zbrazët, mund të ndikojë tek ju, dhe ju mund të thoni, “kjo duhet të ketë një ekuivalente/kompensim”. Madje edhe një logjikë e thjeshtë, mund ta shohë të nevojshme ekzistencën e një bote ku do të jepet kompensimi i merituar për sjelljet të cilave nuk u jepet kompensimi i tyre në mënyrë të mjaftueshme në këtë botë. Ja pra, Islami e quan këtë “bota tjetër”.

5 I Dërguari (a.s.), i cili i është dërguar njerëzimit nga Ai që ka krijuar gjithësinë dhe ka vendosur ekuilibrin midis kësaj bote dhe botës tjetër, ka thënë: “*Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!*” (Buhari, Rikak, 1.) Ndërsa ajo që kërkohet prej birit të njeriut në këtë botë, është “*të kërkojë botën tjetër*”¹ me ato që i janë dhënë. I nderuari Mevlana ka thënë: “Në fakt, çdo çast, një pjesë e



shpirtit tënd është në një gjendje të vdekur. Çdo çast, është koha për të dhënë shpirt dhe çdo çast konsumon jetën tënde.” Edhe nëse njeriu nuk e pranon vendin që i është caktuar në ekuacionin midis dy botëve (dynja-ahiret), ai nuk mund t’i kundërvihet dot “udhëtimit drejt vdekjes çast pas çasti”.

6 E arsyeshme dhe e drejtë për njeriun, është që ai të pranojë të vërtetën dhe në bazë të saj të ndërtojë jetën e kësaj bote. Dhe, kur të bëhet fjalë për cilësinë e jetës së kësaj bote, të paktën të jetë një jetë e cila “mund të mbrohet në botën tjetër”. Por, nuk duhet harruar se kjo “mbrojtje” do të zhvillohet në prezencë të Allahut të Madhëruar, në takimin me Të dhe nën dëshminë e “kiramen katibin-ëve”, të cilët janë regjistruarit e çdo gjëje që njeriu vepron dhe nuk vepron në jetën e kësaj bote deri në detajin më të vogël dhe me precizitetin e kamerave më të sofistikuar.

7 Në këtë pikë, kujdesi më i madh duhet të tregohet në çështjen e “mos harresës”, sepse jeta e kësaj bote, të bën të harrosh dhe, njeriu është i dobët. Për këtë arsye ai paralajmërohet me mesazhin hyjnor: “*O njerëz! Frikësojuni Zotit tuaj dhe frikësojuni Dytës, kur prindi nuk do të mund ta ndihmojë aspak fëmijën e vet, e as fëmija nuk do të mund ta ndihmojë sado pak prindin e vet! Premtimi i Allahut është vërtet i sigurt, prandaj mos e lini jetën e kësaj bote t’ju mashtrojë dhe as djallin mos e lini t’ju mashtrojë për Allahun.*” (Lukman, 33)

8 Në vendin e përjetësisë, ka dy stacione të fundit: Xheneti, vendi i lumturive të përjetshme dhe Xhehenemi, vendi i çdolloj katastrofe, bota e dënimit, e cila do ta bëjë njeriun të dëshirojë vdekjen². Njeriu, edhe Xhenetin e tij do ta ndërtojë në këtë botë, edhe zjarrin e Xhehenemit do ta marrë nga kjo botë.

9 Në Kuran urdhërohet: “(Këta janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut, pas ardhjes së të dërguarve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijsëm.” (Nisa, 165) Profetët erdhën me mesazhet hyjnore që tregojnë rrugën e Xhenetit dhe paralajmërojnë



për rrezikun e rrugës së Xhehenemit, duke u bërë prijës të njerëzimit. Mesazhi i fundit hyjnor, është Kurani Fisnik, i cili ka ardhur me Profetin Muhammed (a.s.). Kush dëshiron të udhëtojë drejt Xhenetit aty do të

2. shih. Zuhruf, 74-77; Fatir, 36.

gjejë edhe udhëzimet përkatëse të asaj rruge. Po ashtu edhe ata që duan të ruhen prej Xhehenemit. Madje, mbase edhe ata që mashtrojnë veten duke thënë: **“Neve nuk do të na prekë zjarr i Xhehenemit, përveçse disa ditë”** (Al-i Imran, 24)

10

Atë Ditë, vetëm Allahut i takon të gjykojë. (En-am, 62) Edhe udhëtimi drejt Xhenetit fillon me vendimin e Tij, edhe dërgimi drejt Xhehenemit... Secili do të marrë shpërblimin për atë që ka bërë dhe askujt nuk do t'i bëhet as padrejtësia më e vogël. **“Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë”** (Zelzele, 6-8)

11

Çmimi i Xhenetit... Është vendosur para njeriut në formën e një harte në Librin e Allahut dhe në hadithet e Profetit (a.s.). Biri i njeriut nuk është lënë i paudhëzuar, që të mund të thotë, “si t'ia bëjë që të gjejë rrugën e vendit të lumturisë së përfundimtare?”, ose “cilët hapa më çojnë drejt humbjes së përfundimtare?”. Madje, mirësia hyjnore është aq e madhe, sa edhe pse ka krijuar njeriun, gjithësinë dhe vetë Xhenetin, Allahu bën fjalë për një shitblerje: **“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit. ...E kush i përmbahet premtimit më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitblerjeje! Kjo është fitorja madhështore.”** (Teube, 111) Çështja fokusohet tek kushtimi i jetës dhe i pasurisë vetëm për Allahun. Njeriu duhet ta vërë edhe jetën, edhe pasurinë në rrugën e Allahut, ndërsa Allahu

do t'i përgatisë atij shpërblimin e Xhenetit, pavarësisht se edhe jeta, edhe pasuria janë mirësi të Allahut.

12

Çdo të thotë t'ia kushtosh Allahut jetën dhe pasurinë? Nëse njeriu arrin të formojë një disiplinë jete me epiqendër kënaqësinë e Allahut, edhe gjumi i tij mund të kthehet në një shkallë të udhëtimit të tij drejt Xhenetit. Në Kuran, në ajete të ndryshme kuadri i karakterit kryesor në marshimin drejt horizontit të Xhenetit, qëndron mbi bazën e “besimit dhe veprës së singertë”. **“Ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të pranohen në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku, me lejen e Zotit të tyre, do të banojnë përherë. Atje do të përshëndeten me fjalën: «Selam!»”** (Ibrahim, 23) Besim, do të thotë t'ia kushtosh Allahut të gjithë ekzistencën tënde dhe që botëkuptimin, “prej tij kemi ardhur, tek Ai do shkojmë”, ta kthesh në një gjendje të pjekurisë shpirtërore. Ndërsa vepër e singertë, do të thotë të bësh një jetë plotësisht me sjellje, prej të cilave Allahu do të jetë i kënaqur. Ky është lloji i jetës, të cilin i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka cilësuar, “Hasune islamuhu / Islami i tij u zbukurua”. Po ashtu, kjo nënkupton edhe kënaqësinë e Allahut në fushat e jetës të cilat kategorizohen si adhurim, moral dhe vepra. E parë nga kjo pikëpamje, edhe dhënia e ujit një qeni që është tharë nga etja, është diçka që i hap njeriut rrugën e Xhenetit. Po kështu është edhe mirësjellja ndaj familjes, përkëdhelja e kokës së një jetimi, heqja nga rruga e gjërave që pengojnë kalimin e njerëzve, fjala e bukur, gëzimi i zemrës së një myslimani, buzëqeshja, etj... dhe, natyrisht që e tillë është edhe vënia e jetës dhe e pasurisë në shërbim të fesë së Allahut të Madhëruar..

Në Kuran urdhërohet: **“...Jepini Allahut një hua të mirë!..”** (Muz-zemmil, 20) Pra, nëse njeriu jep çfarë ka e çfarë nuk ka -që në fakt edhe ato ia ka dhënë vetë Allahu- në ndihmë të nevojtarëve, do të thotë se ai ia ka dhënë Allahut si hua. Gjithashtu, në Kuran thuhet se, **“Allahu i merr sadakatë”**, gjë e cila nënkupton se çfarëdo mirësie që bën njeriu ndaj nevojtarëve, është sikur ato ia janë dhënë Allahut në dorë. Më vonë, vjen dita kur Allahu i Madhëruar u drejtohet atyre që e kanë kaluar sprovën e devotshmërisë dhe u thotë: **“Hyni midis robërve të Mi dhe në xhenetin Tim!”**. Huaja më e bukur, kthehet në mënyrën më të bukur, me Xhenet. Lum si ata që e plotësojnë me sukses sprovën e devotshmërisë dhe arrijnë shpërblimin e Xhenetit!





Përpjekja, **Durimi dhe Xheneti**

— Dr. Adem Ergyl —

Zoti ynë i Madhëruar ka krijuar realitetin e jetës dhe të vdekjes për realizimin e sprovës së devotshmërisë së njeriut dhe i tregoi atij synimin e Tij, që është “veprimi i punëve dhe sjelljeve më të bukura”¹. Po ashtu, Ai i ka dhënë myzhdënë e mirë njeriut, se “ata të cilët veprojnë punët më të mira, do të kenë shpërblime të shumëfishta”² Komentuesit e Kuranit, janë shprehur se fjala “el-husna”, që përdoret në ajet dhe e cila përkthehet “shpërblimi më i bukur”, nënkupton Xhenetin, ndërsa fjala “zijade”, e cila përkthehet, “më shumë”, nënkupton “kënaqësinë hyjnore dhe shikimin e bukurisë së Allahut”. Nuk duhet harruar se së bashku me këto mirësi hyjnore, mund të ketë edhe shumë shpërblime të bukura si në këtë botë, ashtu edhe në atë botë, në këmbim të punëve më të mira e më të sinqerta.

Xheneti është vendi i manifestimit të kënaqësisë hyjnore. Nisur nga kjo, kërkimi i Xhenetit, në një farë kuptimi do të thotë të zotërosh vullnetin për të arritur pjekurinë e një devotshmërie me të cilën do të fitohet kënaqësia hyjnore. Ja pra, për këtë arsye, duke filluar që prej profetëve, të gjithë robërit e mirë

të Allahut, kanë kërkuar strehim tek Allahu prej Xhehenemit, që është manifestimi i zemërimit hyjnor dhe i janë përgjëruar Atij për Xhenetin, që është manifestimi i mëshirës dhe kënaqësisë së Tij.³

Ndërsa fjalët e disa sufive, të cilët të dehur nga dashuria për Zotin, kanë thënë: “E ç’është tjetër Xheneti, përveçse ca qoshka dhe ca hyri!? Jepua atyre që e duan, por mua më duhesh Ti dhe vetëm Ti!”, duhen kuptuar drejtë. Prandaj dhe thuhet se, “të dashuruarit i falet”. Mirëpo, t’i thuash këto fjalë edhe pse nuk je në atë gjendje, do të thotë të pretendosh diçka që i shkel kufijtë.

Zoti ynë i Madhëruar, i fton robërit e Vet drejt Xhenetit.⁴ Madje, Ai dëshiron që ata të garojnë në këtë rrugë.⁵ Gjithashtu, Allahu na tërheq vëmendjen se një aventurë jete e cila nuk përfundon me shpëtimin prej Xhehenemit dhe hyrjen në Xhenet, nuk është as sukses dhe as triumf, por një humbje e madhe, një disfatë e hidhur dhe një dënim i dhimbshëm.⁶

1. shih. Mulk, 2.

2. shih. Junus, 26.

3. shih. Furkan, 65-66.

4. shih. Bekare, 221.

5. shih. Hadid, 21.

6. shih. Al-i Imran, 185.

Në shumë ajete të Kuranit Fisnik na jepet përshkrimi i Xhenetit, ku numërohen mirësitë që i pëlqejnë njeriut. Aty premtohet pothuajse çdo gjë që njeriu mund të dëshirojë, si vreshta, kopshte, vila, lumenj, përrenj, ushqime, pije, veshje, miq, bashkëshorte të pastra, etj... Madje, nuk bëhet fjalë për një kohë të shkurtër, por për përjetësi. Mirëpo, këto premtime nuk jepen ashtu kuturu. Aty numërohen edhe kushtet, ose çmimi që duhet paguar për to. Në përgjithësi, çmimi i këtyre paguhet me jetë dhe pasuri.⁷ Ndërsa ata që e kalojnë jetën e tyre me punë të padobishme dhe të kota, nuk mund të shpresojnë të përfitojnë prej këtyre mirësive. Padyshim se, mirësia e Xhenetit nuk është një rezultat që ne e meritojmë me ato që bëjmë, por një mirësi e mëshirës së gjerë të Zotit tonë, i Cili është Rrahman dhe Rrahim. Mirëpo, për nga aspekti i të qenit shkak i këtyre mirësive, duke filluar që prej besimit, të gjitha veprat e mira, si përpjekja, adhurimet, bindja, etj., kanë një rol shumë të rëndësishëm. Lidhur me këtë çështje, është e mundur të përmendim shumë ajete fisnike. Për rrjedhojë, është me dobi që këtu të japim disa prej tyre, me qëllim që të përballemi direkt me fjalën e Zotit tonë të Madhëruar:

“...Një zë do t'i thërrasë: «Ky është Xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar!»” (A'raf, 43)

“Dhe kushdo që bën vepra të mira, qoftë ai mashkull ose femër, duke qenë besimtar, do të hyjë në Xhenet dhe nuk do t'i bëhet asnjë padrejtësi.” (Nisa, 124)

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, përgëzoji me kopshte të Xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj!..” (Bekare, 25)

Nga këto ajete dhe të tjera të ngjashme me to, kuptojmë se, arritja e Xhenetit kërkon sakrificë. Ndërsa ata që shpresojnë të trashëgojnë Xhenetin pa paguar asnjë çmim, paralajmërohen kështu nga Allahu i Madhëruar:

“A mendoni se do të hyni në Xhenet, pa i provuar Allahu ata që kanë luftuar prej jush dhe pa i provuar ata që kanë duruar?” (Al-i Imran, 142)

Edhe vetë Xheneti, është një vend mirësish që ka disa nivele. Pra, në një farë kuptimi, nuk është vetëm një Xhenet, por disa xhenete. Dhe, arritja e atyre niveleve, është sipas punëve. Lidhur me këtë çështje, në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Secili do të ketë shkallën e tij, sipas veprave

që ka bërë. Zoti yt nuk është i paditur për veprat e tyre.” (En'am, 132)

Gjithashtu, Zoti ynë i Madhëruar, në Kuranin Fisnik ka deklaruar se, ata që nuk punojnë dhe ata që përpiqen për mirë, nuk do të jenë kurrë të barabartë. Për rrjedhojë, ata që përpiqen dhe sakrifikojnë, do të kenë grada shumë më të larta se ata që nuk punojnë.⁸

Ndërsa cilësitë e besimtarëve që do të trashëgojnë “Xhenetin Firdeus”, i cili është një vend i veçantë ndër të gjithë xhenetet, përmenden në këtë mënyrë: 1. Ata janë të përkushtuar në namazet e tyre. 2. Qëndrojnë larg prej fjalëve dhe punëve të kota. 3. Përpiqen shumë për të dhënë zekat dhe për t'u pastruar. 4. Ruajnë nderin dhe namusin e tyre. 5. I respektojnë me rigorozitet amanetet. 6. Janë besnikë ndaj fjalëve dhe premtimeve të tyre. 7. Janë të vazhdueshëm në namazet dhe lutjet e tyre dhe këto i bëjnë në mënyrën më të bukur.⁹

Udhëtimi drejt Xhenetit, ndonjëherë është rrugë e drejtë, e ndonjëherë rrugë e përjetë ose tatëpjetë. Për rrjedhojë, ajo që do të na ndihmonte më shumë në këtë udhëtim, është durimi dhe qëndresa. Durimi është një element i domosdoshëm për t'u larguar prej gjynaheve, për t'i thënë “ndal” dëshirave të panevojshme dhe të rrezikshme të egos, për të qenë i vazhdueshëm në bindje, adhurime, punë të mira, e shërbime dhe për të qenë të suksesshëm në të gjitha sprovat e llojllojshme të jetës. Kjo është edhe arsyeja që Zoti ynë i Madhëruar thekson se të duruarit, janë ata që do të fitojnë shpërblimin e Xhenetit. Për shembull, në suren Furkan, në pjesën që prej ajetit 62, e deri në ajetin 74, numërohen cilësitë e robërve të mirë të Rrahmanit dhe, pasi thuhet se atyre do t'u jepen xhenetet, tërhiqet vëmendja në sekretin që i ka bërë ata të arrijnë këto cilësi dhe shpërblime:

“Njerëz të tillë do të shpërblehen me Xhenet të lartë për durimin e tyre, do të mirëpritën dhe do të gjejnë paqe!” (Furkan, 75)

“Unë i kam shpërblyer ata sot për durimin e tyre, e ata, me të vërtetë, janë të shpëtuar.” (Mu'minin, 111)

Shkurtimisht, ata do ta gëzojnë mirësinë e Xhenetit në sajë të besimit, punëve të mira e të singerta, përpjekjes në rrugë të Allahut, durimit dhe qëndrës së madhe përballë vështirësive dhe vuajtjeve dhe mirësisë së mëshirës hyjnore.

8. shih. Nisa, 95-96.

9. shih. Mu'minin, 1-11.

7. shih. Teube, 111.

XHENETI

— Prof. dr. Sulejman Derin —

Allahu i madhëruar, në Kuranin Fisnik, na fton ne besimtarët në xhenetet e Tij dhe flet për shumë mirësi që Ai ka përgatitur për ne atje. Kopshte poshtë të cilëve rrjedhin lumenj prej ari, vila prej sedefi, bashkëshorte të bukura dhe shërbyes të mrekullueshëm. Mirë, po pavarësisht kësaj ftese që na bën Zoti ynë, cila është arsyeja e qëndrimit që duket “nënçmues” ndaj këtyre mirësive dhe i cili mund të përmbledhet me fjalët e poetit Junus Emre: “E ç’është tjetër Xheneti, përveçse ca djelmosha dhe ca hyri!”

Pikësëpari duhet të theksojmë se, sufitë (e vërtetë), për të hyrë në Xhenet janë gati të sakrifikojnë në rrugën e Allahut jetën, pasurinë dhe gjithçka kanë prej atyre që Zoti ynë i ka kërkuar në Kuran. Madje, ata u paraprijnë të gjithëve në çështjet e adhurimeve, farz apo nafile qofshin. Ata falin shumë namaz, japin zekat me bollëk dhe gjithë kohën e gjallërojnë me përmendjen e Allahut.

Allahu ka premtuar Xhenetin për të gjithë ata që i kryejnë këto. Mirëpo, sufitë dëshirojnë diçka tjetër përtej këtyre mirësive. Ajo që dëshirojnë ata, është Zoti i tyre i Madhëruar. Mevlana, Ibn Arabiu, Junus Emre, e madje edhe Imam Rabbani, i cili njihet për aspektin e tij më shumë të lidhur pas sheriatit ndër

të gjithë sufitë, pothuajse të gjithë të mëdhenjtë e tasavufit, janë të mendimit se shikimi i Fytyrës së Allahut dhe fitimi i kënaqësisë së Tij, janë më të vlefshëm se Xheneti. Siç shprehet edhe Mevlana, Allahu i Madhëruar i jep jetë atij që jep jetën dhe pasurinë e tij më të çmuar në rrugë të Allahut dhe e bën atë meritör që të shohë Fytyrën e Tij. Ndërsa ata që nuk japin jetën, por vetëm pasurinë e tyre, pra, atyre që japin bukën, do t’u jepet bukë.

Në fakt, shembulli i pashoq që ndjekin sufitë në këtë çështje, është i Dërguari i Allahut (a.s.). Edhe pse i kishte të falura gjynahet e shkuara dhe të ardhme, ai vazhdonte të falte namaz derisa i ënjteshin këmbët dhe nënës sonë Aishe (r.a.), e cila i kishte kërkuar të mos e lodhte aq shumë veten, i ishte përgjigjur: “A të mos jem një rob që e falënderon Allahun?”

Punët e mira dhe adhurimet e bëra nga njerëzit e thjeshtë me dëshirën për të arritur Xhenetin, edhe Imam Rabbani i sheh si të mira. Mirëpo, qëllimet e tjera përveç “shikimit të Allahut”, konsiderohen si të gabuara nëse bëhen nga robërit që janë të afërt me Allahun (mukarrabin):

“Qëllimi i udhëtimit shpirtëror në sufizëm, është purifikimi dhe pastrimi i nefsit emmare. Në sajë të këtij pastrimi është e mundur të shpëtohet prej vepërës së “adhurimit të zotave të remë”, që buron prej dëshirave të egos, nuk mbetet asnjë drejtim (kible) tjetër për t’u orientuar përveç Allahut dhe njeriu nuk zgjedh asnjë synim fetar apo të kësaj bote. Edhe pse qëllimet dhe synimet fetare janë të llojit të mi-

rësisë, këto janë punët e njerëzve të mirë (ebrarin). Ndërsa mukarrabinët (njerëzit e afërt me Allahun), i konsiderojnë këto si gabime, sepse ata nuk quajnë qëllim apo synim asgjë tjetër përveç Allahut një e të vetëm.” (shih. Mektubat, V. I, letra 35.)

Sipas Imam Rabbanit, kjo gjendje e udhëtarit në rrugën shpirtërore, shfaqet pas realizimit të dashurisë së veçantë ku edhe mirësia edhe vuajtja janë të barabarta. Edhe sufiu që arrin këtë gradë dëshiron Xhenetin si gjithë të tjerët, por halli i tij nuk janë vetëm arritja e mirësive të Xhenetit, por edhe takimi me Pronarin e Xhenetit:

“Nëse sufite dëshirojnë Xhenetin, e dëshirojnë atë si një vend me të cilin Allahu i Madhëruar është i kënaqur. Pra, ndërkohë që dëshirojnë Xhenetin, ata mendojnë për kënaqësinë e Allahut. Në të njëjtën kohë, kur ruhen prej Xhehenemit, ata ruhen sepse është vendi me të cilin Allahu dënon. Qëllimi në dëshirimin e Xhenetit, nuk është arritja e kënaqësisë. Po ashtu, edhe ruajtja prej Xhehenemit, nuk është ikje prej vështirësisë dhe vuajtjeve. Kjo, sepse sipas tyre, çdo gjë që vjen prej të “dashurit” (Allahut të Madhëruar), është e bukur dhe diçka që duhet kërkuar. Çdo gjë që bën i dashuri, është e dashur dhe e bukur. Këtu shihet edhe e vërteta e singeritetit. Në këtë shkallë shpëtohet edhe prej zotave të rremë. Këtu kuptohet saktë edhe Kelime-i Teuhid. (Mektubat, V. I, Letra 35.)

Atë që Imam Rabbani e ka shprehur në prozë, Mevlana i nderuar e ka shprehur në poezi në veprën e tij Mesnevi:

Nëse një i dashuruar sheh dikë tjetër përveç njeriut që dashuron, ai nuk është me të vërtetë i dashuruar. Dashuria e tij, është një dëshirë e kotë!

Dashuria (e vërtetë), është një zjarr i tillë, i cili kur merr flakë djeg dhe shkrumbon çdo gjë tjetër përveç njeriut që dashuron.

Shpata e “La”-së, pret, fshin dhe zhduk çdo gjë përveç “dashurisë së Hakut”. Pa shiko, çfarë ka mbetur pas “La”-së?

Vetëm “il-lallah”! Çdo gjë iku, u zhduk! Rrofsh o dashuri e madhe, që djeg dhe shkrumbon dyzimin, shoqërimin dhe ortakërinë! (Mesnevi, V. 5, 587-590.)

Imam Rabbani e shpjegon kështu faktin se përse sufite nuk duan të bëhen prej atyre që punojnë për hir të Xhenetit:

Dashuria në zemër, nuk mund të lidhet më tepër se me një gjë të vetme. Kur zemra lidhet me dashuri pas diçkaje, nuk e do diçka tjetër. Ndërsa kur njeriu ka më tepër se një dëshirë, si dashuria për pasuri, fëmijë, pozitë të lartë, lëvdata, etj., pas të cilave lidhet së tepërmi, në fakt ai dashuron vetëm një gjë. Dhe kjo është vetja-egoja e tij. Dashuria për ato

(fëmijët, pasurinë, etj.), është për shkak të dashurisë që ka për veten e tij, sepse ky person nuk i do ato për shkak të vetes së tyre, por për veten e vet. Kur humbet dashuria ndaj vetes, pas saj humbet edhe dashuria për të tjerat. Për këtë arsye, është thënë: “Perdja midis robit dhe Zotit, është egoja-vetja e njeriut, jo dynjaja”. Kjo, sepse vetë bota nuk është diçka që njeriu e dëshiron, e që ajo të jetë perde. Dëshira e robit është vetëm vetja e tij. Dhe si rezultat i detyrueshëm i kësaj, perdja është vetë njeriu, e asgjë tjetër.

Nëse robi nuk zhvishet komplet prej dëshirës së egos-vetvetes, Zoti nuk mund të jetë dëshira e tij dhe dashuria për Të nuk strehohet në zemrën e tij. Dhe kjo mirësi, nuk arrihet pa u realizuar shkëputja e plotë e lidhjes së dashurisë me veten, sepse zhdukja e plotë e errësirës, arrihet vetëm pas lindjes së plotë të diellit. (Mektubat, I, Letra 24.)

Sipas Imam Rabbanit, kënaqësia e Allahut, është më e rëndësishme se Xheneti. Ndërsa zemërimi i Tij, është më i rëndësishëm se sa dënimi i Xhehenemit. E thënë ndryshe, sufiu nuk nënvleftëson dënimin ose Xhenetin e Allahut. Përkundrazi, ai i drejtohet Pronarit të Xhenetit dhe të Xhehenemit. Këtë gjendje, Imam Rabbani e shpjegon kështu:

“Nëse i lëmë të gjitha mirësitë mënjane, cila lumturi mund të jetë e barabartë me kënaqësinë e Allahut si shpërblim për sjelljen e robit? Po ashtu, cila vuajtje dhe torturë mund të jetë e barabartë me vuajtjen e robit që ka merituar zemërimin e Zotit të vet për shkak të sjelljeve të tij? Pra, në Xhenet, kënaqësia e Allahut të Madhëruar, është më e ëmbël se sa të gjitha mirësitë e Xhenetit. Ndërsa në Xhehenem, pakënaqësia dhe zemërimi i Allahut të Madhëruar, është më e hidhur se sa vuajtjet e Xhehenemit. (Letra 73.)

Këto fjalë të singerta të sufive, ndonjëherë bëhen si çamçakëz në gojën e personave që nuk ia kanë haberin këtyre çështjeve dhe për këtë arsye, qëllimi i vërtetë i sufive është anashkaluar. Këto fjalë të sufive, mbase janë thënë kur ata kanë qenë në gjendjen e tyre të veçantë. Prandaj, t’i imitosh ata pa ditur asgjë nga gjendja e tyre, nuk është e lejueshme. Fjalët që thonë sufite për shkak të afrimitetit të singertë që ndjejnë ndaj Allahut, u duhen atribuuar vetëm atyre dhe në lidhje me ta, duhet menduar në mënyrë pozitive. Ndërsa fjalëve të atyre që nuk kryejnë as minimumin e detyrave të tyre si robër të Allahut, nuk u duhet dhënë asnjë vlerë.

Allahu i Madhëruar na shpërbleftë të gjithëve edhe me kënaqësinë e Tij, edhe me xhenetet që na ka premtuar. Po ashtu, Allahu na ruajtë të gjithëve nga pasimi i të paditurve dhe nga mendimi i keq për njerëzit e devotshëm!

Amin!..



RREGULLAT THEMELORE

në ndërtimin e një shoqërie të virtytshme

— Doç. dr. Kerim Bulladë —

“O Besimtarë! ... Ndhimoheni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër!” (Maide, 2)

Ky mesazh, që përbën një pjesë të ajeti 2 të sures Maide, është një nga përgjegjësitë më të rëndësishme që Kurani u ngarkon atyre që i besojnë atij. Mësimet që përmenden në ajetin e mësipërm, janë kriteret më themelore që Kurani kërkon për formimin e personalitetit të besimtarit dhe për ndërtimin e një shoqërie të pastër. Termat, “birr/mirësi”, “takua/devotshmëri”, “ithm/gjynah” dhe “uduan/armiqësi”, të cilat përdoren në ajet, mbase janë termat më gjithëpërfshirës që e shpjegojnë më mirë qëllimin e shpalljes së fundit hyjnore, Kuranit dhe, se çfarë lloj njerëzimi dhe jete shoqërore kërkon ai. Kurani, kërkon një shoqëri ku boshti kryesor është paqja, ku njerëzit ndihmohen me njëri-tjetrin në mirësi, qëndrojnë larg armiqësisë dhe para së gjithash, kanë përvetësuar vetëdijen e devotshmërisë dhe frikës ndaj Allahut, duke qëndruar larg të këqijave. Me qëllim që kjo çështje të kuptohet më qartë, është me dobi të qëndrohet pak tek këto terma që përdoren në ajet:

1- Birr

“el-Birru”: Ka kuptimet, ndershmëri, fjalë-drejtë, besnikëri, bindje, mirësi, bamirësi, vepër e mirë që të afron tek Allahu, të tregohesh i mirë, të jesh i përlulur, të sillësh me respekt, të gostitësh njerëzit, t’i bindesh prindërve dhe të sillësh mirë me ta, etj.

Nëse nisemi nga kuptimi leksikor i fjalës “el-Birru”, kuptojmë se Allahu i Madhëruar kërkon prej besimtarëve të veprojnë me mirësi, besnikëri dhe të ndihmohen me njëri-tjetrin në punë të mira. Ai i urdhëron ata të jenë besnikë në fjalët e tyre, të sillen me respekt ndaj njëri-tjetrit, t’i binden prindërve dhe të ndërtojnë një bashkësi të shëndetshme. E thënë me pak fjalë, Allahu i Madhëruar, dëshiron prej besimtarëve që ata të ndërtojnë një shoqëri që i bindet Atij, është besnike dhe e pastër nga gjynahet.

2- Takua

“et-Takua”, rrjedh prej rrënjës “ueka-jeki-uikajeten” dhe do të thotë: Të kesh frikë, të ruash diçka, të mbrosh, të kujdesesh për diçka, të ruash veten, të jesh i kujdesshëm, të mbrohesh prej gjërave që të dëmtojnë, etj. Fjala takua, përmban kuptimet si, të kesh frikë prej Allahut, të bësh kujdes ndaj hallallit dhe haramit, të sigurosh mbrojtje ndaj diçkaje të rrezikshme, etj. Ndërsa kuptimi terminologjik i fjalës takua, është, “të ruash veten prej gjërave që bëhen shkak për hyrjen në gjynahe”.

Termi “takua”, është një prej termave kryesor të Kuranit. Allahu i Madhëruar, kërkon që njeriu, e në mënyrë të veçantë besimtari, t’i rregullojë të gjitha veprat e tij në lidhje me këtë botë dhe botën tjetër, në bazë të kriterëve të “takua-s”. Për shkak të rëndësisë që ka, forma paskajore e këtij termi, “el-uikaje”, së bashku me format e tjera të saj, përdoret 258 herë në Kuran. Ky fakt, tregon qartë rëndësinë e

madhe që ka termi “takua” në përbërjen semantike/kuptimore të Kuranit.

Fjala “ittika”, do të thotë, të kesh frikë prej Allahut dhe të ruhesh prej haramit dhe gjërave të dyshimta. Kjo gjendje quhet “takua”, ndërsa personi që ka këtë cilësi, quhet “muttaki”. Një njeri që është “muttaki”, do të thotë se është një njeri i besueshëm dhe prej tij nuk vjen asnjë e keqe. Në pikëpamjen Islame, njerëzit janë të barabartë me njëri-tjetrin dhe superioriteti mund të jetë vetëm në “takua”.

Muttaki, është ai që ka respekt të thellë për Allahun. Ata që ndajnë respekt për Allahun, kanë respekt edhe për robërit e Tij dhe për të drejtat e tyre. Për këtë arsye, Kurani kërkon një sistem shoqëror ku mbizotëron takua. Dhe kjo është e mundur vetëm nëse besimtarët ndihmohen ndërmjet njëri-tjetrit në çështjen takuas. Largimi prej haramëve, plotësimi i farzeve, mbizotërimi i drejtësisë, ruajtja e të drejtave vëllazërore, shërbimet e bamirësisë, ruajtja prej gjynaheve, ndihmesa mes njeri-tjetrit në kryerjen e adhurimeve, etj., janë nga detyrat më të rëndësishme që Kurani ua ngarkon besimtarëve. Pa u plotësuar këto rregulla të rëndësishme, duket e pamundur të ndërtohet një shoqëri e virtytshme dhe një personalitet “muttaki”. Shoqëria Islame dhe Qytetërimi Islam i cili është themeluar mbi këtë shoqëri, është ndërtuar dhe ka marrë formë mbi themelet e takuas.

Në lidhje me termin e “takuas”, është bërë edhe një përkufizim që përfshin kuptimin e kryerjes së detyrave fetare dhe morale dhe ruajtjen prej sjelljeve dhe qëndrimeve të cilat konsiderohen të rrezikshme nga feja dhe morali. Nëse e mendojmë kuptimin e ajetit duke u nisur nga kjo, bëhet e qartë se ndihmesa e besimtarëve ndërmjet njëri-tjetrit në luftën kundër të këqijave në shoqëri dhe në parandalimin e tentativave që prishin rregullin shoqëror, ka një rëndësi shumë të madhe. Termi “takua”, që shpreh kapjen pas urdhrave të Allahut dhe largimin në mënyrë rigoroz nga ndalesat e Tij, përbëjnë themelin e drejtësisë, durimit, vetëmohimit, mjaftueshmërisë, mëshirës, shkurtimisht të të gjitha virtyteve.

Nëse do të marrim parasysh domosdoshmërinë e drejtësisë në sistemin e jetës shoqërore, del në pah se “takua-ja”, tashmë nuk përbën vetëm një virtyt individual, por në të njëjtën kohë është edhe një domosdoshmëri e sistemit shoqëror. Nisur nga kjo, takuaja është një parim i rëndësishëm i cili vë rregull në jetën e individit dhe të familjes së tij.

3- Ithm

Fjala “ithm”, e cila përfshin kuptimet, gjynah, krim, faj, etj., rrjedh prej rrënjës “ethime-jethimu”, ndërsa shumësi i saj është “atham”. Ky është emri

i veprave që vonojnë ose ngadalësojnë sevapin. “Ithm”, është veprimi i diçkaje që nuk është hallall. Ithm është quajtur kumari, alkooli dhe gënjeshtria. Kjo fjalë është pranuar si antonimi i fjalës “birr”. Nëse fjala “birr” shpreh veprimin që kënaq shpirtin (qetëson ndërgjegjen dhe të jep gëzim), fjala “ithm”, shpreh diçka që të ther zemrën. Ithm-i është diçka që edhe logjikisht, edhe ligjërisht është e detyrueshme t’i qëndrosh larg. Ithm, është gjynahu që e bën njeriu të meritojë dënim. Me të, mund të shprehen vetëm gjërat që janë haram.

Midis fjalës “ithm” dhe “dhemb” ka disa dallime. “Dhemb”, është gjynahu që bëhet me dije ose padije, ndërsa “ithm”, është gjynahu që bëhet me dije, me dashje dhe që meriton dënim.

Siç mund të kuptohet nga të gjitha këto shpjegime, Allahu i Madhëruar, ka kërkuar që besimtarët të mos ndihmohen ndërmjet vete në kryerjen e veprimeve që sheriat i konsideron gjynahe, të largohen prej haramëve si, alkooli, kumari dhe gënjeshtria dhe të mos e mbështesin kryerjen dhe përhapjen e këtyre. Gjynahu është një veprim që prish shoqëritë dhe eliminon paqen dhe qetësinë. Gjynahu është pengesa më e madhe në ndërtimin e një shoqërie të pajisur me virtyte morale, të drejtë dhe të ndërgjegjshme. Gjynahet janë ato që shkatërrojnë qytetërimet dhe bëhen shkak të ardhjes së fatkeqësive nga qielli dhe nga toka.


4- Uduan

Termi “uduan”, rrjedh nga rrënja “ada” dhe ka kuptimet; armiqësi, të mbash qëndrim armiqësor, të bësh zullum, të sulmosh, të kalosh kufijtë, etj.

Nisur nga këto kuptime, është e qartë se Allahu i Madhëruar në suren Maide, ajeti 2, kërkon prej besimtarëve të mos ushqejnë armiqësi ndaj njëri-tjetrit dhe të mos e ndihmojnë njëri-tjetrin në armiqësi, zullum, në moszbatimin e drejtësisë dhe të tjera veprime të ngjashme. Me pak fjalë, në ajetin e mësipërm, Allahu i Madhëruar kërkon prej besimtarëve të jetojnë si vëllezër, të ndërtojnë një shoqëri të virtytshme, të sigurojnë mbizotërimin e moralit të bukur dhe drejtësisë dhe të mos e ndihmojnë njëri-tjetrin në armiqësi dhe gjynahe.

Është shumë e qartë se myslimanët e kanë të domosdoshme ta ndihmojnë njëri-tjetrin në fushën ekonomike dhe shoqërore. Ajeti i mësipërm e shpreh në mënyrë shumë të qartë se besimtarët duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në fushën shpirtërore, në kryerjen e adhurimeve, në ruajtjen prej gjynaheve dhe qëndrimin larg prej tyre. Në mënyrë të veçantë, theksohet domosdoshmëria e këtyre rregullave në ndërtimin e një shoqërie islame.

Allahu e di më mirë!



Të fitosh pa luftuar

— Ali Riza Temel —

Platoni ka thënë: *“Kur shihen nga larg dy ushtri që luftojnë, duken si një ushtri e vetme që po vetëvritet”*. Kjo thënie nxjerr në pah një të vërtetë shumë tronditëse. Thuhet se lufta nuk ka fitues. Po, dhe kjo është e vërteta lakuriq! Dy persona që luftojnë me njëri-tjetrin, do të goditen e do të plagosen që të dy.

Lufta bëhet shkak i humbjes së shumë jetëve dhe pasurive. Mbi të gjitha, është diçka që kushton shumë shtrenjtë. Ajo kërkon shumë përgatitje dhe nuk është si një operacion që bëhet për të dhënë jetë, por bëhet me qëllim vrasar. E vrasjet shkaktojnë të tjera vrasje... Urrejtja lind urrejtje, e mëshira mëshirë! Lufta është shkatërrim. Është shkatërrimi i historisë, vendeve dhe mundit. Është rrënimi i miqësisë dhe urave të zemrës... nuk është ndërtim por shfarosje!

“Për shkak se lufta përbëhet nga vrasjet, shkatërrimi dhe djegia e vendeve, në pikëpamjen islame ajo nuk konsiderohet si një veprim i lavdërueshëm.

Për sa kohë që është e mundur të jetohet në paqe dhe rehati, nuk është e nevojshme të priresh drejt luftës. Nisur nga kjo, në metodologjinë e fikhut/jurisprudencës islame, është thënë se, “xhihadi (lufta për të vrarë) në thelb nuk është një veprë e mirë, por mbase është e mirë në mënyrë indirekte”

Ngritja për luftë ndaj atyre që respektojnë të drejtat dhe nuk përpiqen të shkelin lirinë dhe lumturinë e të tjerëve, nuk është diçka e pranueshme dhe e këshillueshme nga Islami.¹

Muhamed Hamidullah, kur tregon për mënyrën e drejtimit me parim paqen të Profetit tonë (a.s.), thotë: *“Pas një veprimtarie politike aktive që zgjati dhjetë vjet, deri në momentin që dha frymën e fundit, ai drejtonte një shtet që zotëronte një hapësirë rreth dy milionë km². Numri i të vrarëve nga radhët e ushtrive armike në fushat e betejave të kësaj hapësire të madhe (brenda kësaj periudhe), ka qenë përafërsisht*

1. Ö. N. Bilmen, *Istilahat-i Fikhiye Kamusu*, 3/356-357

250. *Është e pamundur të gjesh një shembull tjetër të kësaj vlere dhe këtij respekti që i është dhënë gjakut të njeriut, në të gjithë historinë e njerëzimit.*²

Një prej këshillave të Profetit tonë (a.s.), ndaj komandantëve të vet, ishte edhe kjo: *“Mos i sulmoni ata pa i ftuar më parë në Islam. Për mua është më e dashur të m'i sillni si myslimanë me vendas e me endacakë, sesa t'i vrisni burrat e të mi sillni si robër gratë dhe fëmijët jetimë.”*

Siç e kemi shprehur edhe më parë, lufta është si një operacion, i cili është zgjedhja e fundit që duhet bërë dhe duhet të jetë me qëllim shpëtues. Ajo bëhet për t'i dhënë fund zullumit dhe për t'i treguar vendin zullumqarëve që nuk njohin asnjë të drejtë.

Të jesh pjesëtar i një feje, i një medhhebi, i një race, i një zone apo i një shteti tjetër nuk mund të jetë shkak për luftë. Ata që i janë ekspozuar një lufte vetëm për faktin se janë shtetasit e një vend tjetër, janë njerëz të shtypur dhe vrasjen e tyre nuk mund ta legjitimojë asnjë arsyetim i drejtë. Fizikani i njohur Paskali e shpreh kështu këtë absurditet: *“Ushtari hap zjarr ndaj palës tjetër. Pala tjetër i thërret ushtarit që hapi zjarr: ‘Përse më vret o njeri?’ Ushtari që hapi zjarr përgjigjet: ‘Sepse ti jeton në anën tjetër të lumit (kufirit).’* Që kur është bërë krim të jesh shtetas i një vendi tjetër?

Islame dhe njerëzore është të japësh jetë, e jo të marrësh. Të vrasësh një njeri pa të drejtë, është si të kesh vrarë të gjithë njerëzit, ndërsa shpëtimi i jetës së një njeriu, është sikur të kesh shpëtuar jetën e të gjithë njerëzve.

Me anë të luftës, dhunës dhe shtypjes mund të sundohet për një farë kohe mbi trupat, por kurrë nuk mund të sundohen mendjet dhe zemrat. Pushim i vërtetë, nuk është ai i tokave, por ai i zemrave. Vetëm kështu mund të sigurohet një atmosferë paqeje dhe qetësie e përhershme.

Këtu do të japim disa shembuj se si mund t'i fitojmë njerëzit pa zgjedhur luftën apo ndëshkimin:

Shejbe bin Osman, të cilit i ishte vrarë babai në betejën e Uhudit, mori pjesë në betejën e Hunejnit. Qëllimi i tij ishte që nëse myslimanët pësojnë disfatë, të sulmonte të Dërguarin e Allahut (a.s.) dhe të merrte hakun e babait. Në një moment kur shigjetarët Hauazinë sulmuan befasisht, ushtria myslimane u çorientua dhe i Dërguari i Allahut (a.s.), zbriti nga deveja e tij. Në këtë moment, Shejbe bin Osman nxori shpatën dhe tentoi të sulmonte të Dërguarin e Allahut (a.s.), sa nga e djathta, në të majtë. Sapo ngriti shpatën për ta goditur, para tij u shfaq një

flakë. Nga frika, ai i zuri sytë me duar dhe u tërhoq mbrapsht. Më pas mendoi se i Dërguari i Allahut (a.s.), mbrohej vërtetë nga Zoti. Ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), ktheu kokën nga Shejbe duke i buzëqeshur dhe i tha: *“Eja pranë meje!”*. Atë moment, Shejbe filloi të dridhej, sepse në zemrën e tij kishte zënë vend përnjëherësh edhe frika, edhe besimi. Kur shkoi pranë të Dërguarit të Allahut (a.s.), ai ia vuri dorën e tij të bekuar në gjoks dhe iu lut Allahut me këto fjalë: *“O Allah! Dëboje shejtanin prej tij!”* Kur Shejbe bin Osman ngriti kokën dhe pa nga i Dërguari i Allahut (a.s.), u mbush plot me dashuri për të. Ai filloi ta donte atë më shumë se çdo gjë tjetër. Kishte ardhur për të marrë hakun e babait, por ja se si e shpreh ai gjendjen e tij në ato momente: *“Luftova me gjithë shpirt për ta mbrojtur të Dërguarin e Allahut nga armiqtë. Nëse babi im do të ishte gjallë dhe do të sulmonte të Dërguarin e Allahut, unë do ta godisja me shpat dhe do ta vrisja aty në vend, për të mbrojtur të Dërguarin.”*

Shejbe bin Osman (r.a.), besoi dhe, për faljen e gjynaheve, i kërkoi të Dërguarit të Allahut (a.s.) të lutej për të. Sjellja e bukur e të Dërguarit të Allahut (a.s.), e shndërroi atë në mënyrë rrënjësore. Ai ishte një njeri, që siç shprehet edhe vet, në fillim thoshte, *“nuk bëhem mysliman edhe sikur të gjithë arabët dhe jo arabët ta pranojnë Islamin!”* Ndërsa tashmë, thoshte se, *“unë nuk ndahem prej tij, edhe sikur të ndahen të gjithë!”*

Kështu fitohen njerëzit. Nëse i Dërguari i Allahut do të dëshironte vrasjen e këtij personi që nxori shpatën për ta vrarë, do t'i kishte shkatërruar atij edhe këtë botë, por edhe botën tjetër. Mirëpo, duke e falur, e bëri atë një njeri besnik të Islamit.

Raste të tilla, kanë ndodhur shumë me Profetin (a.s.). Falja e Uahshit, i cili vrau Hamzain (r.a.), xhaxhain e Profetit në Uhud, falja e djalit të Ebu Xhehlit, Ikrimes, Safuan bin Umejjes, Suhejl bin Amrit, etj., duke ua ngrohur zemrat e tyre me Islam, janë vetëm disa shembuj të këtij fakti.

Kur i Dërguari Allahut (a.s.), arriti të çlironte Mekën, prej nga ishte detyruar të emigronte dhe ku ishte torturuar nga banorët e saj idhujtarë, ai nuk mori hak prej tyre, por u tha: *“Jeni të gjithë të lirë!”*. *“Kushdo prej banorëve të Mekës që mbyllet në shtëpi dhe nuk përdor armë, nuk do të preket. Të plagosurit nuk do të vriten, të arratisurit nuk do të ndiqen dhe robërit nuk do të vriten. Askujt nuk do t'i preket jeta, pasuria dhe familja!”* Në të vërtetë, kështu u fitua Meka, duke iu fituar zemrat! E rëndësishme, nuk është çlirimi i ndërtesave dhe i tokave, por i mendjeve dhe i zemrave.

Të urtët thonë, “njeriu është rob i mirësisë”. Mi-

2. M. Hamidullah, Hz. Peygamberin Savaslari sh. 20-21

rësia josh edhe kafshët. Qeni e mban mend gjithë jetën edhe atë që i jep qoftë vetëm njëherë bukë dhe nuk e harron atë mirësi.

Arma më e fuqishme është ajo e dashurisë. Mirëpo, kjo armë nuk është për të vrarë, por për të dhënë jetë. Është e pamundur të rezistosh para dashurisë, sepse ajo shkrin edhe akullnajat dhe e bën për një çast armikun mik.

Titullin e këtij shkrimi e kemi vendosur *“të fitosh pa luftuar”*. Ky titull, mund të ishte edhe në formën, *“të fitosh pa luftë, jo të fitosh luftën”*. Mirëpo, lufta nuk ka fitues. Madje, edhe vetë fjala “luftë”, duket e shëmtuar për njeriun, sepse ajo të kujton vdekjen, shkatërrimin, dhimbjen dhe fatkeqësinë. Ndërsa Islami të kujton paqen, dashurinë dhe miqësinë. E gjithë çështja është të arrish të hysh në këtë atmos-

ferë paqeje dhe të mos biesh në kurthin e armiqve. Dhe zgjidhja e kësaj, është t’i vëmë veshin kësaj thirrjeje të Zotit tonë të Madhëruar: ***“O besimtarë! Pranojeni Islamin me të gjitha rregullat e tij dhe mos shkonit gjurmëve të djallit, se ai është armiku juaj i përbetuar.”*** (Bekare, 208)

Nevoja jonë dhe e gjithë njerëzimit, nuk është “arma” por “shpëtimi”. Arma mund të përdoret vetëm për të arritur “shpëtimin”, por kjo duhet të jetë zgjidhja e fundit. Nëse bëhet garë për paqe në vend të garës për armë, nuk do të ketë nevojë për armë. Nëse pasuritë që shpenzohen për të vrarë, për të djegur e shkatërruar, do të shpenzoheshin për të dhënë jetë, të gjithë do të dilnin të fituar.

Ah sikur të mësonim njëherë të fitonim pa luftë!

KUR NË SHTËPI HYN HAJDUTI...

Një shembull tjetër i bukur i fitimit të zemrës së njerëzve duke i falur dhe duke u sjell me mirësi, është edhe ky:

Një natë, në shtëpinë e një njeriu të ditur kishte hyrë një hajdut, ai e vë re se këtë gjë dhe i afrohet hajdutit me butësi, duke e qetësuar nga frika dhe paniku me këto fjalë: “Biri im! Më duket se dëshiron të marrësh thesin e grurit. Mirëpo, për të bërë bukë nga gruri, më parë duhet ta bluash, e më pas duhet ta pastrosh nga himet. Në fakt, ti do të lodhesh nga këto punë. Prandaj shiko në dollap se aty ka miell të gatshëm. Nëse do, të jap prej tij.” Hajduti e ndjek të zotin e shtëpisë me qetësi deri tek thesi i miellit, ku njeriu i ditur e pyet: “A ke ndonjë kafshë për ta bartur thesin?” Më pas, ata e ngarkojnë thesin në kafshë dhe pak para se të largohet, burri i ditur i tregon edhe njëherë butësinë e tij dhe i thotë: “Biri im! Duhet ta dija më herët që ti ke pasur nevojë dhe të ta plotësoja nevojën. Prandaj ma bëj hallall se të lodha deri këtu,!” Hajduti shkrihet i tëri para këtyre fjalëve dhe kur kthehet në shtëpi, nuk arrin të flegjë deri në mëngjes nga ndikimi që lanë ato fjalë në shpirtin e tij. Kur zbardhi dita, ai shkoi tek ai përsëri dhe u bë nxënës i tij i përkushtuar.

Në kohën tonë, kur çdo gjë ka vetëm vlerë materiale, është e pamundur t’i imagjinosh këto sjellje. Prandaj, këto tregime shihen si legjenda. Mirëpo, këto janë ndodhi të vërteta dhe nuk është e pamundur të ndodhin. Humbja e shpirtit dhe e botëkuptimit të vetëmohimit dhe preferimit të të tjerëve para vetes, ka bërë që edhe sakrificat e thjeshta të duken jonormale.



Edukimi i karakterit

dhe modeli shembullor

— Prof. dr. Irfan Gyndyz —

Njeriu, në aspektin fizik është një qenie biologjike. Çdo njeri është pajisur me një potencial të caktuar aftësish mendore, sentimentale dhe fizike. Këto aftësi, gjenden edhe në kodet gjenetike të njeriut, edhe si ndjenja dhe esenca në shpirtin e tij. Nga kjo pikëpamje, çdo njeri ka një karakter dhe temperament, i cili formohet prej ndërveprimit të shpirtit dhe trupit me njëri-tjetrin. Rezultati që nxjerrin në pah këto aftësi të lindura që vijnë prej natyrës së njeriut, quhet “temperament”. Më pas, njeriu, me ndikimin edhe të rrethit, ndërton karakterin e vet në bazë të këtyre aftësive. Si rezultat i karakterit të ndërtuar nga familja dhe shoqëria në bazë të këtyre aftësive që vijnë prej lindjes, çdo njeri fiton një ego dhe personalitet. Për rrjedhojë, zakonet, vlerat morale dhe të gjitha rregullat shoqërore që njeriu i thur mbi bazën e cilësive që i zotëron prej lindjes, shpjegohen me termin “karakter”.

Kur një fëmijë arrin periudhën e adoleshencës, marrëdhënia e temperamentit dhe karakterit, shfaqet në formën e personalitetit. Ky personalitet i jep çdo njeriu disa cilësi të veçanta.

Personaliteti është një tërësi harmonike që merr formë në sajë të ndërveprimit me njëra-tjetrën të cilësive të lindura dhe ndikimeve të rrethit shoqëror. Personaliteti është një tërësi cilësish së ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve që bëjnë një njeri të ndryshëm nga të tjerët me anët e tij objektive dhe subjektive.

Karakter, janë sjelljet personale të njeriut dhe një vlerë që rrethi shoqëror i jep aktivitetit të



tij fizik, sentimental dhe mendor. Karakteri i një personi, përbëhet prej vlerësim-gjykimeve të rrethit brenda të cilit jetohet me cilësitë personale. Përvetësimi ose jo i këtyre vlerësim-gjykimeve formon karakterin. Njerëzit nuk janë përgjegjës në sajë të cilësive personale, por në sajë të cilësive të karakterit. Për këtë arsye, nëse edukimi i personalitetit dhe i karakterit nuk plotësojnë njeri-tjetrin, është shumë e vështirë të përparosh qoftë në jetën personale, qoftë në jetën familjare e shoqërore.

Veprimet që njeriu bën kur nuk ekziston rreziku i shikimit nga të tjerët, pasqyrojnë karakterin e tij të vërtetë. Goethe thotë se, *“familja është vendi ku njeriu e tregon veten ashtu siç është”*. Kjo tregon se jashtë familjes së vet dhe në shoqëri, njeriu lëviz i maskuar. E rëndësishme në këtë pikë, nuk është shtypja e këtyre cilësive të temperamentit, por parandalimi i tyre nga dëmtimi vetvetes dhe i të tjerëve, duke i orientuar ato në të mirë ose duke i vënë nën kontroll. Nga kjo pikëpamje, në themel të edukimit të karakterit, parësore është frenimi i cilësive negative të forta dhe mbizotëruese të temperamentit, zhvillimi i cilësive të dobëta ose gjetja e cilësive të duhura të karakterit.

Sjelljet që njeriu i bën në mënyrë të përsëritur dhe gjen prehje tek ato, pasqyrojnë cilësitë e tij karakteristike. Pa zotërimin e një karakteri, nuk ka vlerë as zotërimi i dijeve dhe i aftësive. Përveç kësaj, kjo ka edhe një anë të rrezikshme. Të dish të drejtën, të mirën dhe të bukurën, ka një dallim të madh ndërmjet veprimit të së drejtës, të mirës dhe të bukurës. E rëndësishme, nuk është të dish se çfarë është e drejtë, e mirë dhe e bukur, por të zotërosh entuziazmin për të vepruar të drejtën, të mirën dhe të bukurën. “Temperamenti”, që është si një lloj fare dhe “karakter”, që është si një lloj toke dhe klime, përcaktojnë personalitetin dhe egon tonë. Nëse e ngjasojmë temperamentin me rrënjët e një peme, mund të themi se karakteri janë degët dhe frutat e saj. Ndërsa dallimi midis karakterit dhe personalitetit, është se karakteri, është formimi tek njeriu i cilësive që vijnë prej lindjes, ndërsa personaliteti është si veshje që njeriu ia përshtat vetes së tij më vonë dhe e cila merr formë sipas mendimeve e ideve të veta dhe kulturës së ambientit ku ai edukohet. Dhe, për shkak se kjo veshje merr formë në sajë vetëdijes dhe vullnetit të vet njeriut, në mënyrë paralele merr formë edhe përgjegjësia, dënimi dhe shpër-



blimi i tij. Ndërsa kuptimi i shprehjes, “edukimi i karakterit”, është, “edukimi i zhvillimit të disa cilësive në bazë të një botëkuptimi të caktuar moral tek individi”.

Termi personalitet, i cili në latinisht është “personality”, në letërsinë e vjetër greke shprehet me fjalën “Persona” dhe do të thotë “maskë që vendoset në fytyrë”. Për këtë arsye, sipas disave, personaliteti është një fytyrë dhe ego e maskuar që i tregohet ose dëshirohet t’i tregohet të tjerëve. Atëherë, mund të themi se personaliteti ka lidhje direkte me të qenit i moralshëm. Nisur nga kjo, nuk është edhe aq e gabuar nëse personalitetin e trajtojmë si tërësinë e sjelljeve morale që ia shfaqim të tjerëve.

Personaliteti i njeriut, përbëhet nga dy komponentë, siç janë temperamentin dhe karakterin. Llojet e temperamenteve kanë lidhje direkte me instinktin e brendshëm të njeriut. Ndërsa karakteri, fitohet me edukim dhe ndërtimin e nënvetëdijes. Në mënyrë të veçantë, nëse marrim parasysh faktin se zakonet e lindura nuk mund të eliminohen, mund të themi se është shumë e rëndësishme që këto zakone ekzistuese në temperamentin e njeriut të kanalizohen drejt së mirës, së bukurës dhe të drejtës, me anë të edukimit të karakterit. Personat që janë të prirë ndaj disa virtyteve apo dobësive si pasojë e temperamentit, është e vështirë t’i përmirësosh vetëm me anë të “një lloji” edukimi karakteri. Për këtë arsye, në çështjen e udhëzimit dhe ndërtimit të personalitetit, duhen përdorur metoda dhe teknika të veçanta duke



marrë parasysh cilësitë dhe aftësitë e ndryshme të personave. Ashtu siç është e dëmshme që ta ushqesh me bukë një foshnjë që duhet të ushqehet me qumësht, e tillë është edhe edukimi që bëhet pa marrë parasysh nevojat dhe nivelin e natyrës së njerëzve.

Psikologjia akademike në kohën tonë, në emër të objektivitetit, i ka hedhur në plan të dytë cilësitë morale dhe konceptet e personalitetit dhe karakterit. Për këtë arsye, po eliminohen edhe zakonet e karakterit si drejtësia, respekti dhe besnikëria. E në vend të tyre u është dhënë rëndësi zhvillimit të cilësive të temperamentit si egoizmit, individualizmit, imazhit, sipërmarrjes, iniciativës, etj. Por ç'është më e keqja, personaliteti dhe karakteri janë kthyer në fjalë që përdoren si sinonime të njëra-tjetrës. Mirëpo, ndërkohë që karakteri shpjegon vlerat dhe virtytet morale të njeriut, personaliteti përkufizon më tepër cilësitë e temperamentit dhe unit të njeriut. Nga ky aspekt, mund të themi se, për të bërë një jetë të shëndetshme, ka një rëndësi të të njëjtin nivel që njeriu të ketë edhe një karakter të fortë, por edhe një personalitet super të fortë.

Njeriu, qoftë me vetëdije, qoftë pa vetëdije, përvetëson në masë të gjerë modelet shoqërore duke i parë dhe, në këtë mënyrë ai formon karakterin. Në shoqëri, gjuha, zakonet dhe traditat, disa vepërimtari profesionale, ritet fetare dhe vlerat morale, në përgjithësi përvetësohen si model dhe mësohen duke vëzhguar sjelljet e të tjerëve dhe duke i imituar ato. Sjelljet shembullore të të tjerëve, zënë

një vend shumë të rëndësishëm ndër burimet e mësimi të fëmijëve dhe të rinjve. Ata, një mori sjelljesh dhe qëndrimesh shoqërore, i mësojnë duke vëzhguar sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve të tjerë. Për këtë arsye, mënyra e mësimi me anë të modeleve ka një rëndësi tejet të madhe në shoqërizimin dhe formimin e personaliteteve.

Sado që të shpjegohet me anë të dijeve teorike, në fund do të thuhet, “ja, duhet të bëni kështu, ose ashtu”, duke treguar një shembull, me qëllim që të merren rezultatet e duhura në një mënyrë më të shkurtër. Formimi i personalitetit duke u ndikuar nga sjelljet shembullore të të tjerëve, zë një vend shumë të rëndësishëm në përvetësimin e normave sociale, morale dhe fetare të shoqërisë nga ana e fëmijëve dhe të rinjve. Kjo, sepse fëmijët dhe të rinjtë, në mënyrë të pashmangshme, përpiqen të imitojnë të rriturit dhe mundohen vazhdimisht të ndërtojnë personalitetin e tyre duke përvetësuar sjelljet e tyre të cilat i marrin si shembull.

Marrja shembull e prindërve, mësuesve dhe të rriturve në përvetësimin e rregullave fetare dhe morale, është më efikase se sa mësimi teorik. Ndërkohë që me anë të mënyrës së marrjes shembull fëmija pranon idealet, qëndrimet dhe sjelljet e pjesëtarëve të familjes, ai përvetëson edhe fenë, besimin dhe mendimet e tyre. Në këtë mënyrë, imitimi i mëson atij se si duhet besojë, të ndjejë dhe të sillet. Pra, në këtë formë arrihet të mësohet një pjesë e madhe e dijeve në lidhje me domosdoshmëritë e jetës fetare.

Feja që fillon me anë të imitimit, zhvillohet dhe thellohet dalëngadalë sipas aftësive të vet fëmijës dhe atmosferës fetare të familjes dhe rrethit, e më pas kthehet në një jetë fetare të rregullt. I riu që rritet në një rreth të tillë, duke përvetësuar sjelljet e të rriturve, më tepër se prej mendimeve të veta, ndikohet prej mendimeve dhe sjelljeve të njerëzve fetarë. Në këtë mënyrë, këto mendime e sjellje bëhen edhe mendimet dhe sjelljet e tij.

Si përfundim mund të themi se, fëmijët dhe adoleshentët, ashtu si në qëndrimet dhe sjelljet e tjera sociale, edhe në çështjen e qëndrimeve dhe sjelljeve morale e fetare, ndikohen më tepër prej atyre që i marrin shembull dhe dëshirojnë më së shumti t'u ngjajë.



Një mendim i hollë për një dukuri që trashet

KOMUNIZMI SIPAS ROSE WILDER LANE

— Edison Çeraj —

Shumë lloje insektesh dhe disa kafshë duken sikur janë të kontrolluara nga një Autoritet jashtë tyre.

Për shembull, bleta sillet siç sillet një qelizë në trupin e njeriut; sikur nuk ka dëshira dhe nuk bën dot asnjë zgjedhje. Duket sikur e kontrollon Vullneti i Masave. Bleta është pamëshirshëm e molisur, e përçmuar, e zëvendësuar nga një tjetër bletë për t'u dërrmuar në po atë mundim të pandryshueshëm për luzmën, bash ashtu siç dërrmohen qelizat dhe zëvendësohen. Ngjan sikur nuk ka një jetë individuale. Luzma është krijesë e gjallë.

Rasti më emblematik kur njeriu ngjan më shumë me luzmën e bletëve është komunizmi.

Disa sociologë pohojnë se shoqëria ka filluar me komunizmin e egër dhe është zhvilluar përmes barbarisë në qytetërim. Të tjerë presin nga shoqëria të arrijë përsosjen e vet përfundimtare në botë-komunizëm të së ardhmes.

Ta mendosh shoqërinë njerëzore si një organizëm që zhvillohet, progreson apo bën prapa, do të thotë të mendosh si bleta (nëse bleta mendon). Kjo nënkupton të mendosh siç mendon një pagan. Kjo do të thotë të fantazosh, të adhurosh idealen.

Në botën njerëzore nuk ka njësi tjetër veç personit individual. Nuk ka forcë tjetër përveç energjisë individuale. Në jetën e vërtetë të njeriut, e vetmja shoqëri e vërtetë është çdo kontakt i personit të gjallë me çdokënd që takon.

Për aq sa shoqëria ka çfarëdo lloj ekzistence reale, ajo ekziston kur djali takon vajzën, kur znj. Xhenifer i telefonon z. Smith, kur Robinsoni blen një pako biskota; kur shoferi ndalon për karburant; kur lobisti i jep bakshish shërbëtorit dhe kur takon një politikan; kur ky i fundit kërkon mbështetje; kur postieri dorëzon postën dhe kur shefat e sindikatës bisedojnë për grevën; kur karpentieri të bën një karrige për merak; kur dentisti thërret “hape më shumë, të lutem” e kështu me radhë. Raportet njerëzore janë aq të panumërta dhe ndryshojnë aq shpejt, sa asnjë mendje njerëzore nuk është në gjendje t'i rrokë.

T'i quash të gjitha këto raporte shoqëri dhe pastaj të flasësh për progresin apo mirëqenien e shoqërisë, sikur ajo të ishte një luzmë bletësh, është thjesht një arratisje nga realiteti drejt një vendi ëndrrash, apo drejt një bote ideale, që është shumë tërheqëse kur e mendon apo në letër, por e pamundur në realitet.

Askush nuk e di dhe as që është në gjendje ta marrë me mend se si, kur dhe ku ka nisur jeta njerëzore. Nëse ajo nisi me komunizmin, atëherë ajo po niska tani. Shumë grupe, të të gjitha llojeve, jetojnë në komunizëm. Edhe në Amerikë kanë jetuar e jetojnë akoma shumë grupe komuniste.

E para gjë që bënë intelektualët europianë kur trembëdhjetë kolonitë fituan lirinë nga Anglia, ishte vendosja e komunizmit në Amerikë. Hankoku,

Harvardi, Shirli, Tiringhami në Masaçusets; Alfred dhe Nju Glosteri në Mein; Maunt Lebanon, Uatervli, Grovland, Oneida (argjendi i bashkësisë) në Nju Jork; Sauth Union dhe Plezent Hill në Kentaki; Betlehemi dhe Ekonomi në Pensilvani; Union Vilih, North Union, Uotervlie, Uajtuater dhe Zoar në Ohajo; Enfield dhe Uollingford në Konektikat; Bishop Hill, Ilinois; Korning dhe Bethel, Misuri; Sedarveil, Kansas; Aurora, Oregon dhe dhjetëra qyteza e qytete të tjera amerikane ishin vendbanime komuniste. Në kohën e lulëzimit të Nju Inlandit, miqtë e Emersonit shënuan ndërtimin komunist të Fermës Bruk. Z. Apton Sinkler, që gati sa nuk u zgjodh guvernator i Kalifornisë, famën e tij me përmasa botërore, në radhë të parë e krijoi si revolucionar, me themelimin e një vendbanimi komunist në Halikon Hall në Nju Xhersi. Indianët e Amerikës ishin komunistë, dhe për rrjedhojë të tillë ishin edhe Ndërtuesit e Pirgejeve.

Sparta përbënte një model primitiv të komunizmit. Ja si i përshkruan Plutarku spartanët: “Disiplina e tyre vazhdonte edhe pasi ishin bërë burra të pjekur. Askujt nuk i lejohej të jetonte sipas qejfit të vet. Qyteti ishte një lloj kampi ku çdo njeri kishte vendin e vet në kushtet dhe punën e caktuar të përbashkët. Likurgu i edukonte qytetarët e vet në atë mënyrë që ata të mos donin dhe të mos mundnin të jetonin të pavarur. Prej tyre kërkohej që të bashkoheshin për të mirën publike, dhe duke u mbledhur si bletët përreth komandantit të tyre, me zellin dhe shpirtin e tyre publik të ishin çdo gjë, përveç të qenurit individë.”

Kjo “çdo gjë, përveç” është dallimi kryeneç midis një njeriu dhe një blete. Bleta është tërësisht e dhënë pas vetes. I tillë ishte edhe Likurgu, gjë që e besonin spartanët. Në histori Likurgu është legjendë. Sipas legjendës, ashtu si bleta, ai e derdhte të gjithë energjinë e tij jetësore për të mirën publike, derisa në pleqëri vrau veten, duke mbyllur kështu një jetë që nuk kishte asnjë vlerë tjetër.

Për pesëqind vjet spartanët jetuan në një komunë të pandryshuar. Mbreti Agis IV u përpoq të ngrinte standardin e jetës, por spartanët e vranë. Ata vazhduan të jetonin si celula të Spartës, derisa grekët – më pak komunistë – i mposhtën ata në luftë dhe ua shkatërruan komunën.

Kohë më parë, Dukagjinët, në Alpet Dinarike, jetonin nën të njëjtin zotërim nga Ligji i tyre i Lekës. Rose Wilder Lane, dora vetë, është orvatur për orë të tëra t’i bindte disa prej tyre se njeriu mund të zotërojë shtëpi. Një grua e rrezikshme dhe e radikalizuar e fshatit kërkonte një shtëpi. Ajo kish ndihmuar të shoqin për ta ndërtuar. Tani ajo kishte mbetur e ve, pa fëmijë, por donte ta mbante shtëpinë. Ishte një

shtëpi e rëndomtë, e vogël, me mure prej guri; një kasolle e mbuluar me rrasa, pa dysHEME, dritare apo oxhak. Kokëfortësisht antisociale, ajo përsëriste paphim: “Me këto duar, me duart e mia i kam bërë muret. I kam vënë rrasat në çati me duart e mia. Është shtëpia ime. E dua shtëpinë time.” Fshatarët thoshin se “ajo është e paparë. Shpirti i gurit, jo i njeriut, ka hyrë brenda saj”. Ata ishin të zgjuar. Lutja e Lane në të mirë të gruas i tronditi, por pasi e menduan ata dhanë arsyetimet më të forta mbi komunizmin: barazia ekonomike, siguria ekonomike, rendi shoqëror. Lane u pat thënë se në Amerikë njeriu zotëronte shtëpi. Ata nuk mund ta besonin. Ata e adhuronin Amerikën. Kishin dëgjuar për mrekullitë e saj. Gjatë luftës së sapombaruar botërore kishin parë me sy aeroplanët nga ai vend përrallor. Ata e morën në pyetje dinakërisht. Lane mori guximin t’u përmendte tatimet. Iu desh të pranonte se amerikanë paguan fisin për zotërimin e shtëpisë. Kjo sikur nënkuptonte se fisi amerikan kishte në zotërim shtëpinë. Kjo që shpartalluese. Mendimi i tyre i lartë për Amerikën u kthye në vend.

Nuk ishin në gjendje ta merrnin me mend se mund të ekzistonte çfarëdo lloj sigurie, rendi apo drejtësie mes njerëzve që nuk kontrollohej nga një Pushtet i paprekshëm, që nuk do të lejonte që një individ të kishte shtëpi. Në po këtë mënyrë, Rusoi nuk mund të imagjinonte asnjë lloj qytetërimi po të mos kishte Pushtet.

Dymijë e pesëqind vjet pas Spartës, jo më larg se para dy brezash, të gjithë ata intelektualë të shkëlqyer europianë luftonin për të Drejtat e Njeriut dhe prisnin që të drejtat e njeriut të shkatërronin qytetërimin. Ata nuk mund ta merrnin me mend njeriun e lirë, pa tutor, Njeriun e Kuq fisnik, lakuriq e të vetmuar në malet e egra të Amerikës. (As që donin të mësonin se indianët amerikanë, ndonëse fisnikë dhe lakuriqë, ishin komunistë.)

Më 1776, këta mendimtarë francezë ishin mendjet më të lira në Europë. Ata nuk mund ta merrnin dot me mend se ushtrimi i të drejtave të natyrshme njerëzore mund të krijonte një qytetërim të ri. Nuk mund t’i përfytyronin të drejtat aktuale njerëzore duke pandehur se duhej njëfarë Autoriteti për të kontrolluar individët.

Ky supozim i rremë përshkon mbarë mendimin e Botës së Vjetër, gjatë gjithë historisë së saj e deri në ditët tona. Ai përshkon një masë të madhe edhe të mendimit amerikan.

Ky iluzion ka mbretëruar për një kohë kaq të gjatë dhe akoma arrin të joshë aq shumë mendje të ndershme në arrati nga faktet, ngaqë mendohet sikur kjo zgjidh problemin njerëzor. Problemi është i vërtetë; ai është problemi i kontrollimit të energji

të bashkuara të shumë individëve.

Individët duhet t'i bashkojnë energjitë e tyre që të mund të mbijetojnë në këtë planet. Energjitë e tyre të bashkuara duhet të veprojnë nën njëfarë kontrolli. Shtrohet pyetja se kush i kontrollon ata?

Përgjigja e Botës së Vjetër është Autoriteti.

Kjo përgjigje përbën bazën e jetës njerëzore në Botën e Vjetër. Nuk ka mendimtar nga Bota e Vjetër që ta ketë vënë në dyshim këtë. Pyetja që ka preokupuar vazhdimisht mendjet e Botës së Vjetër është *cili* autoritet?

Mendjet e njerëzve janë përpjekur për mijëra vite në kërkim të Autoritetit. Për ta gjetur atë, shekull pas shekulli, njerëzit aktivë kanë ngritur krye kundër qeverive të tyre, kanë vrarë sundimtarët e tyre, kanë therur njëri-tjetrin dhe kanë vendosur njëra pas tjetres lloj-lloj formash të Autoritetit të gjallë.

Nga Likurgu te Lenini, komunistët hedhin poshtë çdo formë të Autoritetit njerëzor. Për pyetjen se cili Autoritet i kontrollon qeniet njerëzore, komunisti i sinqertë përgjigjet: asnjë njeri i gjallë, asnjë mbret, asnjë car, asnjë despot, asnjë diktator, as shumica, as grupi, as klasa.

Komunisti e jep këtë përgjigje ngaqë kupton një fakt: vëllazërinë njerëzore. Ai e thotë me bindje se të gjithë njerëzit janë të bashkuar në një përpjekje të përbashkët humane, në një qëllim të përbashkët. Të gjithë njerëzit kanë të njëjtat të drejta për jetën, dhe për pasojë edhe për nevojat e jetës.

Por, nga ky këndvështrim, komunisti rezonon i bazuar në supozimin e lashtë pagan, se ka njëfarë Autoriteti që i kontrollon të gjithë njerëzit. Ai nuk e vë në dyshim këtë besëtytni pagane, por e merr si të mirëqenë.

Prandaj, rezonimi i tij vazhdon: meqë të gjithë njerëzit janë njerëzisht të barabartë, asnjëri syresh nuk mund të jetë Autoritet që kontrollon të tjerët. Nëse ky Autoritet nuk është njeri i gjallë, ai duhet të jetë një Autoritet mbinjerëzor, i paprekshëm. Që të zbuloni se ç'është ky Autoritet duhet të shihni sjelljet e njerëzve. Përpjekja e tyre e parë është të sigurojnë ushqim, veshmbathje dhe strehë. Ata i kontrollon Nevoja Ekonomike. Ja e meta që vjen nga besimi besëtyt te Autoriteti.

Një njeri lakuriq në pyll, i vetëm, mund të hallakatet e të përpëlitet derisa të vdesë nga molisja, ose mund të ndërtojë një strehë me degë, të vrasë e të hajë një lepur dhe të bëjë një rrobë nga lëkura e tij. Historikisht njerëzit nuk kanë vrarë njëri-tjetrin deri në vdekje; ata kanë mbijetuar. Është fakt se jeta njerëzore është një betejë midis energjisë së njeriut – që ai e kontrollon – dhe energjive jonjerëzore të motit, drunjve dhe lepujve.

Por, komunisti kërkon Autoritetin që kontrollon

njerëzit, dhe duke e marrë si të mirëqenë faktin se njeriu nuk e kontrollon veten, atëherë Autoriteti që e kontrollon atë duhet të jetë gjendja e tij, shumata totale e drunjve, e lepujve dhe e motit. Kjo do të thotë: gjuetari kontrollohet nga gjahu. Një grua nuk e kontrollon sobën e saj, por anasjelltas. Apo jo?

Meqë komunisti nuk e di se individët kontrollojnë vetveten, ai i sheh ata si celula të shoqërisë, e cila (beson ai) ka një Shpirt të Madh, që për individin përbën atë që përbën luzma për bletën.

Më sa dihet, të vetmit që e quanin këtë një Autoritet të paprekshëm, Shpirti i Madh, ishin indianët e Amerikës. Të egrit e quanin tabu. Spartanët e quanin Sparta. Marksi e quante Vullneti i Masave dhe Shteti Proletar. Është edhe Vija e Partisë që jeton në Moskë.¹

Në teori, komunizmi është vetëdorëzimi i plotë i individit para vullnetit të këtij Autoriteti të paprekshëm, që s'do mend se është gjithmonë E Mira.

Teoria dhe praktika e komunizmit janë të vjetra po aq sa historia. Ato mbijetojnë ngaqë teoria mbështetet pjesërisht në fakte. Ajo njih barazinë dhe vëllazërinë e njerëzve.

Në praktikë, asnjë përpjekje për ta bërë këtë teori efektive nuk ka dhënë fryte, ngaqë teoria nuk njih faktin se individët kontrollojnë energjitë e tyre.

Komunizmi ia del të kontrollojë energjitë e bashkuara njerëzore meqë individët kontrollojnë energjitë e tyre në përputhje me botëkuptimet e tyre mbi gjithësinë, realitetin dhe Zotin (qofshin ato të vërteta apo të rreme). Nëse ata besojnë se i kontrollon një Autoritet i paprekshëm, ata veprojnë sikur kontrollohen përnjëmend nga një Autoritet i tillë. Nëse ata nuk e besojnë këtë, ata nuk jepen pas komunizmit.

E gjithë historia dëshmon se komunizmi është një formë e zbatueshme jetese. Njerëzit kanë jetuar dhe jetojnë në komunizëm në çdo nivel të kulturës dhe në çdo nivel ekonomik që ka arritur ndonjëherë në Botën e Vjetër.

Që të jetosh në komunizëm mjafton që një numër burrash dhe grash të besojnë në dy fakte dhe në një mangësi: se të gjithë njerëzit janë të barabartë, se të gjithë njerëzit janë vëllazër dhe se individët kontrollohen nga një Autoritet i paprekshëm.

"Autoriteti" i vetëm është Zoti, që ka zgjedhur t'i lërë të lirë njerëzit, por shumë syresh nuk e duan ose nuk e meritojnë lirinë, dhe për pasojë shpikin një autoritet të caktuar, për të cilin edhe mund të vetëflijojnë.

1. Pa harruar vijën e demokracisë që fluturoi me mundime nga Athina në Bruksel.



PUNËT E NEVOJSHME DHE TË PANEVOJSHME

— Xhemal Nar —

Islami duhet mësuar në tërësinë e tij. Pra, duhet mësuar me dimensionet e tij të besimit, adhurimit, jurisprudencës dhe moralit. Më pas, duhet të jetohet me sinjeritet dhe më në fund, duhet të përpiqemi ta përçojmë atë edhe tek të tjerët. Si myslimanë që jemi, kur të arrijmë në një numër apo në një peshë të caktuar brenda shoqërisë ku jetojmë, është e detyrueshme që edhe qeveria jonë të jetë Islame, sepse Profeti (a.s.), urdhëron: *“Ashtu si të jeni, ashtu do të qeveriseni.”* Kjo është detyra, përgjegjësia, vetëdija, qëllimi dhe shkaku i ekzistencës sonë.

Gjërat e nevojshme për kryerjen e këtyre detyrave tona, të cilat mund t’i përmbledhim si “dija, puna dhe xhihadi”, duhet të jenë pak a shumë këto: “Përveç gjuhës mëmë, duhet njohja e mirë e gjuhës arabe, mësimi i mirë i dijeve të Kuranit, Sunetit, Tefsirit, Akaidit dhe Fikhut së bashku me metodat tyre, ndërtimi ose mbrojtja e shoqërisë dhe shtetit islam, duke mësuar qeverisjen dhe politikën, mësimi i historisë islame, mësimi dhe kuptimi i shteteve moderne jobesimtare që përpiqen të shuajnë Islamin me kurthet e tyre, bërja e krahasimeve të sistemit të mendimit dhe filozofisë së mohuesve modernë me sistemin islam dhe kuptimi i tyre në nivelin që mund t’i kundërshtosh, mësimi i gjuhës së nevojshme për shpjegimin e fesë, mësimi i mënyrave të komunikimit, mësimi i një prej gjuhëve të huaja më të përdorura dhe një prej gjuhëve të afërta me civilizimin tonë, si persishtja, indishtja, etj. dhe mësimi i përdorimit në mënyrë të mjaftueshme të kompjuterit dhe mjeteve të komunikimit...”

Nisur nga kjo, mund të themi se kemi shumë punë për të bërë. Për rrjedhojë, nëse ne e kalojmë kohën me lojëra e argëtime, nëse merremi me përgojime, thashetheme dhe punë të tjera të padobishme, nuk do t’i sjellim asnjë dobi Islamit dhe myslimanëve! Përkundrazi, do të bëhemi shkak i humbjes, i vdekjeve, i shkatërrimit dhe konsumimit...

Për këtë arsye, Profeti (a.s.), ka thënë: *“Braktisja e punëve të padobishme, është prej bukurisë së Islamit të njeriut!”*

TË SHOHËSH

Mirësitë e përgjithshme

Në suren Nebe' urdhërohet: **"A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat e malet si shtylla?! Ne ju kemi krijuar në çifte dhe gjumin jua kemi bërë për prehje. Natën jua kemi bërë mbulesë, ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar. Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë dhe kemi vënë kandil (diell) të shndritshëm! Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme për rritjen e drithërave, bimëve dhe të kopshteve të dendura."** (Nebe', 6-16)

Në Kuranin Fisnik ka shumë ajete që të përkujtojnë disa prej mirësive të dukshme në sofrën e gjithësisë, të cilat janë vënë në shërbim të njeriut (Âl-i Imrân, 190; A'raf, 57; Ra'd, 3; Nahl, 11, 67; Fâtir, 37; Junus, 5; Ibrahim, 33. etj.) dhe ajeti që është dhënë më sipër është një nga shembujt më të qartë të këtij fakti. Para së gjithash, këtu bie në sy fakti se të gjitha mirësitë kryesore që janë vënë në shërbim të njerëzve, janë në përdorim të tyre pa dallim nëse janë besimtarë apo jobesimtarë. Po ashtu, ky përkujtim vihet pikërisht midis ajetit që dënon ata që vënë në dyshim "lajmin për Ditën e Madhe" (Nebe', 1-5) dhe ajetit **"Sigurisht, Dita e Ndarjes vendimtare është caktuar."** (Nebe', 17) Me shumë mundësi, arsyeja e kësaj është nxitja për t'u përgatitur sa më mirë për atë ditë të madhe duke qenë të vetëdijshëm ndaj mirësive. Pasi njofton në mënyrë më efikase se tronditja e madhe do të ndodh me patjetër, tregon


rrugën për të mos u kapur i papërgatitur nga vdekja, e cila është faza e parë e asaj ndodhie. Shkurtimisht, kërkon të thuhet, "Ngrije kokën njëherë dhe hapi sytë! Pastaj shih me vëmendje rreth e qark!"

Po ashtu, është shumë kuptimplotë edhe fakti se kur i Dërguari i Allahut (a.s.), dilte prej shtëpisë së tij, ngrinte kokën e tij të bekuar lart nga qielli dhe pasi shikonte me vëmendje fillonte të bënte dua.

Një mëngjes, i Dërguari i Allahut (a.s.), e lajmëron Bilal Hebeshiun (r.a.), për zbritjen e ajetit: **"Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët!"** (Al-i Imran, 190) Më pas, edhe pse e lexoi këtë ajet, ai tha: **"Mjerë për atë që nuk mediton rreth mirësive të Allahut!"**

Në të vërtetë, kur flitet për mirësitë e Allahut, shumica e njerëzve shohin vetëm ato prej të cilave kanë dobi, madje edhe për to nuk meditojnë ashtu siç duhet. Ndonjëherë, njeriu mendon edhe se nuk posedon asgjë. Nuk falënderon se është gjallë edhe "sot" dhe nuk e mendon këtë si një mundësi për të bërë vepra të mira. Duket sikur ai kërkon gjithmonë arsyetime për të mos falënderuar. Ai nuk e ngre kokën lart e të shohë sofrën e gjithësisë që është shtruar enkas për të. Ai nuk mendon as faktin se edhe vetë soditja e mirësive, që janë vepra arti më vete, është një mirësi e madhe, duke mos





e llogaritur fare se është duke notuar midis mirësive të pashoqe hyjnore. Ai e ngushton horizontin e tij dhe gjithmonë ua vë syrin atyre që kanë në dorë ata të cilët posedojnë mundësi më të shumta se vetja. Ai harron se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Shikoni ata që i kanë kushtet e jetës më të ulëta se tuajat dhe jo ata që i kanë më lart se tuajat! Kjo është një sjellje më e përshtatshme për ju, me qëllim që të mos i nënçmoni mirësitë e Allahut që keni.”* (Muslim, Zuhd, 9.)

Besojmë se këto ajete fisnike, na përkujtojnë të shkojmë prej rregullit në gjithësi, në gjallërinë e tij, prej shumësisë drejt njëshmërisë dhe prej mirësive që duken tek ato që nuk duken. Na thërrasin të ngremë kokën me qëllim që të njohim Artistin e vërtetë prej veprave të Tij. Na fton të adhurojmë sikur jemi duke e parë Krijuesin e gjithçkaje që ekziston.


Allahu i Madhëruar e bën trupin e njeriut të funksionojë si një fabrikë e heshtur. Dhe për ta mbajtur në këmbë këtë sistem, vazhdon të mbajë në këmbë ciklin e të gjitha mirësive në tokë dhe në qiej. Ai lëviz me anë të erës retë e ngarkuara me shi. Tokën që lag me ujë, e ngroh me diell dhe nga dheu nxjerr lloj-lloj mirësish. Ai e bën natën dhe ditën të ndjekin njëra tjetrën. Po kështu edhe stinët. Ndërsa kafshët bimët dhe mirësitë e tjera i ka vënë në shërbim të njeriut në një mënyrë shumë bujare...

Njerëzit duhet të krahasojnë admirimin që ndiejnë ata për teknologjinë me botëkuptimin që kanë ata ndaj këtyre mirësive të pashoqe të cilat zotërojnë. Ata duhet të ndalen e t'i shikojnë

në mirë mirësitë që arrijnë të shohin, që prej botës makroskopike deri tek ajo mikroskopike, të cilat Allahu i madhëruar ua ka falur pa asnjë çmim. Më pas, duhet të imagjinojnë mirësitë e vogla që nuk mund të shikohen me sy, por që kanë rëndësi jetike për ne. Duhet menduar edhe ato që horizonti yt nuk i përfshin dot për shkak të largësisë së tyre. Dhe për ta falënderuar ashtu siç duhet Atë që i ka dhënë të gjitha këto, nuk duhet harruar se në Kuranin Fisnik Ai na kujton herë pas here mirësitë më kryesore.

Në një ajet fisnik urdhërohet: ***“Andaj, shikoji gjurmët e mëshirës së Allahut, si e gjallëron tokën pas shkretimit të saj!..”*** (Rrum, 50) Ky ajet na kujton faktin se të dashurit e Allahut, zgjidhnin më shumë muajt e pranverës, për të kapur mundësitë e vrojtimt të manifestimeve hyjnore.

Së bashku me pranverën, çdo gjë rigjenerohet dhe fillon të zgjohet. Kjo, do të thotë se rigjenerimi dhe zgjimi janë prej nevojave të pandryshueshme. Për këtë arsye, është e nevojshme të shihet dhe të vrojtohet.



PËRKUFIZIMI I PASTËR I SINQERITETIT

Në shumë vende të Kuranit Fisnik, gjendet urdhri i devotshmërisë me sinqeritet. Një nga këto, është ajeti i dytë në suren Zumer, ku urdhërohet: ***“Njëmend, Ne ta kemi zbritur ty Librin me të vërtetën. Andaj adhuro vetëm Allahun me përkushtim të çiltër për Të!”*** Ndërsa në suren Sad, në ajetin 82 na jepen fjalët e shejtanit, i cili është përbetuar se do ta mashtrojë njeriun dhe do ta nxjerrë atë nga rruga e drejtë: ***“Ai tha: “Betohem në madhërinë Tënde se unë do t’i mashtroj ata të gjithë!”***

Sinqeritet, do të thotë që në fjalët që thuhet dhe në punët që bëhen, të mos ketë të fshehur ndonjë qëllim apo ndonjë llogari tjetër. Po si duhet të jetë kjo, ose si mund të jetë përkufizimi më i qartë i kësaj?

Përgjigjen e kësaj pyetje, e gjejmë në fjalën e një ajeti tjetër, i cili për nga aspekti i temës sonë, na tërheq vëmendjen në mirësitë e panumërta të Allahut të Madhëruar: ***“Allahu zbret nga qielli ujë me të cilin ngjall tokën pasi është tharë! Kjo, në të vërtetë, është shenjë e qartë për njerëzit që duan të dëgjojnë. Në fakt, edhe te bagëtitë ju keni shenja për të mësuar prej tyre. Ne ju japim atë që kanë në barkun e tyre prej ushqimit të përpunuar dhe gjakut: qumësht të pastër dhe të shijshëm për ata që e pinë.”*** (Nahl, 65-66)

Imam Gazaliu, në veprën e tij “Ihyau Ulumi’d-Din”, shprehet: “Ja, ky është përkufizimi më i saktë i sinqeritetit!” T’ia kushtosh një gjë, vendit që ajo i takon. Ta dallosh atë prej të kundërtave dhe të ngjashmeve, duke e bërë atë vetëm për veten e saj. Ndërsa kënaqësia e Allahut, për të cilën po flasim, e bën atë të pastër, të kulluar dhe pa përzjerje, si qumështi.

DUHET TË BËJME PAQE ME OMGJ-TË

— Xhihan Tashtan —

Zbulimi i përbërësve OMGJ në ushqimin e një fëmije të vogël, bëri që të ndizej edhe një herë diskutimi i zjarrtë në lidhje me ushqimet që përmbajnë OMGJ. Por le të mendojmë pak, sa i drejtë është dyshimi ynë në lidhje me këto produkte? A jemi të përgatitur ne për një të ardhme të afërt në të cilën të gjithë dollapët tanë do të mbushen me OMGJ?

1- Ekzistojnë disa shenja të ndryshme në hadithe, që kanë lidhje me OMGJ-të (Organizmat e Modifikuara Gjenetikisht). Pas shiut do t'i thuhet tokës: "Mbaroje prodhimin tënd dhe sille begatinë pas". Atë ditë të gjithë do të hanë nga një shegë dhe do të strehohen nën hijen e saj. Allahu do t'i jap vlera të mëdha edhe qumështit, aq sa një deve e vogël do të ngopë me qumësht një bashkësi të madhe, një lopë do të ngopë një fis, ndërsa një dele do të ngopë një familje të madhe. (Ibni Maxhe) Sigurisht që këto ngjarje që do të shikohen në të ardhmen, nuk mund t'i lidhim direkt me OMGJ-të, por mund të themi se shkenca dhe zhvillimi teknologjik i ditëve të sotme, na bën të mendojmë se nuk jemi aspak larg ditës që do të jemi dëshmitar të këtyre ngjarjeve.

2- Në vitin 2050 popullsia e tokës do të arrijë në 9 miliard banorë. Sipas Fondit të Popullsisë së OKB-së, duke qenë se në vitin 2010 popullsia e botës arriti në 6 miliard e 908.7 milion; në vitin 2050 do të jetë 9 miliard e 150 milion. Kuptohet se duhen gjetur mënyrat për ta ushqyer këtë popullsi. Vetë Fondi i Popullsisë së OKB-së tregon se për të ushqyer të gjithë njerëzit, duhet rritur prodhimi i drithërave me 80%. Sigurisht që do të thoni se "Allahu ua jep rriskun robëve të Vet", por pikërisht që për këtë po flasim, mbase Allahu me anë të metodave të përpunimit gjenetik, ua ka dhënë njerëzve OMGJ-të si një bekim. Gjithsesi, duhet të theksojmë faktin se ka shumë rëndësi se në duart e kujt bien OMGJ-të, sepse në bazë të përdorimit, ato mund të sjellin shkatërrim ose lehtësim.¹





3- Kompanitë e mëdha globale janë duke u përqendruar tek OMGJ-të. Në vitin 2012 vlera ekonomike e produkteve me OMGJ arriti në 2.1 miliard. Sipas parashikimeve, në vitin 2018 kjo vlerë do të arrijë në 16.7 miliard.² Drejtori ekzekutiv i Microsoftit, Bill Gates, së bashku me shoqatën e tij, është duke e mbështetur prodhimin e OMGJ-ve. Për momentin është duke u punuar mbi një banane me gjenetikë të modifikuar që prodhon vitaminë A dhe që nuk kalbet.³ Këto lloj kompanish janë duke studiuar problemet ushqimore që mund të kemi deri në vitet 2050 dhe po mbështetin studimeve në lidhje me prodhimin e organizmave gjenetikusht të modifikuara. Kur të vijë koha ato do të bëjnë reklamën e produkteve me OMGJ. Kur të vij ajo ditë, pavarësisht frikës sonë nga këto produkte, ne do t'i gjejmë të rreshtuara në raftet e marketeve tona.

4- Në vendin tonë nuk bëhen studime dhe analiza në lidhje me produktet e ndaluara dhe “helmuese” OMGJ. Për momentin, në vendin tonë produktet me OMGJ shihen si të rrezikshme dhe të dëmshme. Pra përveç frikës që kemi ndaj këtyre produkteve, ne nuk kemi as laborator të përshtatshëm për të bërë analiza, as një politikë që e mbështet një proces të tillë. Si pasojë e kësaj, në të ardhmen kur do të dalin ligje të cilat na detyrojnë që t'i importojmë këto produkte, ne do të jemi të papërgatitur.

Si përfundim, për sa kohë që nuk e lexojmë dot të ardhmen, nuk do të krijojmë dot baza të forta të së tashmes. Sikur në vend që të mos kapeshim kaq fort pas idesë: “sipas nesh duhet të jetë kështu” dhe të parashikonim realitetin ku po na çon lumi në të cilin ndodhemi për momentin, do të mund ta merrnim vetë timonin dhe të vendosnim se a do t'i konsumojmë apo jo produktet që përmbajnë OMGJ.

Bibliografi:

- 1- A janë OMGJ-të fatkeqësi? Gencdergisi.com, Bota Mikro
- 2- Marketi i biologjisë sintetike, Analiza e Industrisë Globale, Përmasa, Rritja, Shpërndarja dhe Parashikimi 2012-2018, transparecymarketresearch.com
- 3- Falë Bill Gates-it bananet me OMGJ janë duke ardhur në supermarketet tuaja, Naturalnews.com



HISTORIA E NJË ASTRONAUTI

Muaz Erdem

Të bëhem astronaut... Kjo është një prej ëndrrave kryesore të fëmijëve. Por në përgjithësi ajo mbetet vetëm ëndërr. A e keni menduar ndonjë herë se me çfarë vështirësh duhet të përballlet një astronaut? Le t'i hedhim një sy udhëtimit të një astronauti normal:

Astronauti futet brenda anijes kozmike. Bëhen kontrollet dhe përgatitjet e fundit. Rreth 16 sekonda para nisjes sistemi i ftohjes së zërit godet me ujë raketat. Qëllimi kësaj është parandalimi i dëmtimeve prej akustikës. Gjatë këtij procesi harxhohen plot 1 milion litra ujë; nuk e keni lexuar gabim, janë pikërisht 1 milion litra ujë! Kanë mbetur vetëm 10 sekonda para nisjes! Fillon djegia e gazrave brenda anijes kozmike. Një vonesë prej vetëm një sekond, mund të shkaktoj fatkeqësi të tmerrshme.

Motorët fillojnë të punojnë. Motorët e marrin lëndën djegëse nga një tank portokall që të gjithë e kemi shikuar në fotografi. Brenda 3 sekondash motorët duhet të arrijnë performancën e nevojshme për lëshim. Në momentin që arrihet kjo performancë kompjuteri jep urdhrin e nisjes dhe raketat e ndihmojnë anijen kozmike që të lartësohet në qiell. Momenti i nisjes është përfundimtar dhe nuk ka kthim pas. 1-2 sekonda pas nisjes, kompjuteri qëndror jep urdhrin që ndan pjesët që e mbajnë anijen kozmike pas platformës. Tashmë ajo është e lirë për të fluturuar!

Pas nisjes astronautët japin raporte të vazhdueshme. Këtë veprim ato e bëjnë në një nxitim prej 4

– 5 gram. Pra nëse një astronaut në tokë peshon 80 kg, në atë moment e ndjen veten si 350-400 kg. Për ta përballuar një gjë të tillë duhet të kesh rezistencë të mrekullueshme. 2 minuta pas nisjes, në lartësinë prej 50 km; raketat pranë anije kozmike shkëputen dhe bien në tokë të pajisura me parashuta. Ndërkohë anija kozmike vazhdon udhëtimin e saj me një shpejtësi prej 5.500 km/orë!

Pas 8.5 minutash anija kozmike arrin në lartësinë prej 27.000 km! Në 113 km lëshohet edhe tanku portokall. Gjatë kësaj kohe astronautët vazhdojnë ta ndjejnë veten 4-5 herë më të rëndë dhe vazhdojnë të qëndrojnë në një shtypje të tillë! Më pas anija kozmike zë vend në orbitën e Tokës dhe sillet rreth saj. Një sjellje e plotë zgjat 90 minuta. Kjo nënkupton që brenda 24 orëve astronauti shikon 16 herë lindjen dhe perëndimin e Diellit!

Astronautët përfundojnë misionin e tyre dhe bëhen gati për kthimin në shtëpi. Teksa hyjnë në atmosferën e Tokës, në lartësinë prej 120 km anija kozmike fillon të digjet. Ndërkohë shpejtësia është 8 km në sekondë. Anija zbret në tokë pa përdorur motorë prandaj ajo ka vetëm 1 shans për të zbritur në tokë. Astronauti duhet të jetë super-njeri për ta arritur një gjë të tillë, për të zbritur në tokë anijen kozmike duke e ditur se ka vetëm një shans! Ja pra, ky është udhëtimi i vështirë i astronautit. Mund të themi se gjërat nuk janë edhe aq të bukura sa i kemi ëndërruar. Çfarë mund të themi më? Allahu u dhëntë durim!



PËRPIQU TË BËHESH LIQEN

Një mjeshtër indian ishte mërzhitur ngaqë çiraku i tij ankohej vazhdimisht. Një ditë i kërkoi çirakut që t'i sillte kripë. Kur çiraku e solli kripën, mjeshtri i tha që të hidhte një grusht kripë në një gotë dhe pastaj ta pinte. Çiraku bëri ashtu siç i tha mjeshtri, por sapo e piu, menjëherë e volli.

Kur mjeshtri e pyeti se çfarë shije kishte, çiraku iu përgjigj me zemërim: "Të hidhur." Mjeshtri qeshi, e kapi çirakun për krahu dhe e nxori jashtë. Pastaj e çoi në buzë të një liqeni. Këtë herë i tha çirakut që të hidhte një grusht kripë në liqen dhe pastaj të pinte ujë nga liqeni. Çiraku përsëri e bëri atë që iu tha. Mjeshtri i bëri të njëjtën pyetje:

"Çfarë shije ka?" Këtë herë çiraku iu përgjigj: "Të këndshme." Mjeshtri e pyeti: "A e ndjeve shijen e kripës?" Çiraku iu përgjigj: "Jo." Këtë herë mjeshtri u ul pranë çirakut që po qëndronte në buzë të liqenit dhe i tha: "Problemet në jetë i ngjajnë kripës. Ato nuk janë as pak, as shumë. Masa e problemeve gjithmonë është e njëjtë, por shija e hidhur e këtyre problemeve ndjehet në varësi të asaj me të cilën e përziën. Ajo që duhet të bësh është që t'i zgjerosh ndjenjat në lidhje me problemin që të shkakton vuajtje. Për këtë arsye, mos u bëj si gota, por përpiqu të bëhesh si liqeni!.."

NJË THËNIE

*"Ndarja e bukës me të tjerët
është më e shijshme se vetë buka,
nëse ia dini shijen."*

(Nexhip Fazëll Kësakryrek)

NJË LUTJE

*"O Zot! Të kërkoj
mbrojtje nga pikëllimi, mërzhitja,
dembelizmi, frika, barra e borxhit
dhe tërbimi i njerëzve!"*

(Nesai, Istiadhe, 25.)



“...Me të vërtetë,
Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli,
derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete...”

(Ra'd, 11)

Filozofi nga Efesi, Herakliu (v. 435 p.e.s.), ka thënë: “Gjëja e vetme që nuk ndryshon është vetë ndryshimi.” Sigurisht se kjo është një urtësi e mbështetur në përvojë e vëzhgim dhe sigurisht që reflekton të vërtetën. Edhe Mevlana thotë: “Shikoje rrëkenë e rërës që po vërshon. Ajo as nuk ndalet dhe as nuk pushon. Shiko se si prishet kjo botë krejt papritur dhe se si i hedh themelet e një bote tjetër...”

Ndërkohë që fenomeni i ndryshimit realizohet sipas një rrjedhe të natyrshme në këtë botë dhe në gjithësi, te njeriu dhe në fushën e jetës sociale del në pah nga vullneti i individëve, domethënë, nga mundësia dhe aftësia për të ndryshuar. Edhe përgjegjësia që njeriu ka kundrejt sistemit hyjnor bazohet në këtë autoritet dhe aftësi. Njeriu është përgjegjës që ta realizojë ndryshimin në anë të mirësisë dhe që të mos bëhet burim i ndryshimeve për keq. Ai nuk e ka luksin që t’ua kthejë kurrizin edhe rrymave të këqija te të cilat nuk mund të ndikojë. Gjithashtu ai nuk e posedon mundësinë e gjetjes me anë të mendjes se si do ta kryejë këtë përgjegjësi. Për këtë arsye, këtu bëhet fjalë për ndërhyrjen e mesazhit hyjnor, pra, udhërrëfimit të fenomenit religjion.

Gjendja që sundon te egoja e njeriut mbart një strukturë të dyanshme si të qenët i mirë dhe i keq. Nisur nga kjo, kuptimi i përgjithshëm i ajetit në krye të shkrimit mund të jetë edhe kështu: “Përderisa një shoqëri të mos e lërë me vullnetin e saj që e posedon të drejtuarit nga e mira e të larguarit nga e keqja dhe të mos bjerë në shkatërrim e degradim, Allahu nuk ua përkeqëson gjendjen atyre dhe nuk e ndërpret prej tyre ndihmën e mbështetjen e Tij.” Ky kuptim gjenden i qartë edhe në këtë ajet fisnik: “**...Allahu nuk ia ndryshon kurrë një mirësi që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre...**” (Enfal, 53)

Koncepti mirësi, me kuptimin më të gjerë të tij, shpreh çdo gjë prej se cilën përfiton njeriu edhe nëse është apo jo i vetëdijshëm për këtë. Ajeti Fisnik: “**...Edhe nëse përpiqeni t’i numëroni dhuntitë e**

Allahut, nuk do të mund t’i numëroni dot...” (Ibrahim, 34), shpreh këtë përfshirje të gjerë të konceptit mirësi. Kurani Fisnik dhe Suneti i të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), këtë koncept gjithmonë e shtjellon në kuptimin e kujtimit të Allahut i cili i jep mirësitë dhe në kuptimin e të jetuarit sipas këtij rregulli. Nëse robi nuk e kujton Atë që i jep mirësitë, atëherë kjo gjendje mund të rezultojë me ndërprerjen e marrëdhënies së adhurimit në mënyrë direkte apo indirekte. Kur të ndodhë diçka e tillë, ndërprerja e marrëdhënies nuk bëhet më e njëanshme (pra, edhe Zoti e ndërpret marrëdhënien me robin) dhe fuqia që i jep mirësitë i kufizon ato ose i ndalon krejtësisht.

Nëse në shoqëri përjetohet një proces i keq, shkak është qëndrimet dhe orientimet e njeriut. Për këtë arsye, ne duhet ta parandalojmë çdo gjë e cila bëhet shkak për të mos e ndaluar ecurinë e keqe. Domethënë, duhet t’i përmirësojmë qëndrimet dhe sjelljet tona. Ndryshimi shoqëror është i lidhur në mënyrë të drejtë me vlerat shoqërore. Orientimin e ndryshimit për mirë apo për keq e caktojnë këto vlera shoqërore. Humbja e vlerave apo degradimi i tyre, e bëjnë të pashmangshme prishjen në strukturën shoqërore. Ky hadith fisnik e shpreh qartë këtë të vërtetë: “Allahu Teala i shpalli njërit prej pejgamberëve të Beni Israilëve: Nëse një popull apo pjesëtarë të një shtëpie shndërrohen në njerëz që bëjnë mëkate, Allahu do t’i shndërrojë ata në një gjendje që nuk e duan. Këtë të vërtetë e shpreh ajeti fisnik i cili thotë: “**...Allahu nuk ia ndryshon kurrë një mirësi që ia ka dhënë një populli, derisa ata të ndryshojnë atë që kanë në veten e tyre...**” (Enfal, 53)” (Ibn Ebi Hatim, Tefsir.)

Edhe njëri prej shkaqeve themelore të ecurisë së keqe te popujt është humbja e personalitetit dhe të ndjerët e vetes si i huaj. Për shkak të këtyre problemeve, vlerat vendase dhe esenciale hiqen nga qarkullimi. Pastaj shfaqet kriza e identitetit. Edhe nëse bëhet fjalë për mospërputhshmëri gjaku,

prirja për të zgjedhur atë që është më i fortë fillon ta shfaqë ekzistencën e saj si një faktor i fuqishëm. Diversitetet ndërmjet kulturave nuk janë pengesë për influencimin ndërmjet tyre, madje ky influencim është i pashmangshëm. Ajo që duhet të kemi kujdes është influencimi që i ndryshon gurët themelorë të strukturës së kulturës saqë ajo ta humbë thelbin e saj. Ata që i përkasin kësaj kulture që pëson këtë rezultat, lyhen me bojën e kulturës sunduese dhe e përvetësojnë atë. Hadithi fisnik në të cilin thuhet: *“Ai që përpiket të imitojë një popull, është prej tij.”* (Ebu Davud, Libas, 5.), tregon këtë të vërtetë socio-psikologjike.

Prej kushteve të domosdoshme të mirëqenies shoqërore është që, nëse jeta shoqërore ka një ecuri të mirë, njerëzit të jenë të vetëdijshëm për këtë, të përpiqen për ta mbajtur atë edhe në vazhdim dhe të kërkojnë mënyrat për një ecuri edhe më të mirë, por nëse bëhet fjalë për një ecuri të keqe, të përpiqen për ta rregulluar atë. Nëse këtë dëshirojmë ta themi me shprehjen e Kuranit Fisnik, atëherë mund të themi se mënyra për ta bërë këtë është përpjekja e vazhdueshme pa e humbur besimin, bindjen, falënderimin dhe vetëdijen e adhurimit ndaj Zotit (xh. sh.). Nëse arrihet të bëhet kjo, atëherë nuk ngelim të privuar nga mirësitë si shëndeti, siguria, mirëqenia, paqja dhe stabiliteti.

Asnjë ndryshim sociologjik nuk mund të realizohet në mënyrë të menjëhershme sikur të pritët me thikë. Ecuritë drejt të keqes përparojnë pa rënë në sy, dalë nga dalë, por duke i ngulur vazhdimisht rrënjët e tyre në shpirtin e shoqërisë. Kur gjendja të vihet re dhe të kërkohet për t'u rregulluar duke siguruar një ndryshim në drejtim të mirë, e njëjta e vërtetë sociologjike bëhet influencuese. Procesi kohor që përjetohet përgjatë prishjes, përjetohet edhe në procesin e rregullimit dhe ndërtimit. Edhe pse shoqëria politeiste arabe përjetoj një ndryshim mahnitës në një kohë të shkurtër me ardhjen e Islamit, procesi për ta përhapur në një kohë të caktuar shpalljen hyjnore, në mënyrë që të arrinte te rezultati, nuk mund ta lërë në hije të vërtetën që ka përjetuar.

Edhe shoqëritë ashtu si individët, i përvetësojnë dhe i absorbojnë mendimet, format e të jetuarit, qëndrimet dhe sjelljet me të cilat janë ushtruar që nga e kaluara dhe të cilat i konsiderojnë të vërteta. Çdo shoqëri është e kënaqur me besimin, mendimin dhe mënyrën e jetesës së saj. Kjo gjendje arrin deri aty saqë i shndërron këto në gurët themelorë të personalitetit të saj. Siç shprehet edhe Kurani Fisnik, tashmë: *“...Çdo grup është i kënaqur me besimin dhe qëndrimin e tij.”* (Rum, 32)

Gjërat që i pranojmë dhe prej të cilave jemi të kënaqur, kur të jetë e nevojshme na e vështirësojnë ndryshimin e veprimeve me të cilat jemi ushtruar, ndryshimin e qëndrimeve, ndryshimin e mënyrës së jetesës dhe ndryshimin e situatës a të mjedisit në të cilin gjendemi. Edhe pse gjendja është e tillë, në të vërtetë gjithmonë ndjehet nevoja për një ndryshim. “Askush nuk është kundër ndryshimit, mjafton që ky ndryshim të mos e prekë vetë atë.” (Ahmet Hamdi Tanpënar) Në këtë mënyrë, njerëzit thonë: “Ndryshimi është i nevojshëm, por le ta bëjnë të tjerët, jo unë.” Kam parë një karikaturë të lezetshme që e shprehte këtë të vërtetë. Folësi i pyeste dëgjuesit: “Kush do ndryshim?” Të gjithë e ngrinin dorën duke buzëqeshur. Ndërsa kur i pyeste: “Kush dëshiron ta ndryshojë veten e tij?”, të gjitha fytyrat ishin të varura, kokat të ulura para dhe asnjë dorë nuk i ngrihej. Pra, aty sundoi një heshtje e madhe. Gjallesa e vetme që po lëvizte në atë mjedis ishte një mizë që po fluturonte në ajër...

Ndërkohë që ecuritë e këqija dalin në pah “vetvetiu” apo lehtësisht me ndihmën e prirjeve negative brenda nesh, orientimet drejt të mirës kërkojnë një përpjekje, plan dhe sakrificë të veçantë. Këtu kam për qëllim perceptimin e jetës që i Dërguari i Allahut (s.a.s.), e ka cilësuar si *“xhihadi i madh”*. (Munavi, Fejzu'l-Kadir, Bejrut, 1994, III, 211.)

Tronditjet, fatkeqësitë dhe rëniet që po përjeton bota islame, po ndodhin brenda kornizës së ligjit të ndryshimit që Kurani Fisnik na e tërheq vëmendjen. Por Kurani Fisnik nuk i lë vetëm besimtarët e tij me situatën e keqe në të cilin gjenden dhe dëshpërimin. Atyre u jep shpresë, i inkurajon në çështjen për ta bërë ndryshimin drejt të mirës dhe jep sihariqin se sundimi përfundimtar do të jetë i të mirëve: *“Ne shënuam në Zebur, pas Teuratit, që tokën (e Xhenetit) do ta trashëgojnë robërit e Mitë mirë.”* (Enbija, 105) *“O ju që keni besuar! Nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t'ju ndihmojë ju...”* (Muhammed, 7) *“Nëse ju ndihmon Allahu, s'ka kush t'ju mposhtë...”* (Al Imran, 160)

Ne kemi nevojë t'i zbatojmë detyrat që i kemi nënvlerësuar, t'i lëmë mëkatet, të shfaqim vendosmëri në adhurim dhe t'i ndërrojmë me ndjenja të mira ndjenjat e këqija si urrejtja, mëria, mendjemadhësia, përçmimi i të tjerëve, etj. Kalimi mirë me njerëzit, të menduarit për të mirën e të tjerëve, shtëpia modeste dhe çdo lloj hapi që mund të hidhet për t'u bërë njerëz të përshtatshëm, do të shndërrohen në shkallë që e lartësojnë shpirtin tonë.



Abdullah ibn Amri (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Atë që mëshiron, e mëshiron edhe Rrahmani/i Gjithëmëshirshmi. Andaj, mëshirojini ata që janë në tokë, që t’ju mëshirojnë ata që janë në qiej.”

(Ebu Davud, Edeb, 58.)


Abdullah ibn Amr (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Atë që mëshiron, e mëshiron edhe Rrahmani/i Gjithëmëshirshmi. Andaj, mëshirojini ata që janë në tokë, në mënyrë që t’ju mëshirojnë edhe ata që janë në qiej.”* (Ebu Davud, Edeb, 58.)

Fëmijët në heshtje dhe pa nxjerrë asnjë zë e kanë lënë këtë botë ndërkohë që ne zgjohemi me cicërimat e zogjve, ndërkohë që çdo gjë shkon në rrugën e saj në mënyrë të jashtëzakonshme, ndërkohë që nuk kemi çfarë t’u themi rrobave tona (janë mjaft luksoze), ndërkohë që e llastojmë veten, ndërkohë që investojmë për veten, ndërkohë që veten e shndërrojmë në kala të sofistikuar dhe jetojmë vetëm brenda saj, ndërkohë që e ngremë cilësinë e jetesës dhe e rrisim komfortin, ndërkohë që kënaqemi, ndërkohë që mburremi me guston tonë dhe ndërkohë që dielli lind e perëndon vazhdimisht mbi këto që thamë. Mbi të gjitha, këtë e bënë pa e ndjerë askush. Ata ikën nga kjo botë duke ecur në majë të gishtave, në mënyrë që të mos na shqetësonin ndërgjegjen tonë dhe duke mos bërë zhurmë, në mënyrë që të mos i zgjonin ndjenjat tona që i kemi vënë në gjumë. Bashkë me çdo fëmijë që u nda nga jeta e kësaj bote, u pre me gërshërë të padukshme edhe një fije peri prej milionave fijeve të padukshme që bashkojnë tokën me qiellin. Pjesa tjetër e fijeve që e bashkojnë tokën me qiellin, na lanë bashkë me nënat që mbartin në krahët e tyre trupat e pajetë të fëmijëve të tyre. Një pjesë e këtyre nënave na lanë bashkë me baballarët që morën rrugën drejt thellësive të ujërave të errëta me gjithë fëmijët e vet. Një pjesë tjetër e tyre na la kur ndërmjet prindërve dhe fëmijëve u vendosën tela me gjemba. Një pjesë e tyre na la me lotët e baballarëve që u përzunë me fëmijët në krahë dhe që nuk gjenin dot një vend për t’u strehuar në të gjithë këtë planet madhështor. Një pjesë tjetër e tyre na la kur i qëllloi një plumb i kësaj bote trupin e vogël të një foshnje që akoma gjendet në barkun e nënës. Një pjesë e tyre na la kur filluan të binin bombat si shi mbi fëmijët që luanin në bregdet. Një pjesë tjetër e tyre na la kur

fëmijët filluan të dilnin të vdekur nëpër brigjet e kësaj bote...

Shkurtimisht, fije të panumërta dhe të padukshme që zgjaten nga qiejt në tokë, befasisht u këputën nga një palë gërshërë të padukshme dhe shirat pushuan. Për shkak të kësaj, tokat tona ngelën pa ujë dhe u thanë. Pikat e mëshirës/shiut duhet të kenë menduar se do të ndyhen nëse do të binin në tokë. Prandaj duhet të kenë hequr dorë nga rënia. A vëmë pikat e shiut? Që kur e kemi shkëputur lidhjen me qiejt, zemrat tona janë bërë më të shkreta se tokat joproduhuese. Tashmë nuk ka ngelë vend për asnjë gjallesë. Ndërkohë, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, na pati paralajmëruar me plot sinqeritet që të mos binim në këtë gjendje. Pejgamberi (s.a.s.), na pati lajmëruar se kur të mos e mbrojmë mëshirën në sipërfaqen e tokës dhe kur të mos e gjallërojmë zemrën me mëshirë, shirat do të zemërohen me ne, begatia do të na lërë dhe Zoti (xh.sh.), do ta tërheqë mëshirën prej nesh. Ne shkonim si miza nate rreth e rrotull zjarrit, ndërsa i Dërguari i Allahut (a.s.), na kapte dhe na ndalonte. Ai kërkoi që t’i hapim dyert me qiejt dhe të mos e shkëpusim lidhje me ta. Në këtë mënyrë, na pati treguar se mund ta arrinim mëshirën e Rrahmanit/Gjithëmëshirshmit duke u shprehur: *“Atë që mëshiron, e mëshiron edhe Rrahmani/i Gjithëmëshirshmi. Andaj, mëshirojini ata që janë në tokë, në mënyrë që t’ju mëshirojnë edhe ata që janë në qiej.”* (Ebu Davud, Edeb, 58.)

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, pati thënë se do të përfitojmë nga mëshira e qiellit përderisa t’i mëshirojmë ata që janë në tokë, por bota jonë u ndy aq shumë sa që fjalët e tij të dëlira nuk i zbatuam dot në jetën tonë. Pejgamberi (a.s.), gjithmonë na këshillonte për të mëshiruar dhe për t’i pakësuar e lehtësuar dhimbjet, por ne preferuam t’i shumëfishonim këto të fundit. Resulullahu (a.s.), gjithmonë na këshillonte për dhembshuri dhe na sugjeronte që t’i hapnim vend në zemër çdo krijese që mbart shpirt pa marrë parasysh llojin, identitetin



apo ngjyrën e saj, por ne preferuam që dhembshurinë ta ndjenim vetëm për veten tonë dhe ata që na ngjajnë ne. Ne vepruam me përzgjedhje në çështjen e mëshirës, dëgjua vetëm dhimbjen e atyre që na ngjanin dhe preferuam të qëndronim si të shurdhër kundrejt dhimbjes së të tjerëve. Ne u gëzuam ngaqë zjarri dogji vetëm vendin ku ra dhe nuk u përpoqën aspak për t'i fikur shtëpitë që po digjeshin. Ne hezitua për t'ia zgjatur dorën atyre që ranë dhe për t'ua mbyllur plagët të tjerëve. Asnjëherë nuk morën iniciativën për ta vendosur veten në vendin e të tjerëve, për t'i parë ata sikur të ishim në vendin e tyre dhe për të parë te ata veten tonë. Për shkak të kësaj, ngelëm të burgosur brenda vetes sonë. Ndërkohë ne mund të qëndrojmë qoftë edhe pak me të tjerët. Për t'u bërë vetvetja patjetër duhet ta kalojmë veten tonë dhe të hyjmë në botën e të tjerëve. Vetëm atëherë mund ta lartësojmë veten dhe mund të posedojmë një zemër sublime. Vetëm atëherë këmbët tona mund të shkapiten nga toka dhe të hapin derën e qiellit. Vetëm atëherë mund të shpresojmë te mëshira e të Gjithëmëshirshmit.

-Kur pra? Vetëm atëherë kur ta ndjejmë brenda vetes ngrohtësinë e mëshirës dhe mbi supet tona përgjegjësinë për të tjerët. A nuk mjafton për ta ndjerë mëshirën në zemrën tonë, në mënyrë që të bëhemi të mëshirshëm? Sigurisht që nuk mjafton. Mëshira nuk duhet të burgoset në zemër. Kush e thotë këtë? Gazaliu, i cili është zbuluesi i zemrave dhe dijetari që ka shkruar gjendjet dhe sëmundjet e ndryshme të zemrës. Madje, edhe shërimin e kësaj të fundit. Mirë, por çfarë thotë ai? Gazaliu thotë se për t'u bërë i mëshirshëm nuk mjafton të ndjesh mëshirë dhe dhembshuri. Njeriu duhet të ndjejë ngrohtësinë e mëshirës në zemër dhe barrën e saj mbi supe. Nisur nga kjo, njeriu duhet t'ia plotësojë nevojën të dobët, të varfrit dhe të dhunuarit. Mbi të gjitha, njeriu nuk duhet ta bëjë këtë për të rehatuar veten e tij, për ta bërë ndërgjegjen që të heshtë dhe për të shpëtuar nga dhimbja që të jep keqardhja për të tjerët, por për ta ndihmuar nevojtarin dhe për t'i dhënë zgjidhje atij që ka mbetur në mes të katër rrugëve. Vetëm atëherë, mëshira arrin përsosmërinë.

Jo, Imam Gazaliu nuk e ka vështirësuar këtë çështje. Njeriu sigurisht që nuk e ka të lehtë që të marrë në dorë llambën e mëshirës dhe ta ndriçojë të gjithë qytetin duke ecur nëpër të gjitha rrugët e tij, por a nuk ia vlen që të ndriçohet vetë? Të mëshirosh të tjerët është e vështirë, sepse shfaqja e mëshirës ndaj të tjerëve ia prish rehatinë njeriut. Sytë i mbushen me lot dhe fyti sikur i zihet. Mëshira kërkon që njeriu ta vendosë veten në vendin e tjetrit. Kjo nganjëherë i vjen njeriut më vështirë se të mbartë në supet e tij një barrë me tonelata. Nëse jeni prej atyre që thonë: ***"A ne ta ushqejmë atë që nuk i ka dhënë Allahu për t'u ushqyer?"*** (Jasin, 47), do të thotë se puna juaj është edhe më e vështirë, sepse të bëhesh "njeri" është shumë e vështirë. Ndërsa kur e nxjerrim mëshirën nga humanizmi, prej nesh, domethënë prej krijesës më të ndershme mbi tokë, ngelet një makineri krimi e lëvizshme dhe një mjet dhune e terrori me këmbë. Atëherë njeriu bie deri në atë gjendje sa që i tmerron edhe kafshët me tiraninë dhe barbarizmin e tij. Pastaj, edhe nëse pandeh se është i mëshirshëm, ky mendim i tij nuk është gjë tjetër përveçse një iluzion. Njeriu nuk mund të bëhet i mëshirshëm duke menduar se është i mëshirshëm. Gjithashtu, nuk mund t'u japë fund dhimbjeve duke ndjerë keqardhje. Nëse mëshira u përplasat të tjerëve në fytyrë duke e shfaqur atë si një nder ndaj tyre, prapë se prapë njeriu nuk mund të bëhet i mëshirshëm. Edhe dalja nëpër televizione duke e ekspozuar veten si të mëshirshëm, nuk e bën njeriun të mëshirshëm. Kur njeriu të veprojë në këtë mënyrë, thjeshtë lodhet madje edhe mund të rraskapitet, por ky veprim nuk është shërim për zemrat. Njeriu mund të bëhet i mëshirshëm vetëm kur të shfaqë butësi e dhembshuri jo vetëm ndaj njerëzve me të cilët ndan të njëjtën lagje, por kur ta bëjë këtë akt sublim kundrejt të gjitha krijesave që gjenden nën kupën e këtij qielli. Vetëm atëherë njeriu do ta kuptojë se nuk është shkapitur lidhja e qiejve me tokën. Vetëm atëherë mund ta ndjejë mëshirën e gjerë që zbret nga qielli për në tokë. Atëherë, duart do t'i lagen me shiun e kësaj mëshire...



SHITBLERJA E XHENETIT

Allahu nuk ka thënë: “do të vdisni si myslimanë”.

Pra, nga kjo kuptojmë se ne nuk kemi ndonjë garanci që frymën e fundit do ta japim si myslimanë dhe se në çdo çast jemi përballë rrezikut të rrëshqitjes së këmbës. Ky ajet vihet para nesh si një urdhër i Allahut.

Pra, “bëni ç'bëni, mos vdisni ndryshe, përveçse si myslimanë!”

Në fakt, kjo jetë sprove, na jepet si një mundësi e vetme, e cila as nuk mund të përsëritet, e as nuk mund të kompensohet me diçka tjetër...



Allahu i Madhëruar na ka krijuar nga asgjëja dhe midis të gjitha krijesave na ka bërë njerëz, midis të gjithë njerëzve na ka bërë besimtarë, e midis të gjithë besimtarëve na ka bërë prej umetit të Dërguarit të Tij, Muhamedit (a.s.). Të gjitha këto mirësi të mrekullueshme hyjnore i kemi arritur pa paguar asgjë në këmbim.

Po, ne kemi ardhur në këtë botë pa paguar asgjë. Mirëpo, në botën tjetër do të hyjmë duke paguar një çmim të caktuar, sepse Allahu i Madhëruar, kërkon “falënderim” prej nesh në këmbim të të gjitha mirësive që na ka dhuruar. Në Kuranin fisnik, urdhërohet:

“Nëse do t’i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t’i llogarisnit ato!..” (Nahl, 18)

“Pastaj, atë Ditë do të pyeten për kënaqësitë (e kësaj bote)!” (Tekathur, 8)

Një gjë është e vërtetë!.. Të pretendosh për zotërimin e diçkaje për të cilën nuk ke paguar asgjë në këmbim, nuk ka asnjë vlerë. Si besimtarë që jemi, gjëja më e çmuar për të cilën duhet të paguajmë,

është “besimi” ynë.

Elhamdulilah, ne jemi nderuar me besim në sajë të manifestimit të cilësisë “el-Hadi / Udhëzuesi” të Allahut të Madhëruar. Mirëpo, në Kuranin Fisnik, Ai urdhëron:

“O besimtarë! Kijeni frikë Allahun ashtu si i takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Al-i Imran, 102)

Nëse e analizojmë me vëmendje këtë ajet, vërejmë se Allahu nuk ka thënë: “do të vdisni si myslimanë”. Pra, nga kjo kuptojmë se ne nuk kemi ndonjë garanci që frymën e fundit do ta japim si myslimanë dhe se në çdo çast jemi përballë rrezikut të rrëshqitjes së këmbës. Ky ajet vihet para nesh si një urdhër i Allahut. Pra, **“bëni ç'bëni, mos vdisni ndryshe, përveçse si myslimanë!”** Në fakt, kjo jetë sprove, na jepet si një mundësi e vetme, e cila as nuk mund të përsëritet, e as nuk mund të kompensohet me diçka tjetër...

Atëherë, për ta dhënë frymën e fundit si myslimanë, ne jemi të detyruar ta mbrojmë besimin tonë,



qoftë edhe me jetë, të mos lëshojmë pe në të dhe t'i dalim zot në çdo situatë.

Gjëja më e vështirë në jetë, është të paguash në mënyrë të plotë mirësinë e besimit, sepse kjo nuk ka një kufi të caktuar. Për këtë arsye, është kusht që ne të përpiqemi në rrugë të Allahut me të gjitha mundësitë që kemi, deri në frymën e fundit, duke shpresuar mëshirën dhe faljen e Allahut të Madhëruar.

Besimi është një mirësi hyjnore. Ndërsa sprova është një njësi matëse e cilësisë së besimit. Kurse mbrojtja e besimit nga ana e njeriut, me adhurim, devotshmëri, mirësi, durim, falënderim, sakrificë, shërbim dhe dorëzim, janë çmimi i arritjes së shpërblimeve hyjnore me mirësinë e Allahut të Madhëruar. Pra, Zoti ynë i Madhëruar, me qëllim që ata ta kuptojnë mirë vlerën e mirësisë së besimit, kërkon prej robërve të Vet pagimin e një çmimi. Ndërsa për faktin se si do të kryhet pagesa e këtij çmimi, urdhëron:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit...” (Teube, 111)

Nga kjo, kuptohet qartë se kjo botë sprovash në të cilën gjendemi, është si një treg ku blihet Xheneti. Ndërsa jeta dhe pasuria jonë janë kapitali më i madh që kemi në këtë treg. Në fakt, të kujt janë jeta dhe pasuria? Kush është ai që ka dhënë jetën dhe pasurinë?.. Ne ndodhemi në një sprovë ku mirësitë që na ka dhënë Allahu i Madhëruar, do t'i dorëzojmë dhe do t'ia ofrojmë po Atij. Në Kuranin Fisnik hasim shpesh në shembujt e këtij realiteti. Për shembull, Ibrahim (a.s.), ky profet i madh i Allahut, u sprovua me jetën, pasurinë dhe fëmijën e tij. Ai pranoi të hidhej në zjarrin e madh të Nemrudit, vetëm e vetëm për të mbrojtur Teuhidin (besimin në një Zot të vetëm). E më në fund, zjarri u kthye në një kopsht trëndafilash për të. Ai e sakrifikoi të gjithë pasurinë për Allahun dhe u

nderua me titullin “Halilullah / Miku i Allahut”. Po ashtu, ai pranoi të flijojë edhe birin e tij të vetëm për të zbatuar urdhrin e Allahut të Madhëruar. Ndërsa Allahu i fali atij edhe fëmijën, por edhe një kurban prej Xhenetit. Ky pra ishte Ibrahim (a.s.), miku i Allahut të Madhëruar.

Gjithashtu, në Kuranin Fisnik, Allahu i Madhëruar na njofton edhe me shumë personazhe të tjerë prej të cilëve ka blerë jetët dhe pasurinë e tyre në këmbim të Xhenetit.

Kur As'hab-i Uhdud po hidheshin në hendeqet plot zjarr, kur Habib-i Nexhar po gurëzohej nga një popull zullumqar dhe kur magjistarët e faraonit po vareshin në pemët e hurmave duke ju prerë krahët dhe këmbët tërthorazi për shkak se i besuan Musait

(a.s.), ata nuk i kërkuan Allahut që t'i shpëton-te prej këtyre torturave dhe padrejtësive të kësaj bote, e të binin rehat në aspektin e kësaj jete. Dëshira e tyre e vetme, ishte të jepnin frymën e fundit si myslimanë, pa lëshuar pe në besimin e tyre, me qëllim që të dilnin të fituar në aspektin e jetës tjetër. Dhe për këtë arsye, për të mos treguar dobësi në besimin e tyre, ata iu lutën Allahut të Madhëruar me



këto fjalë:

“...O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe bëna të vdesim myslimanë!” (A'raf, 126)

Nëse shohim edhe në Epokën e Lumturisë, vërejmë të njëjtin shpirt besimi dhe të njëjtin entuziazëm. Sahabët e Profetit (a.s.), duruan vuajtje të mëdha për të paguar çmimin e mirësisë së besimit. Ata iu nënshtruan për disa vite me radhë padrejtësive, torturave dhe bojkoteve mizore të idhujtarëve në Mekë. Ata u detyruan t'i lënë shtëpitë, pasuritë dhe atdheun e tyre vetëm e vetëm për të pasur mundësi të ruajnë besimin në zemrat e tyre dhe emigruan në Medinë, ku u përballën me një përpjekje të madhe për besimin dhe ekzistencën e vet midis presionit

të madh që i shkaktonin idhujtarët dhe hipokritët në një anë dhe hebrenjtë në anën tjetër.

Njëri prej sahabëve, që iu nënshtua torturave të rëndë të idhujtarëve për hir të besimit të tij, Habbab bin Ereti (r.a.), tregon:

“Një ditë, kur i Dërguari i Allahut gjendej nën hijen e Qabesë, i shkuam pranë dhe në formën e një ankese, i treguam atij për torturat që hiqnim prej idhujtarëve. Më pas, i kërkuam atij t’i lutej Allahut për ndihmë, që të shpëtonim prej këtyre torturave. Mirëpo, i Dërguari i Allahut (a.s.), na tha:

«Ndër popujt e mëhershëm, një besimtar kapej dhe futej në një gropë. Pastaj ia ndanin kokën më dysh me sharrë dhe ia krihnin mishin dhe kockën me krehër hekuri. Por të gjitha këto, nuk mundën ta kthejnë atë nga feja e vet. Beto hem, se Allahu patjetër do ta bëjë mbizotëruese këtë fe... Por ju po nxitoheni (jeni të padurueshëm)!» (Buhari, Menakib 25, Menakibu'l-ensar 29, Menakib, 25, Ikrah, 1.)

Një tjetër prej sahabëve fisnikë, Abdullah bin Reuaha (r.a.), ishte një prej banorëve të Medinës që mori pjesë në Besëlidhjen e Akabes. Pasi u besatuan me të Dërguarin e Allahut (a.s.), se do të adhuronin vetëm Allahun, nuk do të bënin shirk dhe do ta ruanin Profetin (a.s.), siç ruanin jetët e tyre, ata pyetën:

“Çfarë do të kemi si shpërbtim nëse veprojmë kështu?” Profeti (a.s.), u përgjigj:

“*Keni Xhenetin!*” Pas kësaj përgjigjeje, të gjithë të pranishmit thanë:

“Sa tregti fitimprurëse! Ne as nuk kthehemi prej kësaj (fjalës së dhënë) dhe as nuk dëshirojmë që kjo të kthehet!” (Ibn Kethir, Tefsir, II, 406.)

Ja pra, edhe Abdullah bin Reuaha (r.a.), e kreu këtë shitblerje fitimprurëse të Xhenetit në betejën e Mutes. Pasi mori përgëzimin e të Dërguarit të Allahut (a.s.), se do të binte dëshmor, ai mori pjesë në betejë me vetëdije të plotë se do vdiste, pa e rrudhur aspak fytyrën e vet, e madje me një qetësi të madhe shpirtërore dhe dorëzim tek Allahu. Ai u bë shurdh ndaj vesveseve që i pëshpëriste egoja e vet, e cila donte t’ia bënte këtë botë të ëmbël, e vdekjen të hidhur dhe, të gjithë pasurinë ia fali thesarit të shte-

tit, ndërsa jetën e vet ia ofroi Allahut të Madhëruar, duke fituar kështu Xhenetet e Tij të larta.

Po kështu, edhe shumë sahabë të tjerë udhëtuan në çdo cep të botës me entuziazmin e shërbimit në rrugë të Allahut. Në çdo vend që shkelën, ata kumtuan Islamin me veprat dhe fjalët e tyre, duke vulosur në zemrat e njerëzve vulën e shenjtë të teuhidit. Në këtë mënyrë, ata treguan besnikërinë e tyre ndaj besatimit që kishin bërë me Allahun dhe të Dërguarin e Tij (a.s.).

Në lidhje me këtë besatim që u bë ndërmjet Profetit (a.s.) dhe myslimanëve të Medinës, u zbrit ky ajet fisnik -të cilin e kemi përmendur edhe më lart:-

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit.

Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i Tij i vërtetë në Teurat, Ungjill dhe Kuran. E kush i përmbahet besëlidhjes më fort se Allahu? Andaj, gëzojuni kësaj shitblerjeje! Kjo është fitorja madhështore.” (Teube, 111)

Sahabët gjithmonë e testonin besimin e tyre me përmbajtjen e këtij ajeti fisnik, sepse ata përherë i shihnin ngjarjet nga dritarja e botës tjetër me passionin që u jepte besimi. Ata e kishin kuptuar ashtu siç duhet thënien e Profetit (a.s.): “*Jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër!*” (Buhari, Rikak, 1.)

Për këtë arsye, vështirësitë e kësaj bote dhe vuajtjet që vinin

e shkonin, e kishin humbur rëndësinë në sytë e tyre. Ata kishin fatin e madh të të qenit së bashku me të Dërguarin e Allahut (a.s.), në këtë botë. Dhe, për ta përjetuar këtë lumturi edhe në botën tjetër, të gjitha vuajtjet dhe vështirësitë në rrugën e Allahut, ata i konsideronin si mirësi dhe mëshirë.

Një tjetër personazh i Besëlidhjes së Akabes, ishte edhe sahabiu Sa’d bin Hajthema (r.anhuma), i cili ishte edhe një prej dymbëdhjetë përfaqësuesve të zgjedhur për këtë besëlidhje. Sa’di dhe babai i tij Hajthema, hodhën short se cili prej të dyve do të merrte pjesë në betejën e Bedrit. Shorti i ra Sa’dit (r.a.). Mirëpo, babai i tij tha:

“Biri im! Bëj një sakrificë sot dhe më prefero mua në vend të vetes tënde, që të iki unë në betejë!”



Sa'di (r.a.), tha:

“O baba! Nëse në fund të kësaj do të kishte diçka tjetër në vend të Xhenetit, do të bëja ashtu siç thua ti!”

Si përfundim, Sa'di (r.a.), shkoi në Bedër sikur po shkonte në dasmë dhe atje ra dëshmor. Ndërsa babai i tij Hajtheme (r.a.), arriti gradën e dëshmorit në ditën e Uhudit. (Ibn-i Haxher, el-Isabe, III, 47, nr: 3156.)

Xhabir bin Abdullahu (r.anhuma), ka thënë:

“Një natë para betejës së Uhudit, babai më thirri pranë dhe më tha:

«Mendoj se unë do të jem i pari prej sahabëve të Profetit (a.s.), që do bien dëshmorë. Përveç të Dërguarit të Allahut, ti je njeriu më i çmuar që do të lë pas vetes. Paguaj borxhet që kam dhe sillu gjithmonë mirë me vëllezërit dhe motrat e tua!»

Sipas një transmetimi tjetër, entuziazmin e besimit që kishte, Abdullahu (r.a.), ia shprehu të birit me këto fjalë:

“Xhabir! Nëse në shtëpi nuk do të kishte vajza të cilat kërkojnë përkujdesje, do të doja që edhe ti bije dëshmor!..”

Xhabiri (r.a.), vazhdon të tregojë:

“Në mëngjes, babai im ishte i pari që ra dëshmor. E varrosa atë në një varr me një dëshmor tjetër. Më vonë, desha ta varrosja në një varr më vete. E nxora nga varri pas gjashtë muajsh. Por ç'të shihja, përveç (një pjese të) veshit, i gjithë trupi ishte si ditën kur e kisha varrosur! Më pas e varrosa atë në një varr të veçantë.” (Buhari, Xhenaiz, 78.)

Në një transmetim tjetër, Xhabiri (r.a.), tregon:

“Njëherë, kur isha i hidhëruar, u takova me të Dërguarin e Allahut (a.s.), e ai më tha:

«Përse po të shoh kështu të hidhëruar?»

«Babai im ra dëshmor në Uhud. Pas vetes la një familje të madhe që ka nevojë për përkujdesje dhe një sasi të madhe borxhi.» - i thashë unë. Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut tha:

«Të të tregoj se si e ka pritur Allahu babanë tënd?»

«Po!» i thashë unë dhe ai vazhdoi të tregojë:

«Allahu nuk flet me askënd ballë përballë, por gjithmonë pas një perdeje. Mirëpo, Ai e ringjalli babanë tënd dhe foli drejtpërdrejt me të pa perde, e i tha:

«O rob i im! Kërko ç'të duash prej meje, se do ta jap!» Babai yt tha:

«O Zot! Më ringjall, që të bie përsëri dëshmor në rrugën tënde!» Allahu i Madhëruar tha:

«Unë kam vendosur më parë, që të vdekurit nuk do të kthehen pas në dynja.»¹ Ndërsa babai yt tha:

«O Zot! Atëherë tregojua gjendjen time atyre që kam lënë pas meje!» Pas kësaj kërkesë, u zbrit ky ajet fisnik:

«Kursesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, ata janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë dëshmorë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).» (Al-i Imran, 169-170)” (Ibn-i Maxhe, Mukad-dime, 13/190.)

Ja pra, sahabët fisnikë, me këtë entuziazëm të shitblerjes së Xhenetit e lanë rehatinë si dëshmitarë të fesë së Allahut dhe u shpërndanë në të gjithë botën, duke shkuar deri në Kinë dhe Afrikë. Brenda një kohe të shkurtër, ata arritën deri në Oqeanin Atlantik. Ndërsa në kohën e Omer bin Abdulazizit u hodhën në Spanjë.

Ebu Ejjub el-Ensari (r.a.), shkoi dy herë në Stamboll, sepse ai u frikësua se mos po e hidhte në rrezik me duart e veta të ardhmen e tij në botën tjetër, nëse do të qëndronte larg përpjekjeve në rrugën e Allahut. Në këtë mënyrë, me dëshirën e zjarrit për të arritur përgëzimin që dha Profeti (a.s.), kur tha: “Kostandinopoja patjetër që do të çlirohet!..”², ai mori pjesë në fushatën e Kostandinopojës në moshë tetëdhjetë e ca vjeçare.

Në fushatën e dytë, ai ndërroi jetë përballë Kostandinopojës. E ndërkohë që po jepte frymën e fundit,

Besimi

është një

mirësi hyjnore.

Ndërsa sprova është

një njësi matëse e cilësisë së besimit.

Kurse mbrojtja e besimit nga ana e njeriut, me adhurim, devotshmëri, mirësi, durim, falënderim, sakrificë, shërbim dhe dorëzim, janë çmimi i arritjes së shpërblimeve hyjnore me mirësinë e Allahut të Madhëruar.



1. Tirmidhi, Tefsir, 3/3010.

2. Ahmed, IV, 335; Hakim, IV, 468/8300.

Kur zbriti ajeti, "Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni!..", Ebu Talha (r.a.), i tha të Dërguarit të Allahut (a.s.):

"O i Dërguar i Allahut!.. Pasuria që dua më shumë, është kopshti i hurmave Bejruha, të cilin po e fal për hir të Allahut. Shpresoj që Allahu të më japë shpërblimin e saj dhe që ajo të jetë kapitali im në botën tjetër..." Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

"Të përgëzoj! Kjo është pasuri fitimprurëse!..."
(Shih. Buhari, Zekat, 44; Muslim, Zekat, 42, 43.)



tha: "Më varrosni në pikën e fundit që do të mund të hidhni hapin, me qëllim që ushtarët e tjerë të Islamit që do të vijnë pas meje, të shkojnë edhe më tutje!" Në këtë mënyrë, ai la si trashëgimi horizontin e vërtetë të një myslimani, duke i orientuar brezat e ardhshëm si me jetën, ashtu edhe vdekjen e vet.

Të gjitha këto, janë tablo të sprovave hyjnore ku sahabët fisnikë që ia kishin kushtuar veten Allahut blenë Xhenetin në këmbim të jetëve dhe pasurive të tyre... Ato ishin zemra që kënaqeshin dhe qetësoheshin me përmendjen e Allahut të Madhëruar... Zemra ku mirësitë e kësaj bote nuk kishin vlerë, ndërkohë që kënaqësia e Allahut zinte majat...

Shembulli më i bukur ndër të gjithë këta personalitete të lartë, që shkëlqejnë si yje në qiell, padyshim ka qenë Ebu Bekri (r.a.).

Një ditë, Profeti (a.s.), tha:

"Sa kam pasur dobi prej pasurisë së Ebu Bekrit, nuk kam pasur prej pasurisë së askujt tjetër!.." Ndërsa Ebu Bekri (r.a.), me lot në sy përballë kësaj mirënjohjeje tha:

"A nuk jam unë dhe pasuria ime vetëm për ty o i Dërguar i Allahut?!³

Me këtë, Ebu Bekri (r.a.), tregoi edhe njëherë se ai ia kishte kushtuar të gjithë qenien e vet Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.).

Ai, disa herë ia ka sjellë të gjithë pasurinë të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe njësoj si ai, e dhuronte atë pa pasur aspak frikë nga varfëria. Madje, kur Profeti (a.s.), e pyeti: *"Çfarë le për familjen o Ebu Bekër?"*, ai me zemër të hapur e të qetë tha:

"Allahun dhe të Dërguarin e Tij!.." (Ebu Daud, Zekat, 40.)

Një tjetër sahab i zgjedhur që ka dalë i fituar në shitblerjen e Xhenetit duke dhënë bujarisht dhe pa kursyer prej jetës dhe pasurisë së vet, është Osmani (r.a.). Ky sahab i bekuar, i cili ishte monumenti i bujarisë dhe ndrojtjes, kur emigroi në Medinë, vuri re se myslimanët vuanin për ujë. Të gjithë pusët në Medinë kishin ujë të hidhur, përveç ujit të pusit Rume, që i përkiste një hebreu, i cili siguronte të ardhurat e veta prej tij. Osmani (r.a.), e bleu këtë pus prej hebreut duke paguar një çmim shumë të lartë. Pas kësaj, Profeti (a.s.), e pyeti:

"A mund ta dhurosh si vakëf këtë pus, që njerëzit të pinë ujë prej tij?" Osmani (r.a.), e dhuroi këtë pus pa ngurrar asnjë çast. Madje, duke shfaqur edhe një virtut tjetër të lartë, ai qëndronte në radhë si gjithë të tjetër për të marrë ujë prej pusit që dhuroi si vakëf. Sipas një transmetimi, në lidhje me këtë sakrificë të pashoqe të Osmanit (r.a.), ka zbritur ky ajet fisnik:

"O ti shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt, ti i kënaqur me Atë dhe Ai kënaqur me ty! Bashkohu me robërit e Mi dhe hyr në Xhenetin Tim!"
(Fexhr, 27-30)

Kur Islami filloi të përhapej me shpejtësi, popullsia e Medinës u shtua shumë. Për rrjedhojë, Mexhidi Nebeui filloi të mos mjaftonte më për besimtarët, duke bërë të domosdoshme zgjerimin e tij. Edhe këtë përgjegjësi e mori përsipër Osmani (r.a.), me ç'rast u zbrit edhe ky ajet fisnik:

"Faltoret e Allahut i vizitojnë dhe i mirëmbajnë vetëm ata që besojnë Allahun dhe Ditën e Fundit, që falin namazin dhe japin zekatin, e që nuk i frikësohen askujt, përveç Allahut. Sigurisht që këta janë në rrugë të drejtë." (Teube, 18)

Gjithashtu, në betejën e Tebukut, në të cilën mys-

3. Ibn-i Maxhe, Fedailu As'habi'n-Nebi, 11.

limanët nuk gjenin kafshë për të udhëtuar, duke qenë të detyruar të udhëtonin tre persona me radhë në një deve, ky sahab i madh përgatiti treqind deve me të gjitha pajimet dhe ia fali ushtrisë.

Njëherë, gjatë periudhës së kalifatit të Ebu Bekrit (r.a.), Medinën e kaploi një zi e madhe. Për këtë arsye, Osmani (r.a.), solli njëqind ngarkesa deveje me grurë prej Shamit. Kur panë karvanin, njerëzit shkuan me vrap për të blerë grurë. Madje, kishte edhe nga ata që donin të jepnin shtatë dirhem për një dirhem grurë. Mirëpo, Osmani (r.a.), tha:

“Jo! Unë do t’ia shes njërit që jep më shumë se ju.”

Sahabët u mërzitën nga kjo dhe shkuan tek kalifi për t’u ankuar. Mirëpo, Ebu Bekri (r.a.), i cili e kish-te kuptuar qëllimin e fjalëve të Osmanit (r.a.), tha:

“Mos mendoni menjëherë keq për Osmanin!.. Ai është dhëndri i të Dërguarit të Allahut dhe shoku i tij në Xhenetin Me’ua. Padyshim se ju e keni kuptuar gabim fjalën e tij.” Më pas, shkuan të gjithë së bashku tek Osmani (r.a.). Me të arritur tek ai, Ebu Bekri (r.a.), tha:

“O Osman! Sahabët janë mërzitur prej fjalës tënde!” Pas këtyre fjalëve, Osmani (r.a.), tha:

“O halifja i të Dërguarit të Allahut! Këta japin shtatë për një, ndërsa Allahu i Madhëruar jep shtatëqind për një. Prandaj unë ia kam shitur grurin Atij që jep shtatëqind për një.”

Më pas, e fali të gjithë ngarkesën e njëqind deveve me grurë për të varfrit e Medinës. Ndërsa njëqind devetë i theri si kurban.

Ky ishte Osmani (r.a.), i cili kur mori mbi supë përgjegjësinë e umetit dhe u bë kalif, u vra padrejtësisht, duke u bërë prej fatlumëve që e kanë blerë Xhenetin edhe me jetën e vet.

Ndër të gjithë ensarët, Ebu Talha (r.a.), ishte ai që kishte më shumë hurma në Medinë. Dhe, pasuria që ai kishte më shumë përzemër, ishte kopshti i hurmave i quajtur Bejruha, i cili ndodhej përballë Mesxhidit Nebeui. Herë-herë, i Dërguari i Allahut (a.s.), hynte në këtë kopsht dhe pinte prej ujit të tij.

Kur zbriti ajeti, “**Nuk keni për ta arritur përkushtimin e vërtetë, derisa të ndani (lëmoshë) nga ajo (pasuri) që e doni!..**”⁴, Ebu Talha (r.a.), i tha të Dërguarit të Allahut (a.s.):

“O i Dërguar i Allahut!.. Pasuria që dua më shumë, është kopshti i hurmave Bejruha, të cilin po e fal për hir të Allahut. Shpresoj që Allahu të më japë shpërblimin e saj dhe që ajo të jetë kapitali im në botën tjetër..” Pas këtyre fjalëve, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“**Të përgëzoj! Kjo është pasuri fitimprurëse!..**” (Shih. Buhari, Zekat, 44; Muslim, Zekat, 42, 43.)

Ky pra ishte horizonti i botëkuptimit të sahabëve. Për çdo ajet që zbriste, ata thoshin “dëgjuam dhe u bindëm”⁵ dhe, duke e përvetësuar atë ajet, përpiqeshin të fitonin kënaqësinë e Allahut. Për këtë arsye, Xhabiri (r.a.), ka thënë:

“Nuk njoh asnjë prej muhaxhirëve dhe ensarëve që kanë mundësi (ekonomike), e të mos kenë vakëf.” (Ibn Kudame, el-Mugni, V, 598.)

Edhe të parët tanë, Osmanët, kanë jetuar me të njëjtin shpirt. Për këtë arsye, ata e kanë kthyer vendin e tyre në një qytetërim vakëfesh. Kjo, sepse ata ishin besimtarë të devotshëm që jetonin me urtësinë e sakrifikimit të botës së përkohshme për të fituar botën e përjetshme dhe përpiqeshin të paguanin çmimin e mirësisë së besimit me botëkuptimin se, “jeta e vërtetë është ajo e

botës tjetër”.

Çdo qytetërim ndërton një tip njeriu të veçantë. Kështu edhe ne, si pasardhësit e të parëve tanë fisnikë, jemi përballë një përgjegjësie të madhe...

Allahu i Madhëruar, na bëftë të gjithëve prej robërve fatlumë, të cilët e ndajnë në supet e veta peshën e amanetit që bartin, që derdhin djersë po aq sa derdhin edhe lot për të ndihmuar nevojtarët, për të cilët kanë përgjegjësi dhe që dalin të fituar prej kësaj shitblerjeje të përjetësisë në pazarin e kësaj bote të përkohshme!

Amin!

4. Al-i Imran, 92.

5. shih. Bekare, 285.



EL-KAHHAR

TRIUMFUESI ABSOLUT

— Ilir Hoxha —

Sot jetojmë në një botë ku po përhapet përditë e më shumë ideologjia se njeriu është poseduesi i vërtetë i jetës së vet, se mund të bëjë çdo gjë që dëshiron, ashtu siç dëshiron dhe se askush nuk mund ta pengojë atë. Ky nuk është vetëm një refuzim i autoritetit në jetën shoqërore, por në të njëjtën kohë, edhe një refuzim i autoritetit hyjnor... Mund të ketë shumë njerëz që e ndjejnë veten më afër kësaj ideje për shkak se nuk duan të jenë në ekstremin tjetër, ku mendojnë se nuk kanë të drejtë fjale në asnjë çështje.

Në fakt, ideja se ne jemi poseduesit e padiskutueshëm të jetës sonë dhe se nuk kemi asnjë autoritet mbi krye, pa e kuptuar se në të njëjtën kohë kjo do të thotë se jemi edhe të vetmit përgjegjës për gjithçka që ndodh, mund të na bëjë të ndihemi të vetëkënaqur. Mirëpo, kur shohim historinë e mohimit dhe idhujtarisë që na jepet në Kuranin Fisnik, vërejmë se edhe liderët e mohimit kanë ndezur pikërisht të njëjtat ide me një mendjemadhësi të pashërueshme, duke vënë në pikëpyetje edhe fuqinë e Allahut të Madhëruar. Ndërsa Zoti ynë, herë pas here u kujton atyre forcën e Tij shtypëse si një thirrje drejt udhëzimit. Pra, fuqinë e Tij të pakufishme, superioritetin e Tij shtypës dhe sundimin që ka në grushtin e Tij... Kjo forcë shtypëse, ndonjëherë manifestohet në këtë botë, duke u thyer hundët mohuesve. (shih. Bekare, 211; En'am, 6; Hud, 102.) Ndonjëherë, e shohim kur jemi përballë vdekjes, se kush është i plotfuqishmi absolut. (shih. En'am, 61.) E ndonjëherë, Allahu e thekson forcën e Tij kur tregon skenat e kijametit... (shih. Gafir, 16; Ibrahim, 48.)

Në Kuranin Fisnik, emri Kahhar përmendet në gjashtë vende dhe në të gjitha këto vjen pas emrin Uahid. Përveç kësaj, të gjitha suret ku përmendet

ky emër hyjnor janë të periudhës së Mekës, gjë e cila tregon se sa rëndësi ka qenia e Allahut Uahid dhe Kahhar në anulimin e idhujtarisë dhe luftën për vendosjen e teuhidit. Ndërkohë që me cilësinë Kahhar thekson kotësinë e shkaqeve të idhujtarisë, me cilësinë Uahid instalon teuhidin në mendjen tonë. Gjithçka që njerëzit kthejnë në idhull janë shumë të dobët dhe të pafuqishëm përballë Allahut që është Kahhar. Ndërsa Vet Allahu është Sunduesi i vetëm i gjithësisë. (shih. Jusuf, 39; Sad, 65.)

Në fakt, Allahu i Madhëruar na e kujton këtë cilësi të Vetën me qëllim që të na thërrasë në udhëzim. Mirëpo, ftesa për udhëzim nuk fillohet duke kujtuar “forcën shtypëse”, por duke sjell argumente të logjikshme që i drejtohen mendjes dhe ndjenjave. (shih. Ra'd, 16.) E në fakt, ata që e gjejnë Allahun në argumentet që Ai ka shfaqur në Librin që ka zbrietur dhe Gjithësinë që ka krijuar, i përulen Allahut me një dorëzim që buron prej respektit ndaj së vërtetës. Por nëse kjo nuk ndikon tek njeriu, Zoti ynë na paralajmëron duke na kujtuar fatkeqësi dhe katastrofa të ndryshme që kanë ndodhur në të shkuarën. Në këtë kuptim, historitë e shkatërrimeve që tregohen në Kuran, janë historia e forcës shtypëse të Zotit. Nëse kemi parasysh se Zoti ynë është edhe mbrojtësi ynë, atëherë, këto paralajmërime nuk duhet t'i shohim si kërcënime të tmerrshme, por si paralajmërimin e një të dashurit tonë, i cili shqetësohet për ne në lidhje me përfundimin që do të kemi.

Nëse shihet nga ky aspekt, do të kuptojmë se pas cilësisë “Kahhar”, të Allahut të Madhëruar, fshihet edhe mirësia, edhe mëshira e Tij gjithëpërfshirëse. (shih. A'raf, 156.) Por nëse edhe paralajmërimet nuk ndikojnë, atëherë e ka radhën zbatimi i drejtësisë. Dhe pikërisht në këtë pikë, ndonjëherë

drejtësia manifestohet si një forcë shtypëse (kahr) e pakufishme. Për këtë arsye, fakti që Allahu është Kahhar, për disa është një kërcënim, ndërsa për disa të tjerë është ngushëllim. Ndërsa detyra jonë është të zgjedhim anën.

Çdo kryengritje ndaj Allahut, i Cili është Kahhar, kthehet kundër atij që ngre krye. Dhe pikërisht për këtë arsye, e vetmja mundësi për të shpëtuar nga dënimi poshtërues i Allahut, është strehimi po tek Ai. (shih. En'am, 17-18.) Ndërsa ky strehim fillon me pendimin ndaj gabimeve që na çuan në dënimin e Allahut dhe do të vazhdojë me përpjekjet për të vepruar punë të mira në jetën tonë.

Ndonjëherë mund të ndodh të përjetojmë hidhërime jo për shkak të gabimeve personale... Për shembull siç janë luftërat botërore, sëmundjet ngjitëse, katastrofat natyrore, etj. Në këtë rast, me qëllim që këto sprova të përvitueshme të rezultojnë në favorin tonë, e vetmja gjë që mund të bëjmë, është një durim me përlulje. Pavarësisht se ky lloj durimi disave mund t'u duket si një pasivitet idiot, në fakt ai është një virtyt shumë i lartë që kërkon një forcë të madhe. Prandaj nuk duhet harruar se vetëm në sajë të këtij virtyti mund t'i kalojmë sprovat e Allahut të Madhëruar.

Kur Allahu i Madhëruar na tregon në Kuranin Fisnik për shkatërrimin e popujve të shkuar, na shpjegon edhe shkakun përse Ai i ka shkatërruar ata. Dhe kjo na tregon se dënimi i Allahut nuk realizohet për çështje qefji, por si një shkak-pasojë.

Allahu i Madhëruar, me emrat e Tij që shprehin fuqinë dhe forcën, është manifestuar tek materia dhe qeniet pa vullnet, duke nxjerr në pah një rregull të pashoq. Ndërsa manifestimi që kërkohet, me qëllim që sjelljet e vullnetshme të njeriut të jenë në përputhje me këtë rregull, është lënë dorë të vetë njeriut. Megjithatë Allahu i Madhëruar është Kahhar (ka forcë shtypëse) dhe Xhebbar (forcë detyruese), Ai nuk i ka detyruar njerëzit të besojnë dhe, po ashtu, e ka paralajmëruar edhe Profetin (a.s.), se as ai nuk e ka një autoritet të tillë. (shih. Sad, 65.)

Që njeriu t'i përshtatet rregullit të krijuar nga Allahu në këtë botë dhe si përfundim të fitojë xhenetin, ai duhet të kapërcejë disa pengesa para vetes. Këto pengesa janë shejtani dhe forcat e egos, si zemërimi, epshi dhe dhënia pas kënaqësive të

kësaj bote. Dhe këto pengesa mund të kapërcehen vetëm me manifestimin e cilësisë Kahhar të Allahut të Madhëruar. Kur kjo cilësi të manifestohet, njeriu i ka mbizotëruar të gjithë faktorët e jashtëm dhe të brendshëm, me të cilat ai dëmton veten dhe nuk do të jetë më lodër në dorën e asgjë.

Një mysliman që i njeh emrat e Allahut, si Kahir, Kahhar dhe Galib, ndjen një frikë e cila buron nga një respekt i thellë kundrejt Allahut. Një njeri që i sheh të gjithë Emrat e Bukur të Allahut, e kupton se, dashuria për Allahun, e cila nuk përmban respekt dhe frikë në të njëjtën kohë, nuk është një dashuri e vërtetë. Kjo, sepse në thellësi të përbërjes së njeriut, ashtu si dashuria, edhe frika është një faktor motivues.

Njeriu, gjithë jetën përpjeket të arrijë gjërat që do dhe të largohet nga gjërat që ka frikë. Tek disa mbizotëron instinkti i arritjes, e tek disa të tjerë ai i largimit. Këtu, ajo që kërkohet të arrihet janë emrat e Allahut të Madhëruar që shprehin, falje, mëshirë, mirësi dhe bukuri. Ndërsa ajo prej së cilës frikësohet dhe kërkohet të largohet, janë cilësitë e Allahut (jo Vetë Ai), që shprehin dënim, zemërim, hakmarrje dhe poshtërim. Ky lloj motivimi i dyanshëm përshtatet me dy ndjenjat themelore të njeriut në kërkimin e lumturisë.

Në këtë mënyrë, asnjë njeri nuk do të mbetet jashtë ftesës për udhëzim. Gjithsecili kapet dhe ngrihet një shkallë më sipër, në sajë të asaj me të cilën motivohet më tepër. Kështu arrihet edhe mbizotërimi ndaj shejtanit dhe egos.

E kundërta e cilësisë Kahhar të Allahut, është cilësia që shpreh mirësi. Dhe Allahu i Madhëruar, ka krijuar shkaqe edhe për fitimin e mirësisë, edhe për fitimin e dënimit të Tij. Duke filluar që prej besimit, të gjitha virtytet e bukura janë shkaqe që të çojnë drejt mirësisë së Allahut. Po ashtu, duke filluar që prej mohimit (kufrit), të gjitha cilësitë e këqija janë shkaqe që të çojnë drejt dënimit të Allahut.

Ne duhet të ruhem i sa të mundemi prej cilësive dhe veprave të këqija që të çojnë drejt dënimit të Allahut. Po ashtu nuk duhet të harrojmë se, si mirësia, ashtu edhe dënimi i Allahut mund të vijnë edhe nëpërmjet robërve të Tij. Për rrjedhojë, duhet të bëjmë kujdes të mos bëhemi aq të këqij sa t'i bëjmë të tjerët mjet dënimi të Allahut.

Të shpresojmë të bëhemi shkak i mirësisë, e jo i dënimit të Allahut!..





— Nuredin Nazarko —

A ka mbetur ende vend PËR REFLEKSION?

Refleksioni është një nga mirësitë e dhëna njeriut. Nuk mund të themi që është një nga të shumtat, sepse çdo e mirë në vetvete është e veçantë dhe rrëzëllitëse, sado e vogël qoftë. Refleksioni është një operacion krejt natyral që nxitet dhe vihet në lëvizje nga ngjarjet që shtresohen në shpirtin njerëzor, edhe pse një pjesë e tyre mund që harrohen në shtjellat e kohës që rrjedh. Është një operacion pa të cilin njerëzorja brenda qenies njerëzore nuk do të ishte më një projekt në mundësi. Duke qenë projekt në mundësi ekziston edhe refleksioni.

Ngjarjet që na shoqërojnë një pas një shënjojnë tragat e tyre. Thellësia e përjetimit të tyre na jep lëndën e parë të refleksionit. Këtu e kemi fjalën për ato ngjarje të cilat përbëjnë çastet kyçe në rrjedhën e jetës, ndodhia e të cilave na çon në ndryshime epokale brenda oqeanit të të qënurit qenie njerëzore. Refleksioni mbi këto ndryshime epokale duhet të jetë po aq epokal, në mënyrë që ndryshimi që do ta pasojë refleksionin të jetë në kohezion me atë që kërkojnë realisht parimet dhe shkakësitë parake.

Ndonjë syresh mund të shtrojë pyetjen: E përse na nevojitet refleksioni? Pse kaq me vlerë qenka që ne t'i kushtojmë kaq shumë vëmendje, kaq shumë energji?

Po pse shtrohet kjo pyetje? Pse refleksioni perceptohet si i panevojshëm? Dhe për më tepër i refuzueshëm pavarësisht gjendjes në të cilën kalon qenia njerëzore për të mbërritur në aktualitet.

Këta syresh që refuzojnë refleksionin besojnë katërçipërisht se qysh nga momenti që kanë krijuar

disa bindje të palëkundura se kanë prekur apogjeun, janë të panevojshëm për të kthyer kokën pas. Nuk duan kurrësi të kthejnë kokën pas, sepse besojnë fuqishëm se duhet ecur vetëm para. Kthimin e kokës pas e quajnë humbje kohe dhe për më tepër e vulosin të kaluarën e tyre me justifikimin – *kështu ishte shkruar*.

Kthimi i kokës pas nuk do të thotë domosdoshmërisht që ne do të ecim në hartën e jetës më sytë nga e kaluara për të mos parë të ardhmen. Por edhe vetëm të rendim pa parë se çfarë kemi lënë pas, me bindjen e verbër se kemi bërë gjithçka mirë, nuk është akti i duhur. Duhet kthyer koka pas që të shohim. Të shohim dhe të kundrojmë mirë çfarë gjurmësh kemi lënë. Çfarë bimësh kemi mbjellë. Çfarë pemësh kemi kultivuar. Çfarë tokash kemi lëvruar. Çfarë farash kemi hedhur në këto toka. Çfarë shërbimesh kemi kryer ndaj gjithësa kemi dashur të kultivojmë që të kemi fryte cilësore në jetë. Pikërisht për këto arsye duhet kthyer koka pas. Ecim drejt së ardhmes por jo me verbëri furtunë, ku nuk shohim as pas, as majtas, as djathtas. Nëse ndodh që syresh të caktuar rendin në këtë lloj mjegulline kjo nuk është aspak shenjë e mirë për ta.

Të pretendosh që ke bërë gjithçka mirë në të kaluarën tëndë është më shumë se katastrofike, qoftë edhe atëherë kur ndryshe nga shumë të tjerë je përkapur pas parimeve dhe shkakësive parake. Madje nëse ka qenë kështu dhe pretendon që s'ke nevojë për refleksion gjendja është edhe më e rëndë se më shumë se katastrofike. Është kështu dhe s'mund të



jetë ndryshe, sepse kjo bindje nuk të lejon të shohësh çfarë ke katranosur në jetën tënde.

Ne si qenie njerëzore jemi gabimtarë nga natyra. Atëherë si është e mundur që syresh të caktuar të krijojnë bindjen e verbër që s'kanë nevojë për refleksion? Kemi bërë kaq e kaq gabime në të kaluarën tonë sa që duhet të reflektojmë çdo sekondë. Kjo nuk do të thotë që ne do të kthehemi pas në kohë dhe do të ndryshojmë rrjedhën e dikurshme të jetës. Kjo do të thotë që ne duhet të bëhemi më syçelë, më të qartë, dhe më të vetëdijshëm mbi mundësitë tona si qenie, për të çuar një jetë në kohezion me parimet dhe shkakësitë paraqe.

Ne nuk do të tolerojmë vendosjen apo rivendosjen e modelit papagall brenda qenies tonë pas gjithë kësaj përvoje të çmuar jetësore. Nuk mund të rikthejmë e t'i japim jetë një modeli i cili na dha përvojën e çmuar të asaj që nuk duhet të jemi. Nuk mund të lejojmë kurrsesi të ribëjmë të njëjtat gabime në aktualitet. Nëse ne do të lejojmë të ndodhnin sërish këto gabime, atëherë paskemi shpenzuar vite të tëra jetë kot dhe paskemi mbetur ende pengje të një modeli që duhet shporrur një sahat e më parë nga brendësia jonë.

Pikërisht model që duhet shporrur është modeli papagall, sepse ky model vdes jetën që duhet të na karakterizojë. Vdes dinamizmin që duhet të na shtyjë në lëvizje të vazhdueshme drejt burimeve të mirësisë që është kaq e gjerë, sa që nuk mund të përkufizohet nga disa përcaktime të ashtuquajtura shteruese. Kushdo që rropatet të shterojë me për-

caktime të fundme oqeanin e dijes tregon se është një lundërtar i vogël që pellgaçja i shfaqet si oqean. Model që duhet groposur është modeli papagall. Ende nuk janë qartësuar sa duhet itharët e këtij modeli mbi gjerësinë përmbledhëse të koncepteve themelore, kuptimësia e të cilëve duhet vjelë në stinën e duhur prej parimeve dhe shkakësive paraqe. Nëse dikush nga dëshira e madhe që ka për të shijuar frutat nxiton t'i vjelë para kohe dhe nuk ka durim të presë stinën e duhur, edhe vetë do të thar-tohet edhe të tjerët do t'i thartojë. Ky është model që nuk ka durim të presë stinën e duhur të vjelë frutat e pjekur mirë dhe me ëmbëlsi krejt natyrore.

Nëse do të kishte patur dëshirën e mirë për refleksion me siguri që në aktualitet do të mësonte të duronte, për të pritur kohën kur piqen frutat dhe kështu do të ëmbëlsonte veten dhe të tjerët. Por jo! Është i frikësuar të dalë nga kullëza ku është kyçur. Ka krijuar stabilitet dhe frikësohet ta kthejë dinamizmin në epiqendrën e akteve jetësore. Trembet për vdekje nga rrënojat mbi të cilat duhet të shkelë që të zbulojë thesaret e virtyteve të humbura në humbë-tirën e modelit papagall. I mësuar prej kohësh me rutinën kallp nuk dekonstruktohet në përbrendësinë e vet dhe për aq sa nuk dekonstruktohet nuk mund të frymojë si qenie në mundësi.

Do përpiqet të riciklohet vazhdimisht ky model, sepse ndihet ngrohtë nën jorganin e hershëm. Nuk do që të shkallmojë akujt që e kanë mbërthyer në të katër anët, sepse e ndjen që përtej atyre akujve është akoma edhe më ngricë për një model që përvoja e dëshmoi si të pavlefshëm, të papjekur dhe mbi të gjitha të pavaditur me urtësi dhe vizion.

Nëse edhe pas gjithë thartësisë që shijua nga frutat e papjekura, të këputura dhe të shërbyera jo në stinën e duhur, modelet papagall nuk kanë ndërmend të hyjnë në udhën e refleksionit atëherë ç'mbetet të bëhet? A ka ende vend për refleksion? A ka ende hapësirë për dekonstruktivitet dhe për rikthim tek mundësitë e çuara dëm në një kohë që tashmë nuk e kthejmë dot pas?

Natyrisht që hapësira për dekonstrukcion dhe për të dalë në udhën e refleksionit ka patur gjithmonë. Vetëm se në atë kohë ajo udhë nuk ishte e çelur, sepse ne ende nuk ishim gati për ta kryer refleksionin në kohezion më atë që kërkonte natyrshmëria. Kjo udhë është e mbyllur për këdo që nuk është ende gati për kohezion. Kjo udhë është e çelur për këdo që është gati për kohezion. I mbetet çdokujt të përgatitet për të hyrë në këtë udhë. Mundësi tjetër nuk ka, nëse vërtet na pikon në zemër për mjerimin ku kemi hedhur veten me verbanëri të panevojshme dhe krejt të dëmshme.



MA'KIL IBN JESAR

RADIJALLAHU ANHU

— Mustafa Erish —

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), ishte një sahab që u ndërrua me Islam para Marrëveshjes së Hudejbijes. Ai ishte një njeri fatlum, i cili gjendej në Besëlidhjen e Ridvanit, për pjesëmarrësit e së cilës ka zbritur një ajet që përgëzon me kënaqësinë e Allahut. Po ashtu, i Dërguari i Allahut (a.s.), i besoi atij detyrën e gjykatësit në fisin e vet.

Ai ishte pjesëtar i fisit Muzejne që jetonte në shkretëtirë në një oaz në Luginën Kurra. Mendohet se ai është thirrur edhe me emrat Ebu Abdullah, Ebu Jesar dhe Ebu Ali. Por më shumë njihet me emrin Ebu Ali. Ndërsa në Rijadu's-Salihin përmendet me emrin Ebu Ja'la.

Siç thamë më lart, ai e ka pranuar Islamin para Marrëveshjes së Hudejbijes dhe ishte një prej sahabëve që ka marrë pjesë në Besëlidhjen e Ridvanit. Lidhur me sahabët që kanë marrë pjesë në këtë besëlidhje, ka zbritur një ajet që i përgëzon ata me kënaqësinë e Allahut:

“Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t'u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte se ç'kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha

atyre qetësi dhe i shpërbleu me një fitore të afërt.”
(Fet'h, 18)

Besëlidhja që përmendet në ajet, është pikërisht “Besëlidhja e Ridvanit”, që u bë nën pemën “Semre” në Hudejbije, në të cilën 1400 sahabë dhanë besën e tyre se do të luftonin kundër idhujtarëve deri në vdekje. Një prej atyre fatlumëve ishte edhe Ma'kil ibn Jesar.

Ai ishte shumë i respektuar në fisin e tij Muzejne. Fjalët dhe bisedat e tij dëgjoheshin, ndërsa këshillat dhe propozimet e tij zinin vend. I Dërguari i Allahut (a.s.), e kishte ngarkuar atë me detyrën e gjykatësit për të zgjidhur disa mosmarrëveshje në fisin e vet.

Ma'kil ibn Jesar, u bë shkak i zbritjes së ajetit fisnik në lidhje me çështjen e rimartës me burrat e tyre, të grave që u mbaron koha e pritjes (pas ndarjes). Kjo ndodhi, në Kutub-i Sitte, tregohet si një çështje e detajuar e Ma'kil ibn Jesarit (r.a.):

“Unë kisha një motër, dorën e së cilës e kërkonin shumë vetë. Mirëpo unë nuk i jepja asnjërit përgjigje pozitive. Por kur erdhi e kërkoj një i afërm i imi,

unë e martova me të. Ata jetuan njëfarë kohe së bashku, aq sa dëshiroi Allahu. Më pas, ai e shkurorezoi motrën time me “talak-i rixh'i”¹ Mirëpo, ai e la atë përfundimisht. Kur mbaroi koha e pritjes së saj, erdhën njerëz për t'i kërkuar dorën. Por ai erdhi dhe deshi ta merrte përsëri për grua. Ndërsa unë i thashë:

«Më parë kanë ardhur shumë njerëz për ta kërkuar, por nuk ia dhashë askujt dhe prej të gjithëve të zgjodha ty e të martova me të. Kurse ti e shkurorezove me “talak-i rixh'i”. Pastaj, e le atë edhe pse kishe të drejtë ta merrje përsëri, derisa iu mbush afati. Kur filluan ta kërkojnë të tjerët, erdhe edhe ti për ta kërkuar. Betohem në Allahun se nuk do të ta japë më kurrë atë!»

Ma'kili thotë: Lidhur me këtë ndodhi, ka zbritur ky ajet për mua: **“Kur t'i lini gratë të lira dhe ato të kenë plotësuar kohën e pritjes, mos i pengoni ato që të martohen përsëri me burrat e tyre, nëse merren vesh me të mirë!..”** (Bekare, 232) Për këtë arsye, unë bëra shpagimin e betimit tim dhe e martova përsëri motrën time me ish-burrin e saj. (Buhari, Tefsir, Bekara: 2, 40, Talak: 44; Ebu Daud, Nikah: 21, (2087); Tirmidhi, Tefsir, Bekara: 2, (298).)

Ndërsa në një transmetim tjetër, thuhet: “I Dërguari i Allahut (a.s.), e thirri Ma'kilin dhe ia lexoi ajetin e zbritur. Për këtë arsye, ai hoqi dorë nga vendimi i tij dhe iu nënshtrua urdhrat të Allahut.” (Buhari, Talak: 44; Ibrahim Canan, Kutub-i Sitte Tercüme ve Serhi: 3/322.)

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), ka transmetuar edhe hadithe, prej të cilave 34 janë në Kutub-i Sitte, 27 janë në Musned (V, 25-27.), ndërsa rreth 100 janë në përmbledhjen Taberanit. Ja disa prej këtyre haditheve:

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Kush arrin mëngjesin dhe thotë tri herë “Eudhu billahi's-semi'il-alim meni'sh-shejtani'r-raxhim” dhe lexon tre ajetet e fundit të sures Hashr, Allahu cakton shtatëdhjetë mijë meleke si kujdestarë për të. Ata kërkojnë mëshirë për të deri në mbrëmje. Nëse ai do të vdesë atë ditë, vdes si dëshmor. Nëse lexon të njëjtat në mbrëmje, kësaj here ndodh e njëjta gjë deri në mëngjes.” (Tirmidhi, Fedailu'l-Kur'an 22, 2923)

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: “Lexojuni suren Jasin të

1. - Talak-i Rixh'i: Kur burri i thotë gruas “je e ndarë”, por gruas i duhet të presë një kohë prej 100 ditësh para se të lëshojë shtëpinë e burrit përfundimisht. Mirëpo, nëse burri vendos ta marrë përsëri para se të mbarojë ky afat, ajo mund të vazhdojë martesën normalisht, nëse jo, atëherë ajo quhet e ndarë përfundimisht.



vdekurve tuaj (atyre që janë duke vdekur)” (Ebu Daud, Xhenaiz 24, 3121.); Ibn Maxhe, Xhenaiz 4, 1448.)

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), tregon: “Një person erdhi tek i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe e pyeti: «Kam gjetur një grua fisnike dhe të bukur (me qëllim martese). Mirëpo, është shterpë, nuk lind fëmijë. A të martohem me të?» I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: «Jo, mos u marto!» Më vonë, ky person erdhi përsëri (me të njëjtën pyetje) dhe mori të njëjtën përgjigje. Kur erdhi për herë të tretë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha: «(O njerëz!) Martohuni me atë që është “vedud / dashuron shumë” dhe “velud / lind shumë”, sepse (në Ditën e Kiametit), unë do të krenohem me numrin e madh të umetit tim para umeteve të tjerë.»” (Ebu Daud, Nikah 4, 2050); Nesai, Nikah 11.)

Pas shkuarjes së Profetit tonë (a.s.), në botën e përjetshme, Ma'kil ibn Jesar (r.a.), nuk qëndroi në Medinë, por shkoi në qytetin e Basrës, i cili sapo ishte formuar dhe u bë nga të parët që u vendos aty. Më pas, Omeri (r.a.), e ngarkoi atë me detyrën e hapjes së një kanali ujitës në Basra. Ai e hapi atë kanal në afërsi të Basrës dhe ai kanal u bë i njohur me emrin “Nehr-i Ma'kil / Lumi i Ma'kilit”.²

Më vonë, në kohën e Emevitëve, ai u ngarkua edhe me hapjen e kanalit në Ubul-le nga ana e Valiut të Horasanit dhe Basras, Ubejdullah ibn Zijad. Në

2. - Istiaib, III, 1432-1433.



atë kohë ai ishte një prej sahabëve të pakët që ishin ende gjallë.³ Ubejdullah ibn Zijad, i caktoi familjes së Ma'kilit (r.a.), disa toka në Basra, në të cilën rritet një lloj hurme që njihet me emrin "Ma'kili".

Në periudhën e kalifatit të Aliut (r.a.), Ma'kil ibn Jesar (r.a.), mori pjesë në çlirimin e Iranit. Po ashtu, ai mori pjesë edhe në çlirimin e dytë të qytetit Istakhr nën komandën e Abdullah ibn Amir ibn Kurejdhit në periudhën kur në Basra ishte vali Abdullah ibn Abbasi (r.a.). Në këtë luftë, ai u caktua si komandanti i njërit prej krahëve të ushtrisë.⁴

Gjatë sëmundjes, e cila përfundoi me vdekjen e Ma'kil ibn Jesarit (r.a.), atë e vizitoi vetë Valiu i asaj kohe, Ubejdullah ibn Zijad, me ç'rast Ma'kili (r.a.), i transmetoi valiut një hadith, të cilin nuk ia kishte thënë askujt deri atë ditë. Ky hadith, gjendet në Rijadu's-Salihin dhe është si më poshtë:

Ebu Ja'la Ma'kil ibn Jesar (r.a.), transmeton se, e kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (a.s.), të thotë:

"Nëse një person, të cilin Allahu i Madhëruar e ka bërë drejtues, vdes duke mashtruar njerëzit që drejton, Ai nuk do t'ia tregojë Xhenetin" (Buhari, Ahkam 8; Muslim, Iman 227-228, Imare 21.)

Ndërsa në një transmetim të Muslimit, thuhet: *"Asnjë prej drejtuesve që merr përsipër punët e myslimanëve dhe nuk punon e përpiket për ta, nuk do të hyjë së bashku me ta në Xhenet."* (Muslim, Iman 229, Imare 22.)

Në shpjegimin e këtij hadithi fisnik, zënë vend këto shprehje: "Koha që Ma'kil ibn Jesar (r.a.), zgjodhi për të transmetuar këtë hadith, ka një rëndësi të veçantë. Ndërkohë që ky sahab i nderuar i Profetit tonë (a.s.), dergjej në shtratin e vdekjes në Basra, Valiu Emevit i Horasanit dhe Basrës, Ubejdullah ibn Zijadi i erdhi për vizitë. Kur Ma'kili (r.a.), pa pranë tij përgjegjësin kryesor të masakrës së Kerbelasë, tha:

- Do të të transmetoj një hadith që kam dëgjuar prej të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe i tregoi atij hadithin që nuk ia kishte thënë askujt tjetër për vite me radhë.

Ubejdullah ibn Zijad tha: "A nuk duhej të ma thoshe më parë këtë?"

- Jo! Më parë nuk mund të ta thosha"- tha Ma'kili (r.a.).

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), ka transmetuar edhe këtë hadith në lidhje me kohët e fitneve. I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Kur situata është në kaos, adhurimi është si hixhret për mua!"* (Muslim, Fiten 130. Tirmidhi, Fiten 31; Ibni Maxhe, Fiten 14.)

Fjalës origjinale "herxh" të përdorur në hadith, i janë dhënë kuptimet, kaos, kohë fitnesh, situatë lufte ndërmjet myslimanëve, ngatërrimi i gjendjes së punëve, lajme të pavërteta që përhapin trazira në shoqëri, etj. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), është pyetur se çfarë është "herxh-i", ai ka thënë: *"Herxhi është vrasës!"* (Buhari, Edeb 39; Muslim, Ilim 11.)

Qëllimi i fjalës "vrasës", aludon në faktin se në kohë fitnesh / trazirash, myslimanët luftojnë dhe vrasin njëri-tjetrin. Dhe në shumë hadithe është lajmëruar se kjo do të ndodhë më shumë në kohët afër Kiametit. Shkaku që adhurimi është shumë i çmuar dhe i veçantë në kohë fitnesh dhe kaosi, është se në kohë të tilla, njerëzit përzihen në kaos dhe fitne dhe nuk i kryejnë ashtu siç duhet detyrat e tyre ndaj Allahut të Madhëruar. Ndërsa ata që nuk marrin pjesë në trazira, por tërhiqen mënjane dhe merren me adhurime, do të kenë shpërblime të mëdha nga Allahu. Ky qëndrim, ka një rëndësi të madhe në aspektin e përmirësimit të shoqërisë dhe të ofrimit të një shembulli të mendjes së shëndoshë, e cila duhet të pasohet.

Nga Ma'kil ibn Jesar (r.a.), transmetohet edhe një thënie e tillë: "Nuk ka asnjë ditë që lind e të mos thotë: «O biri i njeriut! Unë jam një ditë e krijuar sot dhe do të dëshmoj për punët e tua. Prandaj, ndërkohë që jeton tek unë bëj punë të mira, që të dëshmoj me to në favorin tënd. Nëse sot iki, nuk do më gjesh më kurrë. Edhe nata i thotë njeriut të njëjtat fjalë." (Ebu Nuajm, Hilje, V 2, 303.)

Ma'kil ibn Jesar (r.a.), ndërroi jetë rreth vitit 680 (60 hixhri) në Basra. (Isabe, VI, 146-147.)

Allahu qoftë i kënaqur me të!.. Amin!..

3. - Jakut, V, 324.

4. - Belazuri, fq. 566.

DUAJA

Duaja/lutja, është thelbi i devotshmërisë dhe i jetës së adhurimit. Në fakt, një nga gjërat që pëlqen më shumë Allahu i Madhëruar, është që rob i t'i ngrejë duart drejt Tij duke qenë i vetëdijshëm për gjendjen e vet të dobët dhe t'i lutet e t'i përgjërohet Atij. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar e dënon atë njeri që nuk i afrohet duasë dhe nuk kërkon asgjë prej Tij. Lidhur me këtë, në një ajet fisnik urdhërohet:

“Thuaj: «Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...»”
(Furkan, 77)

Duaja është çelësi i dyerve të mëshirës, arma e besimtarit, shtylla e fesë dhe drita e tokës dhe e qiejve. Kujt i janë hapur dyert e duasë, do të thotë se atij i janë hapur dyert e mirësisë, urtësisë dhe mëshirës. Kush dëshiron që duaja e tij të pranohet në kohë të vështira, duhet të bëjë shumë dua në kohët kur është rehat dhe ka bollëk. Shpirtra të mëdhenj, janë ata që e bëjnë jetën e tyre gjithmonë të bazuar mbi duanë.

PREJ DUAVE TË RESULULLAHUT (A.S.):

Nëna jonë Ummu Seleme (r.anha.), është pyetur:

“O nëna e besimtarëve! Cilën dua ka bërë më shumë i Dërguari i Allahut kur ka qenë pranë jush?”
Ajo u përgjigj:

“Shpeshherë, lutej duke thënë: «O Zoti im që i kthen zemrat nga një gjendjen në tjetrën! Bëje zemrën time të qëndrueshme në fenë Tëndë!»”

Njëherë, kur i Dërguari i Allahut (a.s.), po bente haxhin dhe gjendej në “vakfe”, me njërën dorë mbante frerët e devesë, ndërsa dorën tjetër e ngriti dhe bëri një dua të gjatë ku shprehte devotshmërinë dhe ndjeshmërinë e jetës së zemrës së tij. Një pjesë e kësaj duaje është kështu:

“O Zot! Qofsh i falënderuar ashtu siç urdhëron Ti dhe më tepër se sa mund të themi ne! O Allah! Namazi, adhurimi, jeta dhe vdekja ime janë vetëm për Ty! Kthimi im është vetëm tek Ti!

O Allah! Strehohem tek Ti prej dënimit të varrit, prej vesveseve që tundojnë zemrën dhe prej hallakatjes së punëve!

O Allah! Më jep dritë në syrin tim, në veshin tim dhe në zemrën time! O Allah! Zgjeroma gjoksin dhe ma lehtëso punën! O Allah! Strehohem tek Ti prej kthimit të shëndetit në sëmundje, prej dënimit që vjen papritur dhe prej zemërimit Tënd! O Allah! Më udhëzo në rrugë të drejtë dhe më fal të shkuarën dhe të ardhmen time!

O Zoti im që ngre gradat, që pakëson begatitë, që ke krijuar qiejt dhe tokën! Zërat gufojnë në lloj-lloj gjuhësh dhe ngrihen drejt Teje, duke kërkuar prej Teje! Dhe ajo që dua unë, është që Ti të më kujtosh në këtë botë sprovash ku banorët e saj më kanë harruar!

O Allah! Ti e dëgjoni fjalën time, e sheh vendin ku ndodhem dhe di gjithçka të fshehtë e të hapur që kam! Asnjë prej punëve të mia nuk është e fshehtë ndaj Teje! Unë jam pa rrugëzgjdhje dhe i varfër. Prej teje kërkoj ndihmë dhe siguri! Kam frikë dhe i pranoj të metat e mia! Ashtu siç kërkon një njeri pa rrugëzgjdhje ashtu kërkoj edhe unë prej Teje! Ashtu siç të përgjërohet një gjynahqar i mjerë, ashtu të përgjërohem edhe unë! Ashtu si një rob që lutet kokulur para Teje, që i rrjedhin lot nga sytë për Ty, që sakrifikon gjithçka në rrugën Tënde dhe që e vendos fytyrën e vet në tokë për Ty, ashtu të lutem edhe unë Ty!

O Zoti im! Mos më privo nga pranimi i lutjes sime! Ji i butë dhe i mëshirshëm me mua o Ti më i miri prej atyre që u kërkohet diçka dhe më bujari i atyre që japin!” (Ibn Kethir, el-Bidaje, V, 166-168.)

Ebu Umame (r.a.), thotë:

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka bërë shumë dua. Mirëpo, ne nuk arritëm të mësonim ndonjë gjë përmendësh prej tij. Për këtë arsye, i thamë:

“O Resulullah! Keni bërë shumë dua, por nuk arritëm t’i mësonim përmendësh.” Atëherë, i Dërguari i Allahut (a.s.), tha:

“A t’ju mësoj një dua që i përmbledh në vete të gjitha ato dua? Thoni kështu:

«O Allah! Edhe ne dëshirojmë të gjitha mirësitë që ka kërkuar Profeti Muhammed (a.s.) prej Teje. Edhe ne strehohemi tek Ti prej atyre të këqijave që është strehuar Profeti Muhammed (a.s.). Ndihma pritet vetëm prej Teje. Ti je Ai që do t’ia plotësosh dëshirat robit në dynja dhe në ahiret. Forca për t’u larguar prej gjynahut dhe fuqia për të kryer adhurime fitohet vetëm me ndihmën e Allahut.»” (Tirmidhi, Deauat, 88/3521.)

Enesi (r.a.), tregon:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), vizitoi një të sëmure, i cili ishte dobësuar jashtë mase dhe e pyeti: «A i je lutur Allahut për ndonjë gjë ose a i ke kërkuar Atij diçka?» I sëmuri tha, po unë i lutem Allahut kështu: «O Allah! Dënimin që do të ma japësh në botën tjetër, ma jep në këtë botë!» Kur dëgjoi këtë, i Dërguari i Allahut tha:

«Subhanallah! Ti nuk mund ta përballosh këtë. A nuk do të ishte më mirë të luteshe kështu: “...**Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë, na jep të mira në botën tjetër dhe na ruaj nga dënimin i Zjarrit (të Xhehenemit)**” (Bekare, 201)»

Pas kësaj, njeriu u lut në këtë mënyrë dhe u

shërua. (Muslim, Dhikr, 23; Tirmidhi, Deauat, 71/3487.)

PREJ DUAVE TË SAHABËVE:

Një sahab i quajtur Ebu Mi’lak, merrej me tregti duke bërë ortakëri me të tjerët. Ai ishte njeri i drejtë dhe i devotshëm. Njëherë, kur kishte dalë për udhë, i preu rrugën një hajdut i armatosur, i cili i thotë:

“Nxirr çfarë ke, sepse do të të vras!” Ebu Mi’lak tha:

“Nëse qëllimi yt është malli, merre!” Hajduti tha:

“Unë dua vetëm jetën tënde!” Ebu Mi’lak tha:

“Atëherë më lejo të fal një namaz.” Hajduti tha:

“Fal sa të duash!” Ebu Mi’lak (r.a.), pasi fali namazin bëri këtë dua:

“O i dashuri i zemrave! O Sunduesi i Arshit të Lartmadhëruar! O Zoti im që bën çfarë dëshiron! Për hir të Fisnikërisë Tënde të pashoqe, të Sundimit Tënd të paarritshëm dhe të nurit që mbulon Arshin Tënd, kërkoj të më mbrosh prej së keqes së këtij (hajduti)! O Zoti im më ndihmo!”

Ebu Mi’lak e përsëriti tre herë këtë dua. Dhe, sapo e mbaroi duanë, u shfaq një kalorës që e mbante heshtën në lartësinë e veshit dhe e vrau hajdutin. Më pas, ky sahab i cili shpëtoi me mirësinë e Allahut, e pyeti kalorësin: “Kush je ti? Allahu më shpëtoi në sajën tënd!”

Kalorësi u përgjigj:

“Unë jam prej banorëve të katit të katërt të qiellit. Kur bëre duanë për herë të parë, dëgjova kërcitjen e dyerve të qiellit. Kur bëre duanë për herë të dytë, dëgjova zhurmat e banorëve të qiellit. Kur e bëre për herë të tretë, u tha: «Po lutet dikush që është në vështirësi!». Sapo dëgjova këtë, i kërkova Allahut të më ngarkonte me detyrën e vrasjes së këtij hajduti. Allahu ma pranoi dëshirën dhe unë erdha. Dije se, kush merr abdest, fal katër rekate namaz dhe bën këtë dua, ajo do të pranohet, qoftë ose jo në vështirësi.” (Ibn Haxher, el-Isabe, IV, 182.)

PREJ DUAVE TË TË PARËVE TANË TË MIRË:

Një pjesë prej duave që kanë bërë të parët tanë të mirë në Arafat janë edhe këto:

“O Zot! Kush mund ta lavdërojë veten përpara Teje? O Zot! Gjuha më është mekur prej gjynaheve dhe unë nuk kam as një vepër të vlefshme që ta paraqes Ty, e asnjë ndërmjetës tjetër përveçse të shpresoj për mëshirën Tënde! O Zot! E di se për shkak të të metave të mia, nuk kam as pozitë tek Ti, e as fytyrë të të kërkoj falje! Mirëpo Ti je më Bujari i bujarëve! O Zot! Edhe nëse nuk e meritoj mëshirën Tënde, ajo mund të më arrijë mua! Sepse mëshira Jote është aq e gjerë sa kaplon gjithçka! O Zot! Sado i madh të

jetë gabimi im, ai mbetet i vogël pranë faljes Tënde!
Falmi ato o Zoti im Bujar!

O Zoti im! Nëse Ti do të falësh vetëm robërit e Tu të bindur, ku të shkojnë e të strehohen gjynahqarët? Zoti im! Nëse Ti do të mëshirosh vetëm robërit e Tu të devotshëm, prej kujt të kërkojnë ndihmë gjynahqarët?

Unë kam nevojë çdo çast për Ty! Ndërsa Ti nuk ke aspak nevojë për mua! Si Krijuesi im, vetëm Ti mund të më falësh! Më lër të kthehem prej këtij vendi me nevojat e mia të plotësuara, kërkesat e mia të pranuar dhe dëshirat e mia të realizuara!

O Allahu im që posedon nevojat e atyre që kërkojnë! O Allahu im që di se çfarë mendojnë ata që heshtin! O Allahu im që përveç Teje nuk ka zot tjetër prej të cilit pritet ndihmë! O Allahu im që përveç Teje nuk ka krijues tjetër prej të cilit duhet të kemi frikë! O Allahu im që nuk ke roje dere si vezirët, të cilëve mund t'u jepet ryshfet për të hyrë tek ta! O Allahu im, që të shtohet bujaria dhe zemërgjerësia kur shtohen kërkesat dhe të shtohet fisnikëria dhe mirësia kur shtohen nevojat! O Allahu im! Ti e mirëpret çdo mysafir! Dhe ne jemi mysafirët e Tu. Prandaj na mirëprit në xhenetet e Tua!

O Allahu im që dhuron dhe gostit çdo vizitor! I jep shpërblime çdokujt që shpreson shpërblim! Ne kemi ardhur në grup në Shtëpinë Tënde! Qëndruam në vendet e rëndësishme për Ty! U gjendëm në ato vende të begata! Shpresa jonë është të arrijmë shpërblim prej Madhërisë Tënde! Pranoji lutjet tona, o Allah!" (Bejhaki, Shuabu'l-Iman, II, 25, 26.)

HISTORI

Duaja e Sulltan Muradit

Kur Sulltani Hydavendigar Muradi i I. hyri në luginën e Kosovës më 8 Gusht të 1389, u përball me një furtunë të madhe. Situata u rëndua aq shumë sa sytë nuk shihnin njëri-tjetrin. Atë natë, ishte Nata e Beraetit. Pasi fali dy rekat namaz, Sulltan Muradi u lut kështu duke qarë:

"O Zot! Nëse kjo furtunë ka filluar për shkak të gjynaheve të robit Tënd të dobët, Muradit, mos i dëno ushtarët për shkak të tij!.. O Allah! Ata kanë ardhur deri këtu vetëm për të ngritur lart emrin Tënd dhe për të kumtuar Islamin!

O Zot! Ti më ke dhënë shumë fitore. Gjithmonë m'i ke pranuar duatë. Tani po strehohem sërish tek Ti, prandaj pranoma lutjen! Na sill një shi që ta largojë këtë tym, t'i shohim qartë ushtarët e mohuesve dhe të përballemi me ta!

O Zot! Edhe sundimi, edhe ky rob janë të Tutë! Unë jam një rob i dobët. Ti je Ai që i njeh më mirë qëllimet dhe të fshehtat e mia. Qëllimi im nuk është malli dhe prona, por vetëm kënaqësia Jote!

O Zot! Mos i mposht dhe mos i shkatërro këta ushtarë besimtarë me dorën e mohuesve! Jepu atyre një fitore të tillë, që të gjithë myslimanët të festojnë! Nëse dëshiron, kurhani i asaj dite feste le të jetë rob i Yt Muradi!

O Zot! Mos më bëj shkak të shkatërrimit të gjithë këtyre ushtarëve myslimanë! Ndihmoji dhe jepu fitore atyre! Unë e sakrifikoj edhe jetën time për ta... mjafton të më pranosh mes shehidëve!.. Jam i gatshëm ta dorëzoj shpirtin tim për ushtarët e Islamit... Ti më bërë gazi. Tani më fal edhe gradën e shehidit! Amin!.."

Pas kësaj lutje shumë të sinqertë, sulltani filloi të lexonte Kuranin Fisnik me një qetësi të jashtëzakonshme. Pa kaluar shumë, të gjitha këto u realizuan. Mbi fushën e Kosovës ra një shi me rrebeshe, era pushoi dhe pluhuri u largua... Pas kësaj filloi sulmi ndaj armikut. Beteja përfundoi me fitoren e myslimanëve pas tetë orë luftimeve. Ndërkohë që Sulltan Muradi po kalonte mes të plagosurve dhe shehidëve në fushën e luftës, një ushtar serb, i cili u ngrit midis kufomave tha:

"Më lini! Dua t'i puth dorën sulltanit dhe do të bëhem mysliman!"

Ky ushtar serb që hiqej si i plagosur, bëri sikur po i puthte dorën sulltanit. Por menjëherë nxori thikën që kishte fshehur nën sqetull dhe ia nguli sulltanit drejt e në gjoks. Në këtë mënyrë, duaja e Sulltan Muradit u realizua plotësisht... (Osman Nuri Topbash, Qytetërimi i Virtyteve, I.)

URTËSI

- Gjatë duasë, gjuha duhet të jetë përkthyesë e zemrës, ndërsa orientimi duhet të jetë mbështetëse e duasë. (Osman Nuri Topbash)

- Duaja është një klithmë shprese. (Alfred De Musset)

- Duaja manifestohet në dy mënyra: Ose e largon atë që na frikëson, ose na jep forcë dhe guxim që ta mposhtim atë. (H. E. Posdic)

- Duaja dhe adhurimi, do të thotë të jesh bashkë me Allahun. Për atë që është bashkë me Allahun, edhe vdekja, edhe jeta janë njësoj të bukura. (Mevlana)

- Ata që arrijnë të shijojnë ëmbëlsinë e duasë dhe dashurisë hyjnore, e dinë se sa gjendje e lartë është ëmbëlsia e qëndrimit vetëm për vetëm me Allahun duke iu lutur Atij. (Muslim B. Jesar)

- Duaja bëhet para se të vijë fatkeqësia. Pas ardhjes së fatkeqësisë, nuk ka rrugëzgjidhje tjetër përveçse ta pranosh dhe të durosh. (Ebu Muhammed Xheriri)

Amatorë në fe...

— Hasan Tahsin Karaman —



Në përgjithësi, njerëzit synojnë të jenë profesionistë. Në cilëndo fushë goftë, synimi është ndërtimi i një personaliteti të pajisur me aftësitë dhe dijen më të përsosur. Ndonjëherë, specializimi në një fushë, i merr vite njeriut, e madje ai e shpenzon të gjithë jetën e tij në këtë drejtim.

Shoqëritë njerëzore i ndërtojnë qytetërimet e tyre mbi supet e njerëzve cilësorë që kanë edukuar. Njeriu e jep rezultatin e përpjekjeve të edukimit në fund të dhjetëra viteve pune të lodhshme. Ndonjëherë, ky proces zgjat edhe më shumë. Investimi në një fryt që do të formohet vite e vite më vonë, në përgjithësi i turbullon synimet e mendësive që bëjnë llogari të cekëta. Njeriu, i cili për nga natyra e krijimit është “i nxituar”, dëshiron gjithmonë qëllimet e afërta.

Në këtë mënyrë, edhe “fetaria”, e thënë ndryshe, “zbatimi praktik i besimit”, nuk mund ta shpëtojë veten nga cilësia e “nxitimit”, sepse zbatuesi i saj është njeriu.

Allahu është një genie që nuk përkufizohet me hapësirë. Për këtë arsye, është e pamundur t’i afroresh apo t’i largohesh atij goftë edhe një hap. Entuziazmi i të rinjve të cilët dëshirojnë që gjithçka të bëhet e të mbarojë menjëherë, përplasit dhe copëtohet në procesin e durimit që zgjat një jetë të tërë. Krijuesi nuk dëshiron prej njeriut shkëlqime të përnjëhershme dhe akumulime të çrregullta të ngjeshura në një kohë shumë të shkurtër, por një “pjekuri shpirtërore” të purifikuar në enën e durimit.

Rruga në të cilën do të ecet dhe distanca që do të përshkohet fillon me dëshminë islame dhe mbaron në frymën e fundit, duke qenë i kënaqur prej Allahut dhe Ai i kënaqur prej teje. Në këtë rrugë, e cila është e rrethuar me mijëra banditë, as nuk mund të ndalesh, e as nuk mund të kthehesh pas. Rruga e fesë është një “proces durimi”, në të cilën përparohet pa ndaluar, pa prituri dhe në bazë të fuqisë së njeriut...

“Profesionalizmi” shihet si synim dhe është i lavdëruar në çdo çështje. Por kur bëhet fjalë për çështjen e fesë, profesionalizmi kërkon një trajtim të veçantë. Momenti kur vendosni t’i jepni formë jetës suaj në bazë të besimit, është shumë i rëndësishëm. Që prej atij momenti, në çdo drejtim dhe në çdo çështje do të shihni prej dritares së besimit tuaj. Dijet që sapo keni mësuar, zënë vend në zemrën tuaj, të cilën nuk e mban vendi prej entuziazmit, si argumente që nuk mund të refuzohen. Gjendja që keni arritur, bën që në kujtesën tuaj të ringjallen me keqardhje të thellë ato që keni përjetuar në të shkuarën. Në zemrën tuaj, në fillim shfaqet një ndjenjë keqardhjeje për ata që ju kalojnë pranë të zhytur në indiferencë, e më pas zemrën e kaplon një zemërim i lehtë...

Ju nuk i diskutoni të vërtetat që keni gjetur dhe askush nuk mund t’ju pengojë prej përjetimit të atyre që keni mësuar. Namazet e natës për të cilat zgjohesh me emocione, bisedat fetare të cilat mezi i pret,

mbledhjet mes miqsh, ngurrimet që shfaqen nga frika se mos bën ndonjë gabim dhe vesveset që të vijnë duke të pëshpëritur “a e kam bërë mirë vallë?”, janë vetëm disa prej veprimeve që fillojnë të bëhen të zakonshme...

Besimi juaj kaplon jetën si një re dhe ju lëshon shiun e mëshirës dhe begatisë së fillimit. Mirëpo, sprovat e vështira të jetës së përjetshme sapo kanë filluar. Në fillim, mungesa e mirëkuptimit dhe shurdhëria e pakuptimtë juaj zbeh shpresat. Gjatë ditës hasni në njerëz që shpikni lloj-lloj arsyesimesh të paqena për t’ju penguar nga adhurimet. Ka prej tyre që fillojnë të të japin mend, duke thënë, “je ende i ri, është ende herët për ty”, ose nga ata që bëjnë sikur dinë gjithçka, e të thonë, “e rëndësishme është pastërtia e zemrës”.

Një pengesë tjetër, shfaqet para jush si armiqësi pa emër e pa shkak, mungesë mirëkuptimi dhe respekti... Ngarkesa që bartnit në fillim të udhës ishte e lehtë, por me zgjatjen e udhës ajo fillon e rëndohet. Mbi të gjitha, në horizont nuk duket asgjë në emër të një rezultati.

Zakonet e vjetra dhe shokët e qejfit që presin me padurim që të kthehesh përsëri midis tyre, ju shkelin syrin përçark duke u përpjekur t’ju joshin. Koha zgjatet, pesha bëhet më e rëndë dhe pengesat tërheqin njëra-tjetrën.

Pikërisht në këtë pikë, para jush dalin dy rrugë. E para, është t’i drejtoheni “profesionalizmit të fesë”, të cilën e filluat me një entuziazëm prej amatori. Ky proces fillon duke u mjaftuar me pak, duke mos e tepruar dhe duke hequr dorë prej disa gjërave. Ndërkohë që dje punonit me vullnet të fortë, sot keni filluar të hetoni edhe autoritetin e një burimi.

Sunetet e namazit të ikindisë, fillojnë të mos falen më për shkak se janë në statusin “gajri mukeked”. Tashmë keni filluar të ktheheni në një “besimtar më të hapur dhe më të relaksuar”. Festat fetare dhe Ramazanët ju japin mundësinë t’ju ktheheni përsëri kohës kur ishit më të angazhuar me jetën fetare. Mirëpo, këto janë çaste që vijnë e shkojnë si flakë kashte. Gjithçka që po përjetohet është një lloj gjendjeje ku brenda vetes është pranuar shekullarizmi me justifikimin e “mos harresës së pjesës që ke në këtë botë”, edhe pse laicizmin nuk e sheh me sy të mirë në aspektin e drejtimit të shtetit dhe të ligjeve. Por, nëse e analizojmë me kujdes Historinë e Profetëve, do të vërejmë se asnjë i Dërguari i Allahut nuk ka nxjerrë justifikime dhe nuk ka ndjekur rrugë të ndryshme në bazë të logjikës së vet. Po ashtu, shohim se si Junusi

(a.s.), i cili braktisi vendin e detyrës, Musai (a.s.), i cili u përçez në një grindje në periferi të Egjiptit dhe Nuhu (a.s.), i cili u mundua të mbronte djalën e tij mohues për shkak të dhimbjes, në momentin e fundit i janë kthyer pendimit, janë dorëzuar tek Allahu dhe fjalën e Tij e kanë mbajtur gjithmonë në plan të parë.

Ndërsa rruga e dytë, është ajo e Bilalit (r.a.), Hubejbit (r.a.), Ammarit (r.a.), etj., të cilët vazhduan ta jetonin fenë me të njëjtin entuziazëm si në ditën e parë... është një mënyrë jetese si ajo e kalifit Omer (r.a.), i cili për ta kontrolluar veten në çështjen e hipokrizisë, e thirri mënjane Hudhejfe Jemanin (r.a.) dhe i tha: “O Hudhejfe pa shikomë njëherë! Çfarë mendon për ato që bëj unë?”...

Padysim se arritja e një pjekurie e cila ka sukses



duke shtuar e jo duke pakësuar, duke u thelluar e jo duke bërë dinakëri dhe duke u rigjeneruar përditë e jo duke u vjetërsuar, është gjëja më e vështirë. E megjithatë, mermerët, të cilët gdhenden me vështirësi edhe nga mjeshtërit më të mirë, me çekiç e dalta të mprehta, gdhenden në mënyrë të mahnitshme prej pikave të ujit me përpjekjen e tyre shekullore dhe me butësinë e durimit të tyre. Pikërisht kjo është ajo që duhet të bëjmë!.. Të vazhdojmë rrugën tonë pa e prishur pastërtinë tonë të ditës së parë, pa ngecur në shkaqet dhe në përfundimet, pa u degjeneruar dhe pa u tjetërsuar... T’i dorëzohemi Krijuesit të qiejve e të tokës, Rrahmanit, Rrahimit, Vedudit, Gafurit, pa kushte dhe pa llogari, duke ruajtur të njëjtën freski si në momentin e parë dhe me një durim të pafund...

1. - Vepra që Profeti (a.s.), edhe i ka vepruar, edhe nuk i ka vepruar. Bërja e këtyre veprave ka sevap, ndërsa lënia nuk ka pasoja.

Mbretëresha BELKIS

— Halime Demiresnik —

Kur më pyeti vajza: “Mami! Cili është emri që të pëlqen më shumë për vajza?”, unë i thashë: “Belkis.”

Ajo më tha: “Çfarë do të thotë Belkis? Nuk e kam dëgjuar asnjëherë!” Atëherë, unë fillova t’i tregoj mbretëreshën e Sebesë, Belkisën për të cilën flitet në Kuranin Fisnik. Kjo histori që përmendet në Kuran, është dhuratë për Belkisat e kohës së fundit, në mënyrë që ta njohin pushtetin e vërtetë që është harruar me kalimin e kohës për shkak të dashurisë ndaj pasurisë, domethënë “salltanetin e adhurimit”.

Ishte koha e Sulejmanit, (a.s.), nën urdhrin e të cilit ishin erërat, kafshët e buta e të egra, njerëzit xhindet, zogjtë... Ai i përgjerohej Allahut Teala me dije e falënderim nga zemra duke thënë: “Falënderimi qoftë për Allahun që na ka lartësuar mbi shumë prej robërve të Tij besimtarë.”

Salltaneti i tij ishte aq i madh, saqë ushtria e tij u bë legjendë. Ushtria e tij përbëhej prej tri pjesësh. Grupi i parë ishin xhindët, grupi i dytë ishin njerëzit dhe grupi i tretë ishin zogjtë. Sulejmani,

(a.s.), që dinte gjuhën e kafshëve dhe të zogjeve, xhindët i përdorte në punë të fshehta, njerëzit në mbrojtje të vendit, ndërsa zogjtë për të dërguar/marrë lajme, për të gjetur rrugën dhe për të gjetur vendet ku kishte ujë.

Transmetohet se Sulejmani, (a.s.), kishte shkuar në haxh. Kur po kthehej në vendin e tij, kishte bujtur në shkretëtirë bashkë me ushtarët e tij. Ai kishte kërkuar zogun Hud’hud (zogu lajmëtar i tij) për ta urdhëruar që të gjente ujë, por nuk e kishte parë. Menjëherë kishte urdhëruar që të gjehej Hud’hudi i cili ishte larguar pa lejen e tij. Kur Hud’hudi erdhi pas një kohe të shkurtër, i tha:

“O Hud’hud! Nëse nuk ke një arsye të fortë, do të të jap një ndëshkim të rëndë!..”

Hud’hudi i tha:

“Unë të kam sjellë një informacion që ti nuk e dije, edhe pse je një peygamber i ditur dhe i urtë. Vij nga vendi Sebe në Jemen. Populli i atjeshëm, i bindet djallit nën udhëheqjen e mbretëreshës për shkak të shkujdesjes që jep pasuria dhe adhurojnë diellin.” Pastaj shtoi: “Mbi të gjitha, kjo mbretë-



reshë ka një fron madhështor.”

Kundrejt këtyre fjalëve të Hud’hudit, Sulejmani, (a.s.), së pari ndjeu paaftësinë e tij. Edhe pse i ishte dhënë gjithë ky salltanet, dije dhe fuqi, kishte çështje të cilat nuk i dinte. Ja, një zog i vogël, po i tregonte për gjëra që ai aspak nuk i dinte.

Ai hoqi dorë nga ndëshkimi i Hud’hudit, por donte ta vërtetonte realitetin e atyre që tha ai. Pastaj i tha:

“Unë do t’i shkruaj një letër kësaj mbretëreshe që jeton në të njëjtën kohë me mua. Këtë letër lëre te froni i saj, ndiqi ata nga larg dhe më njofto për ato që do të ndodhin!”

Belkisa ishte një arabe marramendëse. Me rrobën e saj të hijshme, të zbukuruar me perla dhe të plotësuar me kurorën prej smeraldi, iu afrua fronit duke përhapur dritë. Mbi fron ndodhej një letër. U habit. Ajo nuk kishte parë njeri që ta linte atë letër aty. Filloi ta lexonte letrën:

“Kjo letër është nga Sulejmani dhe fillon me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit Mëshirëplotit:

O mbretëreshë! Me sa kam dëgjuar, ju e keni lënë rrugën e Allahut, keni ndjekur rrugën e shejtanit dhe adhuron diellin. Besojini Allahut, i Cili është një! Mos më kundërshtoni dhe dorëzohuni duke mu nënshtuar!..”

Mbretëresha Belkis, menjëherë mblodhi anëtarët e këshillit konsultativ që përbëheshin nga 310 vetë dhe u lexoi letrën. Hud’hudi i ndiqte ata me kujdes nga dritarja e sarajit. Mbretëresha e tha ndihmësve të saj:

“Zotërinj të nderuar! Më jepni një mendim në

lidhje me këtë çështje! Ju e dini se unë nuk bëj asgjë pa u konsultuar me ju. Mendimet tuaja janë të vlefshme për mua.”

Së pari e mori fjalën komandanti i mbrojtjes dhe tha:

“Mbretëreshë! Ne jemi të fuqishëm. Ushtria jonë është e aftë për luftë të vështirë. Ne mund të luftojmë, por sidoqoftë, vendimi i fundit i përket mbretëreshës!..”

Kur edhe të tjerët thanë të njëjtat gjëra, mbretëresha Belkis që ishte shumë e mençur dhe e zgjuar, mori fjalën dhe tha:

“Kur sunduesit hyjnë në një vend, e shkatërrojnë atë. Njerëzit i poshtërojnë dhe i kapin robër. Nëse mbreti Sulejman me gjithë atë salltanet dhe fuqi që ka, na mund, do të bëjë të njëjtën gjë. Tani, unë do t’i dërgoj disa dhurata me të dërguarit e mi dhe të shohim se çfarë lajmesh do të na sjellin.”

Hud’hudi fluturoi menjëherë, shkoi te Sulejmani, (a.s.) dhe ia tregoi të gjitha një nga një.

Të dërguarit e Belkisës, pa kaluar shumë kohë, erdhën në Kuds me dhurata të çmueshme. Këto dhurata shumë të vlefshme sipas tyre, ngelën si një enë uji pranë pasurisë të Sulejmanit. Të dërguarit patën mundësinë të shikonin me sytë e tyre Sulejmanin dhe mbretërimin e tij. Kafshët e egra qëndronin urtë si mace te këmbët e Sulejmanit, njëri prej zogjve shkonte dhe i pëshpëriste disa gjëra në vesh. Shkonte ai, vinte një tjetër dhe i sillte lajme. Sulejmani, (a.s.), që pothuajse e kthente erën me dorën e tij, i pyeti të dërguarit:

“A doni të më ndihmoni me pasuri? Ajo që më ka dhënë Allahu, është më e mirë dhe më e shum-

të nga ajo që ju ka dhënë juve. Megjithatë ju po mburreni me dhuratat tuaja...” Pastaj u tha me acarim:

“Shkoni te mbretëresha juaj dhe i thoni: Dijeni mirë se do të vij me një ushtri që kurrë nuk mund ta mposhtni. Ata që nuk i besojnë Allahut, do t’i nxjerrim të poshtëruar prej aty!..”

Të dërguarit u larguan nga saraji të frikësuar. Ata ia treguan mbretëreshës Belkis gjërat që kishin parë dhe kishin dëgjuar. Belkisa njoftoi se dëshironte të vizitonte Sulejmanin, (a.s.), me parinë e sarajit të saj. Vendosi për t’u nisur në mënyrë që të vërtetonte profecinë dhe fenë e tij. Pastaj filloi të përgatitej. Por fronin madhështor që e kishte si sytë e saj, dëshiroi ta siguronte para se të dilte në këtë udhëtim dhe e futi atë te thesari. Pasi e kyçi pas tri dyersh dhe vendosi me dhjetëra roje, u nis e qetë për në Kuds.

Edhe Sulejmani, (a.s.), kishte filluar përgatitjet për ta pritur atë. Ai mendoi që ta sillte në Kuds fronin e saj shumë të vlefshëm para se të arrinte ajo, në mënyrë që të dorëzohej e të nënshtrohej me shikim të parë. U kthye nga vezirët, xhindët dhe njerëzit e ditur e të urtë dhe i pyeti:

“Kush mund të ma sjellë mua fronin e mbretëreshës Belkis nga Jemeni, para se ajo të arrijë këtu?” Kryetari i xhindeve, që ishte nën urdhrin e tij, i tha:

“Unë mund ta sjell atë pa u ngritur ju nga froni juaj.”

Ndërsa veziri Asaf bin Berhija që i ishte dhënë dije dhe urtësi nga Allahu Teala, i tha:

“Unë mund ta sjell atë sa hap e mbyll sytë.” Dhe pa mbaruar fjalën, e solli fronin e Belkisës në audiencën e Sulejmanit, (a.s.).

Përballë kësaj mirësie të madhe hyjnore, Sulejmani tha me një modesti të madhe:

“Kjo është prej mirësisë së Zotit për të më provuar nëse do të falënderoj apo do të shfaq mosmirënjohje. Ai që falënderon, falënderon për veten e tij. Ai që shfaq mosmirënjohje, shfaq për veten e tij... Ai që shfaq mosmirënjohje, le ta dijë mirë se Zoti nuk ka nevojë për të dhe se Ai është shumë bujar.”

Largësia nga ishte sjellë froni, ishte një muaj rrugë në këmbë.

Pastaj u kthye nga vezirët e ndihmësit e tij dhe u tha:

“Këtë fron, kthejeni në një formë që të mos njihet në çast. Pastaj të shohim nëse do ta njohë apo jo mbretëresha fronin e saj.”

Kur mbretëresha Belkis, pas një udhëtimi të gjatë, iu afrua sarajit të Sulejmanit, (a.s.), pothuajse u magjeps nga madhështia e tij. Kur Sulejmani, (a.s.), e ftoi në sarajin e tij, ajo ndaloi pak. Në vendin ku do të hidhte hapin rridhte ujë dhe peshqit ngjyra-ngjyra dalloheshin qartë nga pastërtia e ujit. Ajo e mblodhi majën e fundit që të mos lagej dhe diamantët në fund të shallvareve prej mëndafshi po i shkëlqenin. Hodhi këmbën dhe u habit

shumë. Këmba e saj nuk humbi në ujë dhe i dukej sikur po ecte mbi të... Ajo e pa e habitur Sulejmanin, (a.s.) dhe ai i tha:

“Mbi ujë ka një bazë transparente të bërë nga qelqi i kristaltë. Mos e mblidh fundin sepse nuk ka nevojë!..”

Mbretëresha Belkis hyri në sarajin prej kristali dhe ndër-sa po shikonte me admirim këtë salltanet, i ra në sy një fron. Edhe Sulejmani, (a.s.), dëshironte që ajo ta shikonte fronin. Kështu që e pyeti:

“A i ngjan ky fronit tënd?”

Belkisa e kishte bërë fronin e saj në mënyrë të veçantë dhe para se të nisej, kishte marrë të gjitha masat për mbrojtjen e tij. Përsëri u habit për shkak se i ngjante shumë dhe arriti të thoshte:

“Sikur të ishte ai!..”

Kur Sulejmani, (a.s.), i tha se froni që po shikonte ishte i saj, Belkisa u dorëzua dhe:

“O Zot! Me të vërtetë i paskam bërë padrejtësi vetes. Tashmë, bashkë me Sulejmanin, i jam dorëzuar Allahut i cili është Zoti i botëve.”

Edhe ata që kishte pranë, besuan bashkë me të. Sipas një transmetimi, Belkisa pranoi edhe propozimin e Sulejmanit, (a.s.), për martesë dhe me mendjen dhe zgjuarsinë që kishte, e ktheu pasurinë e kësaj bote në pasuri të Ahiretit.

“Kjo letër është nga Sulejmani dhe fillon me emrin e Allahut të Gjithëmeshirshmit Mëshirëplotit:

O mbretëreshë! Me sa kam dëgjuar, ju e keni lënë rrugën e Allahut, keni ndjekur rrugën e shejtanit dhe adhuroni diellin. Besojini Allahut, i Cili është një! Mos më kundërshtoni dhe dorëzohuni duke mu nënshtroar!..”

ÇDO GJË DËSHMON PËR PROFETIN



— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin famëlartë: “**..dhe Muhamedi nuk ishte babai i asnjërit prej jush, por ishte profet i Allahut dhe ishte mbyllja e profetëve**”. (Ahzab: 40).

Si fillim lusim Allahun që zemrat tona t'i mbushë me fjalën LA ILAHE IL ALLAH. Lusim Zotin që problemet tona t'i zgjidhë me fjalën LA ILAHE IL ALAH. Lusim Allahun (xh.sh) që të na nxjerrë nga gjendja e keqe për hir të fjalës LA ILAHE IL ALLAH.

Emri **ALLAH**, ky emër kaq i bukur dhe kuptimplotë, emër i cili respektohet dhe me të cilin flet mbarë universi, u shoqërua nga vetë Allahu (xh.sh) më një emër gjithashtu të bukur, me emrin e profetit Muhamed (a.s).

Zoti fenë e tij të pastër, Islamin, ia dha në besueshmëri profetit (a.s). Deklaratën LA ILAHE IL ALLAH e shoqëroi me një deklaratë tjetër që është MUHAMEDUN RESULULLAH (Muhamedi është i dërguari i Allahut). Prandaj çdo njeri që ka zgjedhur Allahun për Zot, që nuk ka tjetër përveç Tij dhe Islamin për fe duhet që kur të dëshmojë për fenë e tij, të thotë LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH (Dëshmoj se nuk zot tjetër veç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është i dërguari i Tij). Nëse këto dy deklarata nuk ia bashkangjisim njëra – tjetrës, nuk jemi besimtarë muslimanë.

Është mjaft e rëndësishme ta kuptosh këtë deklaratë, “Muhamed Resulullah”.

Nuk janë të paktë ata që thonë: “Ne besojmë Zotin, por nuk e besojmë fenë. Nuk e besojmë Muhamedin për profet, sepse na mjafton të themi LA ILAHE IL ALLAH”.

Flasim për këtë temë, sepse ishte profeti (a.s), i cili na e mësoi fjalën LA ILAHE IL ALLAH, i cili e mbajti të pastër këtë fjalë, pasi e patën njollosur këtë fjalë njerëzit që ishin para tij.

Prandaj do të flasim për fjalën MUHAMED RESULULLAH, në mënyrë që deklarata jonë të jetë e pastër dhe e plotë, që të mbajmë përgjegjësi të plotë përpara gjithë njerëzimit dhe para Allahut (xh.sh) për fjalët që kemi thënë: “LA ILAHE IL ALLAH, MUHAMEDUN RESULULLAH”.

A ka argument që Muhamedi (a.s) është profet

i Zotit?! Nëse flasim për argumente, ato nuk kanë fund. Për këtë dëshmon i gjithë universi. Mrekullia dhe argument më i fortë që vërteton profetësinë e Muhamedit (a.s) është Kurani famëlartë. Kurani është sa i vjetër aq edhe i ri. Ai është dëshmia më e mirë, që tregon se Muhamedi (a.s) është profet i Allahut (xh.sh).

Nëse pyesim çifutët se ku e kanë mrekullinë e Musait (a.s), **shkopin e tij**, askush prej tyre nuk mund ta sjellë atë. Ai mbaroi bashkë me Musain (a.s).

Po të pyesim të krishterët se ku e kanë **dorën** e Isait (a.s), askush prej tyre nuk mund ta sjellë atë edhe pse e dëshiron një gjë të tillë, sepse ajo mbaroi bashkë me Isain (a.s).

Por po të pyesësh një musliman, se ku qëndron mrekullia e Muhamedit (a.s), ka të drejtë ta shpallë argumentin e profetit (a.s), **Kuranin**, i cili do të vazhdojë të jetë i gjallë deri sa të bëhet Kijameti.

Ky Kuran me ëmbëlsinë e tij, i thith zemrat e besimtarëve madje i zbut edhe zemrat e jobesimtarëve. Ai shëron sëmundjet, hallet dhe problemet e njerëzve. Ky Kuran sfidoi arabët. Arabët në atë kohë nuk kishin ndonjë zgjuarsitë të rrallë, nuk ishin të zhvilluar në ndonjë fushë të shkencës, por në fushën e poezisë ishin të parët ndoshta në rang botëror. Ata me anë të poezisë ndoshta ushqeheshin apo madje edhe martoheshin. Me anë të poezisë mund të ndiznin luftra, që zgjasnin me vite dhe me një poezi mund të zbusnin konfliktet, që kishin zgjatur me vite të tëra.

Pikërisht në këtë fushë i sfidoi Allahu (xh.sh). I sfidoi me Kuranin famëlartë dhe u tha: “**Nëse keni dyshim për këtë Kuran, atëherë sillni një libër tjetër që i ngjan këtij Kurani**”. (Bekare: 23). Ata nuk iu përgjigjën dot sfidës edhe pse ishin oratorët më të fortë.

Pas kësaj Allahu (xh.sh) u tha: “**nëse keni dyshim pr këtë Kuran, sillni vetëm dhjetë sure** (kapituj) **si Kurani**”. *Hud: 13). Arabët nuk mundën ta bëjnë as diçka të tillë.

Atëherë Allahu (xh.sh) iu drejtua përsëri atyre: “**....sillni qoftë edhe një ajet që i ngjan këtij Kurani**”. (Tur: 33-34). Ata nuk mundën ta bëjnë as diçka të tillë. Kjo ishte vërtet mrekullia e profetit (a.s). Ai

nuk ishte as poet as prozator. Madje ai nuk dinte as të shkruante e as të lexonte. Atëherë nga i solli këto fjalë? Arabët mahniteshin para Kuranit, sepse Kurani është fjala e Allahut (xh.sh).

Kurani është dëshmia më e fortë, sepse foli për të ardhmen, kur ajo nuk kishte ardhur akoma.

Allahu (xh.sh) thotë në suren Er-Rrum: **“Elif, lamë, mimë. U mundën romakët. Në tokën më të ulët, por në pak vite ata prapë do të fitojnë dhe besimtarët atë ditë do të kënaqen me fitoren e Allahut (xh.sh)”. (Rrum: 1-4).**

Romakët në atë kohë ishin të krishterë, besonin tek një Zot dhe muslimanëve u erdhi shumë keq që humbën pikërisht romakët. Ndërsa idhujtarëve të Mekës u erdhi shumë mirë që fituan persët, sepse persët ishin idhujtarë. Në këtë kohë një nga idhujtarët i thotë Ebu Bekrit: “A e pe sesi fituan persët”. Ebu Bekri i tha, që në Kuran thuhet se romakët kanë humbur, por do të triumfojnë në pak vite. Atëherë idhujtari i thotë Ebu Bekrit: “Unë vë bast, që romakët nuk do të fitojnë kurrë”. Ebu Bekri (r.a) shkon tek profeti (a.s) dhe i thotë: “O profet i Zotit. Filani pretendon se romakët nuk do të fitojnë, madje ai vendos bast për këtë punë. A të vë edhe unë bast”. Në atë kohë basti ishte i lejuar. Profeti (a.s) i thotë: **“Vëre bastin. Do ta shohësh se Allahu (xh.sh) do ta mbajë premtimin e Tij”¹.**

Pas 7 vitesh romakët fituan ndaj persëve dhe Allahu (xh.sh) e mbajti premtimin e Tij. Fakte të ngjashme me këtë ka sa të duash.

Ky Kuran foli për shkencën edhe pse i zbriste një njeriu, që nuk dinte shkrim e lexim. Kurani fliste për qiellin dhe për tokën. Ku e dinin njerëzit në atë kohë, se detet nuk janë njëloj dhe mes tyre kanë valë që i ndajnë. Kurani famëlartë e preku diçka të tillë para 1400 vitesh dhe vetëm në ditët tona u vërtetua kjo gjë.

Ku e dinin njerëzit e asaj kohe, që malet kanë vetëm çerekun e gjatësisë mbi tokë, kurse pjesën tjetër nën tokë. Erdhi koha dhe u zbulua edhe kjo gjë.

Ku e dinin njerëzit e asaj kohe, se çfarë ndodh me fëmijën në barkun e nënës. Erdhi koha që u vërtetua fjala e Kuranit. Sot ka aparatura që i sheh fëmijët, teksa rriten në barkun e nënës. Këto janë fakte të gjalla të Kuranit, që flasin në gjuhën arabe, shqipe, angleze apo në ndonjë gjuhë tjetër. Kur dijetarët bashkëkohorë dhe të sinqertë dëgjojnë këto fakte, ulin kokën në shenjë respekti për këtë Kuran, sepse ai është libri i Allahut (xh.sh) dhe nuk është dija e Muhamedit (a.s), as dija e arabëve, madje as dija e gjithë njerëzve të asaj kohe.

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: **“Thuaj: Kuranin e zbriti Ai (Allahu), që e di sekretin në**

qiej dhe në tokë”. (Furkan: 6). Prandaj kij guximin të thuash se je musliman. Ti ke mrekullitë dhe faktet bashkëkohore, që nuk mund t'i hedhë poshtë as shkenca, as dijetarët bashkëkohorë dhe askush përveç teje nuk e ka këtë mirësi.

Për profetin (a.s) dëshmuar edhe të krishterët e asaj kohe. Dëgjoni historinë e Selman Farisiut, atij njeriu që më vonë u bë musliman.

Ai kërkonte për fenë e vërtetë dhe nuk i pëlqenin të krishterët e asaj kohe. Shkoi tek shumë priftërinj, derisa arriti tek prifti i fundit dhe qëndroi me të. Në momentet kur prifti po jepte shpirt, i thotë Selmanit: “Nuk ka më fe të vërtetë mbi shpinën e tokës. Nuk ka më besimtarë. Por mesa duket është koha e profetit të fundit, i cili do të dërgohet në gadishullin arabik. Atë do ta dëbojë populli i tij dhe ai do të shkojë në një tokë me hurma (toka e Medines)”.

Selam Farisiu shkon dhe pret në Medine. Ai kishte dëgjuar nga prifti, se ky profet ka tre shenja: 1- **Ai nuk e pranon sadakanë.** Nuk e ha sadakanë. Jo vetëm profeti (a.s) por edhe familja e tij dhe të gjithë ata që kanë lidhje gjaku me të, nuk e hanë sadakanë edhe në ditët tona, që të mos thotë njerëzimi, se ai e bëri këtë gjë vetëm për veten e tij.

2-Ai e pranon dhuratën.

3- Në mes të shpatullave të tij është shenja profetike. Ajo është një copë e vogël mishi e ngritur, në madhësinë e vezës së pëllumbit. Ajo është vula e profetit Muhamed (a.s).

Kur vjen profeti (a.s) bashkë me shokët e tij, Selmani mendon ta provojë Muhamedin (a.s) për të parë nëse është vërtet profeti i Zotit.

Ai mbledh disa hurma dhe shkon dhe i thotë: “O Muhamed. E di që keni ardhur prej larg ti dhe shokët e tu. Kam mbledhur disa hurma për sadaka. Hani se nuk keni shtëpi dhe familje këtu”.

Profeti (a.s) e falenderon dhe pasi merr hurmat u thotë shokve të tij: “Hani, se unë nuk e ha sadakanë”. Selmani tha me vete: **“U provua shenja e parë”.** Profeti (a.s) nuk e dinte se ç'ka në zemër Selman Farisiu.

Pas disa ditësh ai mbledh përsëri disa hurma, shkon tek profeti (a.s) dhe i thotë: ” O Muhamed. Këto hurma janë dhuratë për ty dhe për shokët e tu”. Profeti (a.s) pasi e falenderoi, i mori, tha BISMILAH dhe hëngri një hurmë. Pastaj thirri shokët e tij dhe ua ndau hurmat e tjera. Selmani tha me vete: **“U provua shenja e dytë”.**

Pas disa kohësh teksa profeti (a.s) po rrinte me shokët e tij, pa që Selmani rrotullohej para dhe mbrapa profetit (a.s) për të parë shenjën në shpinën e tij. Profeti (a.s) e kuptoi diçka të tillë dhe hoqi rrobën që kishte veshur. Atëherë Selmani e pa shenjën e profecisë dhe tha me vete: **“Ja, u provua shenja e tretë”.** Pastaj filloi të qante e të puthte shpinën,

1. Bejhakiu në Delail, Ebu Jala dhe Ibn Ebi Hatim

duart dhe kokën e profetit të Zotit. Profeti (a.s) e pyeti: **“Pse po qan o Selman”?** Atëherë ai i tregoi historinë e tij. Profeti (a.s) ftoi edhe shokët e tij që ta dëgjojnë këtë histori.² Ja pra si dëshmojnë të krishterët e sinqertë për profetin Muhamed (a.s).

Për profetin tonë dëshmojnë gishtat e tij, prej të cilëve rridhte ujë kur ishte thatësirë. Për profetin (a.s) dëshmoi mishi i një qingji të vetëm, i cili ngopi 1000 vetë. Për profetin (a.s) dëshmojnë gurët, që i jepnin selam, ndërsa shokët e tij i dëgjonin. Dëshmonin drurët dhe pemët.

Dëgjoni këtë histori prekëse:

“Kur iku në Medine, profeti (a.s) e ndërtoi xhaminë e tij me trungje palmash dhe kur fliste ditën e xhuma, mbshtetej mbi një trung palme. Më vonë shokët e tij i ndërtuan një minber. Një ditë teksa profeti (a.s) po mbante hutben dhe po u fliste shokëve të tij, u dëgjua një rënkim i thellë. Askush nuk e dinte se nga vinte dhe krijua një gjendje hutimi. Profeti (a.s) zbriti prej minberit të tij dhe shkoi e lëmoi trungun e palmës, e përqafoi atë dhe atëherë rënkimi nuk u ndje më. Kur e pyetën shokët për këtë, ai u tha: **“Trungut të palmës i erdhi keq, që nuk po mbaj hutbe duke u mbështetur në të, prandaj po rënkonte. Pasha Zotin, po të mos e prekja unë dhe po të mos e përqafoja do të vazhdonte të rënkonte deri në ditën e Gjykimit”**³.

Një trung e ndjeu dashurinë për profetin (a.s), po zemra e njeriut vallë??

Lusim Allahun (xh.sh) që zemrat tona të mos jenë më të forta se gurët dhe se trungu i palmës. Le të dëshmojmë sinqerisht nga zemra jonë, se nuk ka Zot tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi (a.s) është rob dhe i dërguari i Tij. Bashkohu me gjuhën e universit, që të jesh nga ato krijesa që i ka nderuar Allahu (xh.sh) në këtë jetë dhe në tjetrën.

Lusim Allahun (xh.sh) që zemrat tona t'i mbushë me besim, më dashurinë për profetin (a.s) edhe pse nuk e kemi parë me sytë tanë. Nuk ka mirësi më të madhe, sesa të ndjekësh rrugën e këtij profeti, fjalët e të cilit janë bërë realitet.

Ai foli për shenjat e Kijametit dhe disa prej tyre shikohen sot me sy.

Ai ka thënë: **“Do të vijë një kohë, kur të varfrit, barinjtë e deleve do të zbresin nëpër qytete dhe do të garojnë se kush do të ndërtojë shtëpinë më të gjatë”**⁴.

Në atë kohë nuk ia merrte mendja askujt, se këto fjalë do të bëheshin një ditë realitet. Sot kjo është mëse e dukshme jo vetëm në tokat arabe por kudo.

Janë fjalët e profetit, të cilat nuk mund të hidhen kurrë poshtë.

Ai thoshte: **“Do të vijë një kohë, kur do të pihet alkooli në masë dhe do të ketë emra nga më të ndryshmit”**⁵. Kjo gjë as që mendohej në atë kohë, por e shikojmë të bërë realitet në ditët tona.

Ai thoshte: **“Në fund të jetës së kësaj bote, do të shtohet prostitucioni”**. (Buhariu & Muslimi). Në atë kohë as që mendohej një gjë e tillë, kurse sot prostitucioni është shtuar aq shumë, saqë i ndershmi ka frikë të thotë që është i ndershëm, sepse tallet nga të tjerët.

Profeti (a.s) thoshte: **“Sendet do të flasin”. “Fëmija do të përzërë nënën dhe babanë e tij”**.

Të gjitha po dalin dhe do të dalin, sepse ato janë fjalët e profetit (a.s). Prandaj lidhuni fort pas Islamit. Në qoftë se profetin (a.s) nuk e panë sytë tanë dhe fjalët e tij nuk i dëgjuam me veshët tona, dijeni se ato i kemi te shkruara nëpër libra. Faktet e tij janë të gjalla dhe i shikojmë përditë.

Ngushëlloj veten time dhe ju me këtë hadith të profetit (a.s), i cili na përshëndet qysh para 1400 vitesh. Ai (a.s) na përshëndet mua, ty dhe të gjithë besimtarët që do të jenë mbi shpinën e kësaj toke derisa të bëhet Kijameti. Ai ka thënë: **“Sa dëshirë do të kisha, të shikoja vëllezërit e mi”**. Sahabët I thanë: “O profet i Zotit! Po a nuk jemi ne vëllezërit e tu”? **“Jo – tha ai – ju jeni shokët e mi. Vëllezërit e mi do të jenë ata besimtarë, që nuk do të më shohin me sy fjalët e mia do t'i gjejnë të shkruara nëpër letra dhe do t'i besojnë ato. Shpërblimi i njërit prej tyre është sa 50-fishi i punës që bën njëri prej jush”**⁶.

Për profetin (a.s) çon salavate vetë Allahu (xh.sh), çojnë salavate edhe melekët e Zotit, prandaj është obligim për çdo musliman, që kur dëgjon emrin e profetit Muhamed (a.s), të çojë salavate për të duke thënë: “O Zot, dërgoi paqe këtij njeriu”, i cili u bë shkak që të dilnim nga errësirat në dritë.

E lusim Allahun (xh.sh), që zemrat tona t'i mbushë me dashurinë për profetin Muhamed (a.s), për krijesën më të mirë të Zotit.

Lusim Zotin, që ta japim shpirtin duke thënë fjalën LA ILAHE IL ALLAH MUHAMED RESULULLAH.

Lusim Zotin, që karvani ynë për në xhenet të jetë nën udhëheqjen e profetit Muhamed (a.s).

Lusim Zotin që të na mundësojë të pijmë ujin e Keutherit nga dora e profetit Muhamed (a.s) e kush pi prej dorës së tij, nuk do të ketë kurrë më etje.

Amin!..

2. Bejhakiu në Delailun' nubu' ueh. Ibn Haxheri dhe Dhehbiu e vlerësojnë tregimin të vërtetë.

3. Buhariu.

4. Muslimi.

5. **Hadith i vërtetë**. Ahmedi dhe Ibn Maxheh.

6. Pjesa e parë e hadithit përcillet nga Ahmedi dhe është i vërtetë. Pjesa e fundit e hadithit përcillet nga Ebu Daudi, Tirmidhiu dhe Ibn Maxheh, hadithi është i vërtetë.

Panxhari i Kuq



PËR SHËNDETIN E MIRË TË ZEMRËS DHE ORGANIZMIT

Panxhari i kuq është një nga perimet më të mira shqiptare dhe kultivohet gjerësisht në tokat më pjellore të vendit.

Vërtet është i vogël, por bën një punë shumë të madhe në trajtimin e problemeve të shëndetit.

Ai ndihmon me tensionin e lartë të gjakut, aneminë, tretjen, konstipacionit, problemeve me veshkat, lëkurën dhe sëmundjet e zemrës.

Panxhari gjithashtu ju ndihmon në përmirësimin e qarkullimit të gjakut, parandalon formimin e perdeve të syrit dhe problemet e frymëmarrjes.

Të gjitha këto i adresohen përbërjes së pasur të panxharit me vitamina dhe minerale.

VLERAT E PANXHARIT

Panxhari i kuq ka shumë vlera shëndetësore, duke qenë se është i pasur me vitamina, minerale dhe përbërës organikë si karotenoidi, vitamina C, magnezi, hekuri, bakri dhe fosfori, duke qenë në të njëjtën kohë dhe një burim i shkëlqyer me antioksidues.

Ata kanë shumë pak kalori, nuk përmbajnë kolesterol. Por kanë dhe përmbajtjen më të lartë të sheqerit natyral nga të gjitha perimet.

Bën shumë mirë për zemrën. Fibrat që ndodhen tek panxhari i kuq ndihmojnë për të ulur nivelin e triglicerideve dhe kolesterolit, duke ngritur nivelin e kolesterolit të mirë.

Trigliceridet në nivel të lartë rrisin shumë mundësinë për të pasur një atak kardiak, ndërkohë që konsumi i panxharit e ul këtë nivel, falë përbërësve të tij.

Redukton defektet në lindje. Panxhari është një produkt i shkëlqyer për gratë shtatzëna.

Duke qenë se është një burim i mirë për vitaminë B, ai ndihmon në zhvillimin e shtyllës kurrizore tek bebet. Mungesa e folatit sjell një sërë defektesh tek të porsalindurit.

Parandalon zhvillimin e qelizave tumorale. Studimet kanë treguar se panxhari është i mirë në parandalimin e qelizave të dëmshme të lëkurës, mushkërive dhe sistemit tretës, duke qenë se përmban pigmentin betacianinë, i cili pengon zhvillimin e tyre.

Parandalon problemet dhe perdet e syve. Plot me beta-karoten, panxhari ndihmon në parandalimin e kataraktit, ose perdes së syrit.

Por dhe problemeve të tjera të dobësimi të shikimit, që vijnë si pasojë e moshës.

Kujdes! Panxhari përmban një element të njohur si oksalat. Konsumimi me tepriçë i panxharit kristalizon lëngjet e trupit.

Njerëzit që kanë probleme me veshkat ose me fshikëzën e urinës, nuk duhet të konsumojnë panxhar, sepse mund të përkeqësojnë gjendjen e gurëve në veshka.





PSE DUHET KONTROLLUAR SKADENCA E UJIT NË SHISHE

Data e skadimit e ujit të ambalazhuar në shishe plastike është data kur plastika fillon të prishet dhe lëshon kimikatat e saj në ujë.

Është njohuri e zakonshme që ju nuk duhet të pini nga shisheet e ujit që keni lënë në një makinë të nxehtë, sidomos kur temperaturat e motit janë të larta.

Por kur është hera e fundit që e keni kontrolluar datën e skadimit të një shisheje uji që ju keni porositur në lokal apo blerë në dyqan?

Shumica dërrmuese e konsumatorëve nuk e kontrollojnë datën e skadencës, ata marrin të mirëqënë faktin që uji në shishe plastike është i sigurtë.

Arsyeja pse lëngjet ose produktet e qumështit kanë një datë të skadencës është shumë e vetëkuptueshme, ndaj mund të habiteni që edhe uji në shishe vjen me një afat kohor përdorimi.

Por nuk është cilësia e ujit që duhet të shqetësoheni. Bëhet fjalë për plastikën në të cilën uji vjen i pakeluar. Zakonisht vihet re përdorimi i PET për shishe me pakicë dhe polietileni me densitet të lartë, HDPE për paketimet masive të ujit.

Pas një pike të caktuar në jetën e saj, plastika fillon të lëshojë kimikate në ujë. Kjo dukuri ndikon në shijen e ujit i cili përbën një rrezik serioz për shëndetin.

A ju ka ndodhur të lini një gotë uji gjatë natës

dhe të pini një gllënjë të nesërmen? A e keni vënë re se ajo ka shije shumë ndryshe nga uji i freskët?

Ju mund të dyshoni se uji është prishur, por shija e çuditshme është në të vërtetë për shkak se uji është ekspozuar ndaj ajrit. Ky ekspozim e bën ujin më acid duke grumbulluar elementë si pluhuri dhe mikrobet.

Asnjëherë mos lini ujë në shishe në rrezet e diellit të drejtpërdrejtë ose brenda makinës gjatë gjithë ditës në një ditë të nxehtë me diell.

Kimikatat nga ena plastike do të nxehen dhe do të depërtojnë në ujë.

Pirja e këtyre shisheve që kanë mbetur në diell kanë rezultuar të lidhur drejtpërdrejt me tumorët e gjirit tek femrat. Studimet e fundit tregojnë lidhje me lloje të tjera të sëmundjeve tumorale si në meshkuj ashtu edhe në femra.



PAJISJE ME LAZËR PËR TË ZBULUAR USHQIMET E FALSIFIKUARA



Mashtrimi me ushqimet, falsifikimi i tyre, i kushton industrisë së ushqimit dhe pijeve rreth 30 miliardë dollarë çdo vit. Mashtrimi me ushqimet është zëvendësimi i qëllimshëm ose keqinterpretimi i produkteve ushqimore për përfitime ekonomike. Në disa raste, si hollimi i vajit të ullirit është me pak rrezik dhe në raste të tjera, përdorimi i niseshtesë ose lëndëve plastike për të zëvendësuar orizin, rreziku është shumë i madh. Siç na njeh edhe materiali në vazhdim, një test me lazer i zhvilluar në Itali mund të zbulojë me saktësi të pabesueshme ushqimet e falsifikuara.

Mashtrimi me ushqimet ndodh për herë dhe në të gjitha llojet e produkteve, që nga lëngjet e frutave, vaji i ullirit e deri tek peshku ton. Hulumtuesit italianë kanë krijuar një pajisje që zbulon menjëherë ushqimet e falsifikuara. Adriana Puiu është me Qendrën Kërkimore Frascati Enea.

“Synimi është të zbulojmë rastet e falsifikimit të ushqimit. Për shembull, prania e vajrave me cilësi të ulët të përziera me vajin e ullirit ekstra të virgjër, ose metanoli në pijet alkoolike, apo fshehja e përmbajtjes së sheqerit në etiketat e lëngjeve të frutave, dhe kryesisht histamina në produktet e peshkut.”

Prova bëhet përmes analizës të quajtur spektroskopi fotoakustike me rreze lazer. Një rreze lazer kalon përmes vajit të ullirit apo peshkut dhe zbulon të gjitha kimikatet e ndryshme në të.

“Rrezja lazer përshkron artikullin dhe ndërvepron me përbërësit e tij. Rrezja lazer është ndërtuar posaçërisht për këtë qëllim dhe na lejon të zbulojmë me përpikmëri të lartë molekulat e falsifikuara”, thotë hulumtuesja italiane Adriana Puiu.

Sikurse të gjitha teknologjitë e reja, pajisja nuk është shumë praktike. Por ekipi po punon për të prodhuar një pajisje të vogël që të mbahet në dorë.

Luca Fiorani është me laboratorin e Qendrës Kërkimore Frascati Enea.

“Duam të prodhojmë një sistem portativ si një çantë dore që autoritet mund ta marrin me vete për të analizuar produktet. Kur pajisja sinjalizon për probleme në produkte, mostrat dërgohen në laborator për analizë të hollësishme, çfarë kërkon kohë, kushton dhe është komplekse.”


Hulumtuesit thonë se një variant portativ do të jetë i mundshëm gjatë tre viteve të ardhshme.

ZBULOHET NJË FORMË E RE E MATERIES

Pothuajse 50 vjet pas krijimit të teorisë së parë për ekscitoniumin, fizikantët përfundimisht arritën të gjejnë fakte për ekzistimin e kësaj forme të materies, transmeton Daily Mail. Ekscitonium përbëhet nga grimca të quajtura ekscitone, të cilat përbëhen nga elektronet e ikura dhe zbrazëtirat që ata lënë pas vetes.

Në eksperimentet e fundit, hulumtuesit patën rastin të vëzhgojnë këtë materie dhe fazën e saj të prekursorit, gjë që konsiderohet si një fakt jo i rëndësishëm për ekzistencën e saj. Për të gjetur formën e re të materies, shkencëtarët kanë zhvilluar një teknikë të re, të quajtur spektroskopja EEL.

Termi "ekscitonium" është përmendur në vitin 1960 nga fizikanti teorik Bert Halperin nga Harvardi, ndërsa fizikantët që nga atëherë tentojnë që të dëshmojnë ekzistimin e saj. Zbulimi i ri do të duhej të ofrojë përgjigje në shumë çështje nga fusha e fizikës kuantike.



10 FAKTE INTERESANTE QË DUHET TË DINI PËR DRITËN

Më 21 nëntor 1676, astronomi danez Ole Romer njoftoi në Akademinë e Shkencave në Paris përfundimin e tij se drita udhëton me një shpejtësi të kufizuar.

1. Sipas obserbimeve të Romer për Jupiterin dhe hënën, drita udhëton 220,000 km në sekondë. Shifra e saktë është 299,000 km për sec.

2. Romer ishte i pari që provoi se drita nuk udhëtonte asnjëherë.

3. Rastësisht data 21 nëntor ishte gjithashtu data kur Ajnshtajni publikoi së pari ekuacionin $E = mc^2$ duke lidhur energjinë, masën dhe shpejtësinë e dritës

4. Kjo datë është mjaft e rëndësishme në historinë e zërit dhe dritës. Edison shpalli shpikjen e fonografit po në këtë ditë në 1877.

5. Mesatarisht dritës i duhen 8 minuta dhe 20 sekonda për të arritur në tokë.

6. Dritës së hënës i duhen 1.25 sekonda për të arritur te ne.

7. Rrezet e diellit arrijnë deri në 80 metra thellë në oqean

8. Një vit dritë është distanca që drita udhëton për një vit

9. Ylli më i afërt i Tokës përveç Diellit është Proxima Centauri që është 4.24 vite dritë larg

10. Sipas teorisë aktuale, drita nuk ekzistonte deri në mes të 240,000 dhe 300,000 vitesh pas Big bang.

EKSPERTËT RREGJISTROJNË ZHURMË, QË VJEN “NGA BRENDA” PLANETIT TONË

Studiuesit kanë regjistruar një zhurmë që vjen nga brenda planetit tonë duke përdorur instrumente të vendosura në shtratin e oqeanit. Shkencëtarët janë të bindur se zbulimet e reja mund të përdoren për të zbuluar më shumë hollësi dhe saktësi mbi brendësinë e Tokës.

Duke përdorur instrumente sizmike të vendosura në shtratin e oqeanit, studiuesit kanë përcaktuar me sukses sasinë e vibracioneve të Tokës.

Jo, nuk janë alienë, nuk është një bazë alienësh, as nuk ka një anije kozmike aliene në fund të oqeanëve tona.

Shkencëtarët kanë pranuar prej disa kohësh që tërmetet mund të bëjnë që Toka të dridhet për periudha të gjata kohore.

Megjithatë, në vitin 1998 një ekip shkencëtarësh zbuluan se Toka vazhdimisht gjeneron një sinjal vibracional me frekuencë të ulët, edhe kur nuk ka tërmete.

Që atëherë, sizmologët kanë propozuar teori të ndryshme për të shpjeguar ekzistencën e kësaj dridhjeje të vazhdueshme, nga trazirat atmosferike, deri tek valët e oqeanëve.

Ata gjithashtu matën dridhjet duke përdorur sizmometër në terren, por ende nuk kishin matur me sukses në fund të detit, gjë që mund të ndihmonte shkencëtarët të vlerësonin më mirë burimet e

dridhjeve.

Tani, duke përdorur instrumente sizmike të vendosura strategjikisht në shtratin e oqeanit, studiuesit kanë arritur të vërtetojnë me sukses sasinë e vibracioneve të Tokës.

Një studim i ri i botuar në një revistë të Unionit të Gjeofizikantëve Amerikanë, shpjegon se si ekspertët arritën të zbulonin frekuencat në të cilat Toka vibron natyrshëm dhe konfirmuan mundësinë e përdorimit të instrumenteve oqeanike për të studiuar lëvizjen e Tokës.

Kapja e lëvizjes në shtratin e oqeanit mund të japë njohuri të reja në madhësinë e burimit, sipas Martha Deen, një gjeofizikane në Institutin e Fizikës së Tokës në Paris, Francë, dhe autore kryesore e studimit të ri.

Përveç kësaj, gjetjet e reja mund të përdoren për të hartëzuar brendësinë e Tokës në më shumë detaje dhe saktësi.

Studimi mund të japë një tablo më të mirë se sa përdorimi i vetëm sizmometereve të vendosur në tokë, duke rritur mbulimin e të dhënave në zona të mëdha, tha Din.

“Toka është duke lëvizur vazhdimisht dhe ne kemi dashur të vëzhgojmë këto lëvizje, sepse mund të përfitojmë nga fakti se kemi më shumë të dhëna,” shpjegoi Deen.



KOPSHTI

Aromë Trëndafili



KOPSHTI
“Aromë Trëndafili”!



**Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe i kontrolluar,
staf i kualifikuar, çmime të arsyeshme,
transporti është i garantuar.**

Ju mirëpresim!



1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË



“Në të vërtetë,
Allahu ka blerë
nga besimtarët
jetën dhe
pasurinë e tyre,
në këmbim
të Xhenetit...”

(Teube, 111)

